FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 100

Tiranë – E enjte, 12 qershor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 4.6.2025	Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe analizimin e rrezikut të sigurisë kibernetike	14487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 4.6.2025	Për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin dhe të planit të veprimit 2025–2030	14496
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 29.4.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 22/22-2018-127, datë 17.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2024-1285, datë 11.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	14530
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 124, datë 30.5.2025	Autorizim i ndihmës shtetërore "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë"	14539
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 125, datë 30.5.2025	Autorizim i ndihmës shtetërore "Mbështetje për incentiva të reja për grupet në nevojë"	14544
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 12.5.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV	14547
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 12.5.2025	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Green Energy" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw	14548
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 12.5.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "SunPro" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë eolike, me kapacitet prodhues 3 mw	14549

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 12.5.2025	Mbi licencimin e shoqërisë "NAD Investment" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	14551
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 12.5.2025	Mbi licencimin e shoqërisë "NAD Investment" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	14553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 12.5.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Hydropower" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj.....	14554
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 12.5.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Dimax Albania" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj	14555
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 103, datë 12.5.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Construction Energy Parts (C.E.P)" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj.....	14556

VENDIM
Nr. 308, datë 4.6.2025

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN DHE ANALIZIMIN E RREZIKUT TË SIGURISË KIBERNETIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ë", të nenit 9, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe analizimin e rrezikut të sigurisë kibernetike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe operatorët e infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN DHE ANALIZIMIN E RREZIKUT TË SIGURISË KIBERNETIKE

Përmbajtja

Lista e figurave
Lista e tabelave
1. Hyrje
2. Objekti
3. Qëllimi
7. Fusha e veprimit
8. Burimet e informacionit për vlerësimin e rrezikut kibernetik
9. Regjistri i rreziqeve të OIKI-së/OIRI-së
10. Hapat e implementimit të metodologjisë
10.1. Mbledhja e informacionit
10.2. Analiza dhe vlerësimi i rrezikut
10.3. Raportimi dhe monitorimi
11. Caktimi i peshave të pyetësorit
11.1. Detajimi i peshave (ndikimi) teknologjike
11.2. Detajimi i peshave (ndikimi) të proceseve
11.3. Detajimi i peshave (ndikimi) të burimeve njerëzore
12. Vlerësimi i rrezikut
12.1. Mundësia e ndodhjes
12.2. Ndikimi
12.3. Vlerësimi i rrezikut

Lista e figurave

Figura 1. Tri nivelet e vlerësimit të rrezikut

Lista e tabelave

Tabela 1. Pesha sipas hendekut profesional
Tabela 2. Mundësia e ndodhjes sipas shpeshtësisë së pritshme të ndodhjes së rrezikut
Tabela 3. Mundësia e ndodhjes sipas kategorive nga 1 deri në 5 dhe triada e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave në total dhe sipas komponentëve përkatës
Tabela 4. Mundësia e ndikimit sipas kategorive nga 1 deri në 5 dhe triada e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave në total dhe sipas komponentëve përkatës
Tabela 5. Prodhimi sasior i mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit
Tabela 6. Prioritizimi i trajtimit sipas matricës së rrezikut
1 Hyrje

Shqipëria, herë pas here, është përballur me sulme kibernetike ndaj operatorëve që ofrojnë shërbime kritike dhe të rëndësishme. Përpjekjet e vazhdueshme në digjitalizimin e shërbimeve sjellin lehtësime dhe fleksibilitet në funksionet jetësore, shoqërore dhe ekonomike të qytetarëve, por, nga ana tjetër, rrisin mundësinë e ndodhjes së sulmeve kibernetike, duke vënë në pah ndërvarësinë dhe ndërlidhjen gjithnjë e më shumë të sistemeve të teknologjisë së informacionit mes tyre. Gjithashtu, varësia nga zinxhirët globalë të furnizimit do të thotë që operatorët e infrastrukturave të informacionit janë, gjithashtu, të ekspozuar ndaj rreziqeve sistemike kibernetike jashtë kontrollit të tyre të drejtpërdrejtë dhe, si rrjedhim, bëhen më të ndjeshme ndaj efekteve të menjëhershme ndërprerëse të sulmeve kibernetike.

Për të kuptuar, përmirësuar e për një vendimmarrje sa më të favorshme në kuadër të pozicionit të rrezikut kombëtar të sigurisë kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike duhet të kuptojë vazhdimisht rreziqet e sigurisë kibernetike që lidhen me çdo sektor, ku operojnë OIKI-të/OIRI-të dhe të bashkëveprojë për identifikimin e rreziqeve kibernetike. Krijimi i

besimit dhe bashkëpunimi me operatorët është shumë i rëndësishëm për identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve të sigurisë kibernetike.

Ky dokument prezanton "Metodologjinë për vlerësimin dhe analizimin e rrezikut të sigurisë kibernetike" (në vijim "Metodologjia") për hapësirën digjitale kombëtare. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) zhvilloi këtë proces analitik të standardizuar nëpërmjet qasjes nga poshtë lart (siç ilustrohet në figurën 1), të kontekstualizuar me inteligjencën e kërcënimeve kibernetike dhe informacioneve të tjera. Metodologjia bazohet në standardet[1] dhe praktikat ndërkombëtare më të mira të menaxhimit të rrezikut kibernetik dhe është në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", dhe kërkesat e direktivës së Bashkimit Evropian (NIS2).

Kjo metodologji konsiston në tre hapa kryesorë:

- Hapi 1. AKSK-ja kryen vlerësime individuale të rrezikut të sigurisë kibernetike për operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit (OIKI/OIRI), bazuar në burimet e përcaktuara në pikën 6 të kësaj metodologjie;
- Hapi 2. AKSK-ja kryen vlerësime sektoriale të rrezikut të sigurisë kibernetike;
- Hapi 3. AKSK-ja kryen vlerësimin kombëtar të rrezikut të sigurisë kibernetike.



Figura 1. Tri nivelet e vlerësimit të rrezikut

[1] ISO 27001/5, ENISA and NIST SP 800-53.

2. Objekti

Objekti i kësaj metodologjie është vendosja e një kornize gjithëpërfshirëse për identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe menaxhimin e rreziqeve kibernetike në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, duke mundësuar që operatorët e infrastrukturave të përmirësojnë qëndrueshmërinë kibernetike dhe të kontribuojnë në mbrojtjen e sigurisë kombëtare, stabilitetin ekonomik dhe sigurinë publike.

3. Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i dobësive në infrastrukturat e informacionit, me qëllim mbrojtjen e tyre, duke përmirësuar dobësitë në këto infrastruktura dhe duke garantuar qëndrueshmërinë kibernetike për të rritur nivelin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

4. **Përkufizimet**

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike".

5. Përgjegjësia e AKSK-së dhe OIKI-së/OIRI-së

AKSK-ja është përgjegjëse për vlerësimin e rrezikut kibernetik nga niveli i infrastrukturës, sektorial e deri në atë kombëtar, sipas përcaktimeve të kësaj metodologjie.

Çdo OIKI/OIRI është përgjegjës në lidhje me:

- identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të infrastrukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofrojnë, duke zbatuar praktikat më të mira të sigurisë kibernetike dhe kontrollet e aplikueshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mbrojtur dhe për të ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë "CIA" të shërbimeve dhe të dhënave të saj;

- realizimin e vlerësimit periodik të rrezikut kibernetik (të paktën një herë në vit) ose, në rast ndryshimesh të klasifikuara si madhore, nga vetë operatori.

OIKI/OIRI mund të zgjedhë sipas vendimmarrjes individuale metodologjinë e vlerësimit të rrezikut kibernetik, bazuar në standardet ndërkombëtare, por duhet të raportojë sa herë i kërkohet nga AKSK-ja mbi vlerësimin e rrezikut, sipas specifikimeve në këtë metodologji (sipas formatit të përcaktuar nga AKSK-ja).

6. Objektivat

Objektivat kryesorë të kësaj metodologjie përfshijnë:

a) identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve dhe dobësive kibernetike për infrastrukturat e rëndësishme dhe kritike të informacionit;

b) prioritizimin e rreziqeve bazuar në ndikimin e tyre të mundshëm për të siguruar shpërndarjen efektive të burimeve;

c) zhvillimin e strategjive me qëllim zbutjen e rreziqeve për të përmirësuar sigurinë kibernetike kombëtare;

ç) promovimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara për të nxitur një qasje të unifikuar ndaj sigurisë kibernetike;

d) përmirësimin e aftësive për përgjigje ndaj incidenteve për të adresuar shpejt dhe në mënyrë efektive incidentet kibernetike;

dh) sigurimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve kritike përballë kërcënimeve kibernetike në zhvillim.

6.1. Objektivat specifikë

AKSK-ja, bazuar në këtë metodologji, mbështetet në këta objektiva specifikë:

a) Vlerësimin e rrezikut të shërbimeve të OIKI-së/OIRI-së me periodicitet 6-mujor.

b) Rivlerësimin e nivelit të rrezikut kibernetik të OIKI-së/OIRI-së pas një ndryshimi madhor në:

- arkitekturën e sistemeve;
- shërbimet e reja të ofruara;
- infrastrukturën;
- furnizimin e palëve të treta;
- kuadrin rregullativ;
- ristrukturimin e institucionit;
- rastin e një incidenti me ndikim të lartë etj.

7. Fusha e veprimit

Metodologjia fokusohet në identifikimin e rreziqeve të sigurisë kibernetike ndaj shërbimeve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të vendit, që lidhen me analizimin e faktorëve, si: burimet njerëzore, proceset, teknologjia, gjeopolitika (çështje që lidhen drejtpërdrejt me politikën kombëtare të vendit) dhe të tjera (elemente të tjera të rëndësishme që nuk janë të përfshirë në kategoritë e mësipërme, por që mund të ndikojnë në sigurinë kibernetike dhe që AKSK-ja i merr në konsideratë në varësi të zhvillimeve të reja teknologjike, ligjore, gjeopolitike ose operacionale).

8. Burimet e informacionit për vlerësimin e rrezikut kibernetik

Për të vlerësuar rrezikun kombëtar lidhur me sigurinë kibernetike të vendit, AKSK-ja analizon informacionet e marra nga:

- OIKI/OIRI përmes pyetësorëve me periodicitet 6-mujor, të cilët miratohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKSK-së;
- raportet e vlerësimit të rrezikut kibernetik të operatorëve;
- raportet e organit të vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike;
- raportet e auditimit të brendshëm/jashtëm nga OIKI/OIRI apo kontrollit, të realizuara nga AKSK-ja pranë këtyre infrastrukturave të informacionit;
- raportet dhe analiza e kryer nga AKSK-ja ose OIKI/OIRI lidhur me incidentet, kërcënimet, teknikat e taktikat dhe procedurat që përdoren nga sulmuesi, dobësitë etj.;
- shërbimet e inteligjencës, të sigurisë dhe mbrojtjes;
- partnerët ndërkombëtarë;
- media (sociale, portale, TV, e shkruar).

9. Regjistri i rreziqeve të OIKI-t/OIRI-t

AKSK-ja do të ndërtojë, mirëmbajë dhe përditësojë një regjistër të rreziqeve OIKI/OIRI. Regjistri do të përbëhet nga profilet e operatorëve, që do të përfshijnë informacione bazë mbi infrastrukturat, arkitekturat e tyre, sistemet, shërbimet, zinxhirët e furnizimit të tyre, si dhe informacione mbi vlerësimet e brendshme të rrezikut kibernetik, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga kontrollet, auditimet, testimet e realizuara, raportet dhe analizat e kryera nga AKSK-ja ose OIKI/OIRI lidhur me incidentet, kërcënimet kibernetike. Në ndërtimin dhe popullimin e të dhënave të profilit të operatorëve, informacioni do të mblidhet nga të dhënat e disponueshme publike, sikurse dhe nëpërmjet pyetësorëve të detyrueshëm, të iniciuar dhe dërguar çdo operatori nga AKSK-ja.

AKSK-ja do të mirëmbajë e do të përditësojë këtë regjistër nëpërmjet menaxhimit të duhur të "aksesit" dhe kontrolleve bazuar në parimin "kërkesë sipas nevojës".

10. Hapat e implementimit të metodologjisë

Për implementimin e metodologjisë për vlerësimin dhe analizimin e rrezikut të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, AKSK-ja do të ndjekë hapat e mëposhtëm:

10.1. Mbledhja e informacionit

AKSK-ja kryen procesin e mbledhjes së informacionit bazuar në burimet e përcaktuara në pikën 8 të kësaj metodologjie.

10.2. Analiza dhe vlerësimi i rrezikut

Kjo fazë përfshin hapat e mëposhtëm:

a) analizën e informacioneve të mbledhura nga AKSK-ja për identifikimin e rreziqeve;

b) vlerësimin e rrezikut në formatet sasiore dhe cilësore për çdo OIKI/OIRI, sipas pikës 12 të kësaj metodologjie;

c) përfshirjen e rreziqeve gjeopolitike dhe të tjera në vlerësimin e rrezikut kombëtar;

ç) prioritizimin e rreziqeve;

d) vlerësimin e rreziqeve në nivel sektorial dhe kombëtar.

10.3. Raportimi dhe monitorimi

AKSK-ja harton 2 herë në vit raportin e vlerësimit dhe analizimit të rrezikut kombëtar, raport i cili do t'u dërgohet operatorëve të infrastrukturave të informacionit.

AKSK-ja, në mënyrë të vazhdueshme, monitoron e vlerëson rrezikun kibernetik, me qëllim trajtimin e rreziqeve nga OIKI/OIRI, sipas prioritizimit kohor të përcaktuar në tabelën nr. 6 të kësaj metodologjie.

11. Caktimi i peshave të pyetësorit

11.1. Detajimi i peshave (ndikimi) teknologjike

Sipas ndikimit teknologjik, peshat reflektojnë rëndësinë dhe ndikimin që ka secila masë teknike e sigurisë në "Pyetësor" në sigurinë e përgjithshme të sistemit, sipas ndikimit që mund të kenë në triadën e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

11.2. Detajimi i peshave (ndikimi) të proceseve

Sipas hendekut të proceseve, ndikimi do të jetë një shumatore e 5 (pesë) kategorive të marra në konsideratë nga standardi ISO 27005, si në vijim:

1. Ndikimi financiar

a) Humbjet e të ardhurave: Sulmet kibernetike mund të çojnë në humbje të ardhurash, për shkak të ndërprerjes së operacioneve ose ndërprerjes së shërbimeve;

b) Kostot e rikuperimit: Kostot e lidhura me zbulimin, përgjigjen dhe rikuperimin nga sulmet kibernetike mund të jenë shumë të larta;

c) Dëmet për shkak të mashtrimeve: Përfshirja në aktivitete të paligjshme, si vjedhja e identitetit ose mashtrimet financiare, mund të shkaktojë dëme të mëdha financiare.

2. Ndikimi ligjor dhe reputacional

a) Sanksionet dhe gjobat: Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve të privatësisë dhe sigurisë së të dhënave mund të rezultojnë në sanksione të rënda dhe gjoba;

b) Ndjekja penale: Operatorët e infrastrukturave mund të përballen me ndjekje penale dhe përgjegjësi ligjore për mosmbrojtjen adekuate të të dhënave të përdoruesve;

c) Humbja e besimit të klientëve: Incidentet e sigurisë mund të dëmtojnë besimin e klientëve dhe partnerëve, duke shkaktuar humbje të klientëve dhe të ardhurave të mundshme;

ç) Dëmtimi i markës: Një sulm kibernetik mund të dëmtojë imazhin dhe reputacionin e një operatori të infrastrukturës së informacionit, gjë që mund të ketë pasoja afatgjata në treg.

3. Ndikimi social

a) Shkeljet e privatësisë: Rreziqet kibernetike mund të shkaktojnë shkelje të privatësisë dhe të të dhënave personale të individëve, duke çuar në pasoja të rënda për jetën private;

b) Ndikimi në shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve: Sulmet ndaj sistemeve shëndetësore dhe të sigurisë publike mund të kenë pasoja të rënda për shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

4. Ndikimi operacional

a) Ndërprerja e shërbimeve: Sulmet *DDoS (Distributed Denial of Service)* dhe *malware* mund të ndërpresin shërbimet kritike, duke penguar funksionimin normal të operatorit të infrastrukturës dhe sistemeve.

b) Humbja e të dhënave: Të dhënat mund të fshihen, të shkatërrohen ose të vidhen gjatë sulmeve kibernetike, duke penguar operacionet dhe duke shkaktuar humbje të dhënash të rëndësishme.

5. Ndikimi në sigurinë kombëtare

a) Kompromentimi i infrastrukturës kritike të informacionit: Sulmet kibernetike ndaj infrastrukturës kritike të informacionit, si: energjia, uji, dhe shërbimet financiare etj. mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe jetën e qytetarëve;

b) Rreziku për mbrojtjen kombëtare: Sulmet ndaj sistemeve qeveritare dhe ushtarake mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe të ndikojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Secili prej ndikimeve të mësipërme e ka peshën 0 ose 1. Shuma e peshave përcakton peshën totale të masës organizative të sigurisë.

11.3. Detajimi i peshave (ndikimi) të burimeve njerëzore

Peshat reflektojnë rëndësinë dhe ndikimin që ka secila masë teknike e sigurisë në sigurinë e përgjithshme të sistemit, sipas ndikimit që mund të kenë në hendekun e burimeve njerëzore (institucioni ka mjaftueshëm kapacitete të burimeve njerëzore për sigurinë kibernetike për të përmbushur qëllimet/ objektivat strategjikë/operacionalë), si dhe hendekun profesional (kapacitete njerëzore me eksperiencën dhe kualifikimet e mjaftueshme për të përmbushur qëllimet/objektivat strategjikë/ operacionalë).

Hendeku i burimeve njerëzore identifikon dhe vlerëson diferencën ndërmjet kapacitetit aktual të burimeve njerëzore dhe kërkesave optimale të nevojshme. Formula për vlerësimin e këtij hendeku mbështetet në praktikat më të mira të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe organizative në fushën e sigurisë kibernetike, duke u bazuar në parametrat kryesorë të përcaktuar në standardet ISO/IEC 27001 dhe 27005 për burimet njerëzore. Ky vlerësim bazohet në katër parametra kryesorë:

a) numrin total të punonjësve;

b) vendndodhjet gjeografike;

c) shërbimet kritike;

ç) numrin aktual të ekspertëve.

Formula e përdorur në këtë analizë është:

Hendeku i burimeve njerëzore = {(Numri total i punonjësve × 0.02[2]) + (Vendndodhjet gjeografike ÷ 30[3]) + (Shërbimet kritike ÷ 4[4])} – Numrin aktual të ekspertëve IT+Sec.

Hendeku profesional vlerësohet në bazë të peshës që sjell niveli i ekspertizës së punonjësit në fushën e sigurisë kibernetike. Kjo peshë përcaktohet duke marrë parasysh vitet e përvojës profesionale, zotërimin e certifikimeve të njohura ndërkombëtarisht, si dhe të diplomave apo të certifikimeve të lëshuara nga institucione të arsimit

[2] Shumëzimi i numrit total të punonjësve me 0.02 pasqyron një pjesë të vogël, por të rëndësishme të forcës së punës që kërkohet për të mbajtur operacionet optimale.

[3] Ndarja e numrit të vendndodhjeve gjeografike me 30 normalizon të dhënat, duke i bërë ato të krahasueshme me parametrat e tjerë.

[4] Ndarja e shërbimeve kritike me 4 llogarit rëndësinë e këtyre shërbimeve në efikasitetin e përgjithshëm operacional.

profesional dhe të lartë të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në fusha të tilla, si: teknologjia e informacionit, siguria kibernetike, inxhinieria, apo shkencat kompjuterike.

Tabela në vijim prezanton peshën në këndvështrim të hendekut profesional:

Tabela nr. 1 Pesha sipas hendekut profesional

Vitet e eksperiencës në fushën e sigurisë kibernetike	Certifikime ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike	Pesha
3	0	1
2	1	1
1	2	1
2	0	2
1	1	2
1	0	3
0	1	4
0	0	5

12. Vlerësimi i rrezikut

Në këtë fazë shpjegohet procesi i vlerësimit dhe i analizimit të rrezikut të sigurisë kibernetike të përdorur në këtë metodologji, duke përfshirë identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rrezikut kibernetik kombëtar, që mund të cenojë infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit të vendit.

Metodologjia e vlerësimit dhe e analizimit të rrezikut të sigurisë kibernetike përdor një qasje sistematike dhe model të strukturuar për analizimin e faktorëve tipikë të rrezikut, që përfshijnë probabilitetin dhe ndikimin në shërbime në terma të humbjes së ***konfidencialitetit, integritetit dhe/ose disponueshmërisë (CIA)*** të të dhënave dhe/ose një funksioni të një shërbimi kritik dhe të rëndësishëm.

Faktorët e rrezikut përfshijnë, si më poshtë vijon:

- Kërcënimi – Çfarë mund të ndodhë për të dëmtuar dhe/ose ndërprerë funksionimin normal të një shërbimi të caktuar?

- Dobësia – Pikat e dobëta në sistem/arkitekturë, që shfrytëzohen nga vektori i kërcënimit me qëllim keqfunksionimin ose ndërprerjen e tij.

- Probabiliteti/frekuenca (ekspozimi) – Mundësia që kërcënimi të shfrytëzojë dobësinë për të shkaktuar një ndikim negativ.

- Ndikimi/serioziteti i pasojave – Në rast se një kërcënim materializohet, vlerësohet niveli i ashpërsisë së ndikimit të mundshëm që ai mund të ketë mbi funksionimin e shërbimit apo infrastrukturës përkatëse. Ky vlerësim realizohet në mënyrë të kontekstualizuar, duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve, auditimeve dhe burimeve të tjera relevante, si dhe në analizën profesionale të stafit vlerësues. Kjo qasje mundëson fleksibilitet dhe përshtatshmëri me realitetin konkret të çdo sektori apo infrastrukture, duke shmangur kufizimet që do të sillte një vlerësim i bazuar vetëm në skenarë të standardizuar.

Metodologjia analizon këta faktorë rreziku në kontekstin e **burimeve njerëzore, proceseve dhe teknologjisë** për të bërë një përcaktim të rrezikut të sigurisë kibernetike për OIKI/OIRI.

Për të grupuar rreziqet e identifikuara, metodologjia përdor 3 (tri) hendeqet kryesore, si më poshtë:

1. Hendeku në burime njerëzore

- Staf i pamjaftueshëm: Numër i pamjaftueshëm personeli për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë kibernetike.

- Mungesë njohurish të specializuara: Punonjësit mund të mos kenë njohuritë e nevojshme në menaxhimin e rrezikut, analizën e të dhënave ose sigurinë kibernetike.

- Mungesa e trajnimeve dhe ndërgjegjësimi: Programe të pamjaftueshme trajnimi dhe ndërgjegjësimi për punonjësit që të përballojnë rreziqet e sigurisë kibernetike.

2. Hendeku në procese

2.1. Hendeku operacional. Këto janë mangësi në proceset ose praktikat që lidhen me menaxhimin dhe mbrojtjen e sistemeve të informacionit dhe të dhënave. Shembujt përfshijnë plane të pamjaftueshme për përgjigjen ndaj incidenteve, mungesën e auditimeve të rregullta të sigurisë, mungesën e testimeve periodike të përputhshmërisë dhe penetrimit, dështimin për të zbatuar në mënyrë të vazhdueshme politikat e sigurisë, azhurnimet e pamjaftueshme të sigurisë dhe ndreqjen e cenueshmërive të njohura të *software*-it, dështimin për të rishikuar e vepruar mbi inteligjencën e kërcënimeve, zbutjen/riparimin e cenueshmërive të zbuluara gjatë testimeve etj.

2.2. Hendeku i menaxhimit. I referohet mungesës së një kuadri të qartë dhe të dokumentuar për menaxhimin e rrezikut kibernetik, duke përfshirë edhe mungesën e mekanizmave të brendshëm për vendimmarrje strategjike në lidhje

me këto rreziqe. Ky hendek nuk ka të bëjë me përmbajtjen e prioriteteve specifike të operatorit, të cilat mbeten përgjegjësi ekskluzive e tij, por lidhet me ekzistencën ose mungesën e një qasjeje të strukturuar për menaxhimin e tyre.

2.3 Hendeku i politikave dhe përputhshmërisë. Këto ndodhin kur një operator infrastrukture dështon në përmbushjen e kërkesave rregullatore ose standardet e industrisë për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurisë së informacionit. Kjo mund të jetë për shkak të politikave të vjetruara, mungesës së ndërgjegjësimit për ndryshimet rregullatore, kontrolleve të pamjaftueshme për të siguruar përputhshmëri me standardet ose dështimit për të përmbushur planin e trajtimit të rrezikut.

3. Hendeku në teknologji

Hendeku teknologjik ndodh kur ka mungesë të zgjidhjeve të nevojshme teknologjike për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike aktuale dhe të reja. Kjo mund të përfshijë sisteme sigurie të vjetruara, mungesë të mjeteve të avancuara për zbulimin e kërcënimeve, karakteristika të pamjaftueshme të sigurisë në infrastrukturën ekzistuese të IT-së ose dështim për të përdorur praktikat më të mira si "mbrojtja në thellësi", ndarja e rrjeteve në rrjete publike dhe private etj.

Për secilën nga kategoritë e mësipërme janë identifikuar rreziqet shoqëruese si pjesë përbërëse e tyre, ndërsa në tabelën e vlerësimit të rreziqeve janë përcaktuar, gjithashtu, dhe komponentët e triadës CIA, që preken (konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria) për çdo gjetje që derivon në rrezik.

Për qëllime të kësaj metodologjie, rreziku do të matet në terma të mundësisë së ndodhjes dhe ndikimi, pra, mundësia që një ngjarje të ndodhë në kombinim me pasojën e saj.

Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes: Një vlerë numerike, e cila përfaqëson probabilitetin e një rreziku që të ndodhë. Kjo vlerë përcaktohet nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson një probabilitet shumë të ulët dhe 5 një probabilitet shumë të lartë të ndodhjes së ngjarjes.

Vlerësimi i ndikimit: Një vlerë numerike, e cila përfaqëson ndikimin e rrezikut, nëse ai ndodh, në terma financiarë, shëndetësorë, mjedisorë etj. Po ashtu, kjo vlerë përcaktohet nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson një ndikim të papërfillshëm dhe 5 një ndikim kritik ose tepër të lartë.

Llogaritja e vlerës së rrezikut do të jetë prodhimi i vlerës së mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit, që do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

Vlera e Rrezikut = Mundësia e Ndodhjes * Ndikim

12.1 Mundësia e ndodhjes

Mundësia e ndodhjes mbështetet në probabilitetin që një ngjarje të materializohet. Në vijim, faktorët kyçë, që do të konsiderohen në vlerësimin e mundësisë së ndodhjes, përfshijnë, por nuk limitohen në:

- arkitekturën dhe mjedisin e sistemit të informacionit;
- qasjen në sisteme, qëndrueshmërinë kibernetike, forcën dhe natyrën e kërcënimit;
- dobësitë dhe efektivitetin e kontrolleve ekzistuese etj.

Bazuar në mundësinë e ndodhjes, më poshtë është përcaktuar tabela nr. 2 e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së rreziqeve të ndara në 5 kategori (shumë i ulët (1), i ulët (2), mesatar (3), i lartë (4) dhe shumë i lartë (5)), nëpërmjet mundësisë së materializimit të rrezikut në terma kohorë.

Tabela nr. 2 Mundësia e ndodhjes sipas shpeshtësisë së pritshme të ndodhjes së rrezikut

Mundësia e ndodhjes	Përshkrimi
1	vjetore
2	3-mujore (2–4 herë në vit)
3	mujore (5–12 herë në vit)
4	javore (13–52 herë në vit)
5	ditore (>52 herë në vit)

Tabela nr. 3 prezanton mundësinë e ndodhjes sipas kategorive në terma të triadës së të dhënave CIA.

Tabela nr. 3 Mundësia e ndodhjes sipas kategorive nga 1 deri në 5 dhe triada e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave në total dhe sipas komponentëve përkatës

Kategorizimi		CIA	Konfidencialiteti	Integriteti	Disponueshmeria
1	**Shumë i ulët**	Ka një mundësi shumë të ulët që një kërcënim të materializohet dhe të ndikojë në triadën CIA.	Është shumë e ulët mundësia që informacioni sensitiv të zbulohet në mënyrë të paautorizuar. Proceset dhe teknologjitë e avancuara operojnë efektivisht për të mbrojtur të dhënat.	Është shumë e ulët mundësia që informacioni sensitiv të modifikohet në mënyrë të paautorizuar, falë mekanizmave të fortë të kontrollit të aksesit dhe auditimit.	Është shumë e ulët mundësia që informacioni sensitiv të bëhet i padisponueshëm, si pasojë e marrjes së masave të forta kompensuese.
2	**I ulët**	Ka një mundësi relativisht të ulët që një kërcënim të materializohet dhe të ndikojë në triadën CIA.	Ekziston një probabilitet i ulët që të dhënat konfidenciale të zbulohen, por masat mbrojtëse janë relativisht të mjaftueshme për të parandaluar shumicën e sulmeve.	Ekziston një probabilitet i ulët që të dhënat të kompromentohen, por ka kontrolle dhe masa korrigjuese për të zbuluar dhe për të korrigjuar shpejt modifikimet e paautorizuara.	Ekziston një probabilitet i ulët që një sistem të bëhet i padisponueshëm, por procedurat e mirëmbajtjes dhe të testimit të rregullt ndihmojnë në minimizimin e këtij rreziku.
3	**Mesatar**	Kërcënimet janë të mundshme dhe mund të ndodhin nëse nuk zbatohen masa mbrojtëse.	Është e mundur që informacioni konfidencial të zbulohet pa autorizim, nëse sulmuesit shfrytëzojnë dobësitë e njohura/panjohura. Masat mbrojtëse janë implementuar, por ka nevojë për përmirësime të vazhdueshme.	Ekziston një probabilitet mesatar që të dhënat të ndryshohen në mënyrë të paautorizuar, veçanërisht nëse sulmuesit kanë qasje të brendshme ose shfrytëzojnë dobësitë e sistemit.	Është e mundur që një sistem të bëhet i padisponueshëm, për shkak të ndonjë dështimi teknik.
4	**I lartë**	Kërcënimet janë të mundshme dhe pritet të ndodhin nëse nuk ndërmerren masa parandaluese.	Është e mundshme që të dhënat konfidenciale të ekspozohen për shkak të një sërë faktorësh, përfshirë sulmet e sofistikuara ose dobësitë e brendshme të sistemit. Masat mbrojtëse nuk janë implementuar efektivisht.	Është e mundshme që të dhënat të ndryshohen pa autorizim, veçanërisht dhe vihet re mungesë e implementimit efektiv të masave të kontrollit të aksesit dhe monitorimit të vazhdueshëm.	Ekziston një probabilitet i lartë që një sistem të bëhet i padisponueshëm, për shkak të sulmeve të vazhdueshme ose dështimeve teknike të pajisjeve.
5	**Shumë i lartë**	Kërcënimet janë potencialisht të sigurta që do të ndodhin dhe do të ndikojnë në triadën CIA.	Është pothuajse e sigurt që të dhënat konfidenciale të ekspozohen, nëse nuk merren masa mbrojtëse urgjente dhe të efektshme, sidomos në rastet e sulmeve të sofistikuara	Është pothuajse e sigurt që të dhënat do të ndryshohen pa autorizim, për shkak të mungesës së plotë të kontrolleve të aksesit dhe monitorimit.	Është pothuajse e sigurt që një sistem të bëhet i padisponueshëm për një periudhë të konsiderueshme kohe, veçanërisht nëse ka sulme të sofistikuara që shfrytëzojnë dobësitë e njohura/panjohura ose mungesën e mbrojtjeve të duhura.

12.2. Ndikimi

Vlerësimi i ndikimit do të kryhet bazuar në analizimin e ndikimit, që do të sillte në sigurinë kibernetike të infrastrukturës në hendekun në kapacitetet teknike, procese dhe burime njerëzore, si dhe peshat specifike të përcaktuara për çdo kategori, sipas pyetësorëve që do të dërgohen pranë OIKI-t/OIRI-t nga AKSK-ja të kësaj metodologjie.

Tabela nr. 4 prezanton ndikimin (impaktin) sipas kategorive në terma të triadës së të dhënave: konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

Tabela nr. 4 Mundësia e ndikimit sipas kategorive nga 1 deri në 5 dhe triada e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave në total dhe sipas komponentëve përkatës

Kategorizimi		CIA	Konfidencialiteti	Integriteti	Disponueshmëria
1	Shumë i ulët	Zbulimi i paautorizuar i informacionit, modifikimi, prishja e tij, si dhe ndërprerja e aksesit/përdorimit të sistemeve/rrjeteve teknologjike të informacionit pritet të ketë një ndikim të papërfillshëm për organizatën/kompaninë. Efektet janë lehtësisht të menaxhueshme dhe nuk ka pritshmëri për të shkaktuar dëme ose ndërprerje të shërbimit të ofruar.	Një shkelje e papërfillshme e konfidencialitetit që nuk ndikon të dhënat. Nuk ka efekt, as pasoja për organizatën ose individët.	Ndryshime të papërfillshme dhe të parëndësishme në të dhëna josensitive dhe që nuk ndikojnë në operacione. Nuk ka efekt, as pasoja për organizatën ose individët.	Ndërprerje e vogël ose e parëndësishme, që nuk ndikon në funksionet kritike të biznesit ose shërbimet kryesore. Shërbimi rikthehet shpejt pa ndikime të rëndësishme.

2	I ulët	Zbulimi i paautorizuar i informacionit, modifikimi, prishja e tij, si dhe ndërprerja e aksesit/përdorimit të sistemeve/rrjeteve teknologjike të informacionit pritet të ketë një ndikim të ulët për organizatën/kompaninë. Efektet janë të limituara dhe të menaxhueshme me burimet dhe procedurat ekzistuese për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit.	Një shkelje e papërfillshme e konfidencialitetit, që nuk ndikon të dhënat sensitive. Efekti është minimal dhe nuk ka pasoja për organizatën ose individët.	Ndryshime në të dhëna josensitive dhe që nuk ndikojnë në operacionet. Nuk ka efekt, as pasoja për organizatën ose individët.	Ndërprerje e shërbimit që ndikon në funksionet jokritike. Shërbimi rikthehet brenda një periudhe të shkurtër kohore me pasoja minimale.
3	Moderuar	Zbulimi i paautorizuar i informacionit, modifikimi, prishja e tij, si dhe ndërprerja e aksesit/përdorimit të sistemeve/rrjeteve teknologjike të informacionit pritet të ketë një ndikim të moderuar për organizatën/kompaninë. Efektet në këtë kategori kanë potencialin për të shkaktuar ndërprerje të shërbimeve dhe nëse nuk ndërmerren masa për minimizimin ose eliminimin e tyre.	Shkelje që ndikon në një sasi të dhënash të ndjeshme me efekt të kufizuar. Ekspozimi mund të ketë pasoja negative për individët ose organizatën dhe kërkon masa korrigjuese.	Ndryshime në të dhëna sensitive, që ndikojnë lehtësisht në operacione. Korrigjimi kërkon kohë dhe burime.	Ndërprerje që ndikon në disa funksione kritike. Rimëkëmbja kërkon kohë dhe përpjekje të konsiderueshme me pasoja të moderuara për organizatën.
4	I lartë	Zbulimi i paautorizuar i informacionit, modifikimi, prishja e tij, si dhe ndërprerja e aksesit/përdorimit të sistemeve/rrjeteve teknologjike të informacionit pritet të ketë një ndikim serioz, të lartë për organizatën/kompaninë. Efektet janë të konsiderueshme dhe mund të shkaktojnë ndërprerje të rëndësishme të shërbimit nëse nuk trajtohen brenda një kohe të shkurtër dhe nuk merren masat e duhura në ruajtjen e vazhdimësisë së shërbimit të ofruar.	Një shkelje e rëndësishme që ndikon në një sasi relativisht të madhe të të dhënave sensitive. Pasojat janë të gjera dhe mund të përfshijnë humbje të mëdha financiare ose dëmtim të reputacionit.	Ndryshime të mëdha në të dhëna sensitive, që ndikojnë në operacione dhe vendimmarrje. Korrigjimi kërkon përpjekje të mëdha në kohë dhe burime.	Ndërprerje e rëndësishme, që ndikon në shumicën e funksioneve kritike. Rimëkëmbja është e komplikuar dhe kërkon burime të mëdha, me pasoja të rënda për organizatën.
5	Shumë i lartë/kritik	Zbulimi i paautorizuar i informacionit, modifikimi, prishja e tij, si dhe ndërprerja e aksesit/përdorimit të sistemeve/rrjeteve teknologjike të informacionit pritet të ketë një ndikim jashtëzakonisht të rëndë, kritikë për organizatën/kompaninë. Efektet e ndikimit janë në nivelin më të lartë dhe kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Ekziston potenciali shumë i lartë për dëme serioze, të pariparueshme, duke rrezikuar vazhdimësinë e punës dhe ofrimin e shërbimit përtej kohës së toleruar.	Një shkelje shumë e rëndë që ndikon në një sasi të konsiderueshme të dhënash sensitive. Pasojat janë katastrofike, duke përfshirë humbje të mëdha financiare, dëmtim të reputacionit dhe pasoja ligjore.	Ndryshime thelbësore në të dhënat sensitive që kompromentojnë rëndë operacionet dhe vendimmarrjen. Pasojat janë katastrofike dhe kërkojnë përpjekje të gjera për rikuperim dhe korrigjim.	Ndërprerje shumë e rëndë që ndikon në të gjitha funksionet kritike. Rimëkëmbja është jashtëzakonisht e komplikuar dhe kërkon burime të jashtëzakonshme, me pasoja katastrofike për organizatën.

12.3 Vlerësimi i rrezikut

Qëllimi i një matrice rreziku, e cila kombinon mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin në një metrikë të vetme (mundësi e ndodhjes * ndikim), është vlerësimi dhe prioritizimi i rreziqeve në mënyrë efektive.

Qëllimi i vlerësimit të rrezikut është prioritizimi i rreziqeve dhe vendimmarrja se cilat rreziqe mund të pranohen dhe cilat duhet të trajtohen. Rreziku, i cili, nga prodhimi i mundësisë së ndodhjes dhe ndikimi, do të klasifikohet si "shumë i ulët" dhe "i ulët", do të konsiderohet si rrezik i pranuar nga AKSK-ja, ndërsa për kategoritë e tjera të rrezikut, infrastrukturat e rëndësishme dhe kritike të informacionit janë përgjegjëse për përcaktimin e planit të trajtimit dhe zbutjes, duke u bazuar në metodologjitë përkatëse të operatorëve.

Matrica në tabelën 5 tregon klasifikimet e rrezikut, ku zonat jeshile tregojnë se rreziku është në pragun e pranueshëm, zonat e verdhë, portokalli dhe e kuqe tregojnë se një rrezik nuk përmbush kriteret e pranimit nga AKSK-ja dhe, si rrjedhojë, duhet trajtuar me masat përkatëse për zbutjen e tij. Tabela nr. 6 prezanton prioritizimin e trajtimit sipas matricës së rrezikut.

Tabela nr. 5 Prodhimi sasior i mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit

Rreziku = Mundësia e ndodhjes * Ndikim

MUNDËSIA		NDIKIMI				
		Shumë i ulët (1)	I ulët (2)	Mesatar (3)	I lartë (4)	Shumë i lartë (5)
	Shumë i ulët (1)	1	2	3	4	5
	I ulët (2)	2	4	6	8	10
	Mesatar (3)	3	6	9	12	15
	I lartë (4)	4	8	12	16	20
	Shumë i lartë (5)	5	10	15	20	25

Rreziqet do të prioritizohen për trajtim nga OIKI/OIRI, sipas prodhimit sasior dhe klasifikimit të tyre, në mënyrë që rreziqet me prodhim sasior **"I lartë"** apo "**Shumë i lartë**" rekomandohen të trajtohen para rreziqeve me nivele më të ulëta për operatorët e infrastrukturave.

Tabela nr. 6 Prioritizimi i trajtimit sipas matricës së rrezikut

Vlera e rrezikut	Niveli i rrezikut	Koha e trajtimit
[1-3]	Shumë i ulët	Nuk ka nevojë për trajtim
[4-6]	E ulët	Nuk ka nevojë për trajtim
[7-11]	Mesatar	Ka nevojë për trajtim deri në 12 muaj
[12-19]	I Lartë	Ka nevojë për trajtim deri në 6 muaj
[20-25]	Shume i lartë	Ka nevojë për trajtim deri në 3 muaj

VENDIM
Nr. 315, datë 4.6.2025

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT POLITIK PËR MOSHIMIN DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2025–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin dhe të planit të veprimit 2025–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në Dokumentin Politik për Moshimin dhe në planin e veprimit, për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DRAFTDOKUMENTI POLITIK PËR MOSHIMIN DHE PLANI I VEPRIMIT 2025–2030

Tabela e përmbajtjes
Hyrje
Lista e shkurtesave
PJESA I – KUADRI POLITIK, INSTITUCIONAL DHE SOCIAL I VENDIT
1.1. Kuadri ekonomi
1.2. Vështrim i përgjithshëm mbi situatën demografike
1.3. Kuadri social
2. Reformimi i politikave shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe të pensioneve për një jetë dinjitoze të të moshuarve
3. Arritje të planit të veprimit 2020–2024
PJESA II – KONTEKSTI STRATEGJIK
1. Kuadri politik, strategjik dhe institucional
2. Qëllimi, vizioni dhe parimet mbi të cilat mbështetet PKVM-ja
3. Procesi i zhvillimit të planit të veprimit dhe metodologjia e përdorur

PJESA III – QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, MASAT PRIORITARE DHE TREGUESIT E NDIKIMIT
1. Politika A: Mbrojtja ekonomike dhe sociale e të moshuarve në nevojë
1.1. Qëllimi i politikës A
1.2. Rezultati i pritshëm
1.3. Objektivat specifikë
1.4. Aktivitetet sipas objektivave specifikë
2. Politika B: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për moshimin
2.1. Qëllimi i politikës B
2.2. Rezultati i pritshëm
2.3. Objektivat specifikë
2.4. Aktivitetet sipas objektivave specifikë
PJESA IV – MONITORIMI I PLANIT KOMBËTAR
4.1. Mekanizmat e zbatimit dhe koordinimit
4.2. Monitorimi dhe vlerësimi
PJESA V – Vlerësimi i kostove dhe burimet financiare për zbatimin e planin e veprimit të moshimit 2025–2030

Hyrje

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe e koordinuar nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), ka marrë iniciativën të përgatisë Planin Kombëtar të Veprimit për Moshën e Tretë, për periudhën 2025–2030.

Plani i Veprimit për Personat e Moshuar 2025–2030, synon të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve në Shqipëri. Ky plan vjen në një moment të rëndësishëm për vendin, ndërsa Shqipëria përparon në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian dhe përballet me sfida të thella demografike dhe ekonomike, që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e të moshuarve.

Përfundimi i planit të mëparshëm ka krijuar nevojën për një strategji të re dhe më të avancuar, duke reflektuar ndryshimet në strukturën shoqërore dhe prioritetet e politikave publike. Deri më tani, politikat për mbrojtjen e të drejtave të personave të moshuar, pavarësisht arritjeve, nuk kanë mundur të trajtojnë me përparësi nevojat më kritike të moshës së tretë. Megjithatë, ndryshimet demografike të theksuara dhe kushtet e vështira ekonomike për të moshuarit, përfitues të pensioneve urbane, rurale ose sociale, kanë bërë që qeveria t'i japë një rëndësi më të madhe zhvillimit të politikave të dedikuara për këtë grup-moshë.

Ky plan veprimi mbështetet në parime të tilla, si: të drejtat e barabarta, integrimi social, përmirësimi i kujdesit shëndetësor, garantimi i aksesit në shërbimet sociale dhe mbështetjen institucionale. Në bashkëpunim me institucionet qeveritare, organizatat joqeveritare dhe komunitetin, synojmë të krijojmë politika dhe masa konkrete që promovojnë pavarësinë, pjesëmarrjen aktive dhe mirëqenien e të moshuarve.

Plani përfshin masa për përmirësimin e kushteve të jetesës, akses më të mirë në shërbimet e integruara shëndetësore e sociale, mbështetje psikosociale, mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna, si dhe inkurajimin e angazhimit aktiv të të moshuarve, në jetën sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, theksohet nevoja për zhvillimin e politikave afatgjata, që mbështesin, moshimin aktiv dhe të shëndetshëm, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Ky dokument paraqet një angazhim të qartë për të siguruar që çdo person i moshuar të gëzojë të drejta të plota, mbështetje dhe respekt në të gjitha aspektet e jetës. Përmes zbatimit efektiv të këtij plani të veprimit, synojmë të ndërtojmë një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse për të gjithë brezat.

Lista e shkurtesave

ASCK	Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore dhe Shoqërore
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AZHBR	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

MIS	Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Social
MF	Ministria e Financave
MIPAA/RIS	Plani Ndërkombëtar i Veprimit i Madridit mbi Moshimin, si edhe Strategjia Rajonale e Zbatimit (RIS) për Rajonin UNECE.
SKMS	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
NJVKSH	Njësia e Vlerësimit të Kujdesit Shëndetësor
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
OJF	Organizata jofitimprurëse
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PKVM	Plani Kombëtar për Veprimin i Moshimit
QSH	Qendër Shëndetësore
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PJESA I
KUADRI POLITIK, INSTITUCIONAL DHE SOCIAL I VENDIT

Shqipëria, si shumë vende të tjera, po përjeton një zhvendosje të shpejtë demografike. Midis censeve 1989 dhe 2023 përqindja e njerëzve të moshës 65+ u rrit nga rreth 5.3% në 19.7%.

Të dhënat e censit 2023 tregojnë se një në pesë individë (19,7 për qind) janë 65 vjeç e lart, krahasuar me një në nëntë individë (11,3 për qind) në censin e vitit 2011 dhe 7,5 për qind në censin e 2001-shit.[5]

Parashikimet tregojnë se kjo do të arrijë në 26.4% deri në vitin 2050. Kjo prirje sjell implikime të rëndësishme për mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor dhe sistemet e mbështetjes ekonomike, si dhe ndikon në mundësitë e nxitjes së zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Raporti i varësisë për të moshuarit është rritur, nga 16.4% në 2011[6] në 24.4% në 2023. Në vitin 2023, raporti i varësisë së të moshuarve tejkaloi atë të të rinjve[7].

Çështjet që lidhen me krijimin e një mjedisi mbrojtës për individë në nevojë, gradualisht janë përfshirë në listën e prioriteteve të qeverisë shqiptare gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Pikëpamja mbi mbrojtjen sociale të grupeve në nevojë ka ndryshuar, nga njohja e të drejtave të tyre, në respektimin dhe garantimin e këtyre të drejtave. Sidoqoftë, trashëgimia e varfër e të kaluarës si edhe problemet ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë, kanë përcaktuar edhe drejtimet e politikave sociale të Shqipërisë. Si rezultat i situatës ekonomike dhe shoqërore, si edhe i dukurive që lidhen me tranzicionin, individë dhe grupe të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, përballen me shumë dukuri kritike që ndikojnë në mohimin, përjashtimin apo mosrespektimin e të drejtave të tyre.

Referuar censit 2023 popullsia 65+ është 473.104 ose 19.7%[8]

Braktisja e vendit me ritme të shpejta, sidomos nga të rinjtë, përveç se ka ndryshuar ndjeshëm strukturën demografike, ka shkaktuar edhe rritjen e numrit të të moshuarve që jetojnë vetëm ose në varfëri, gjë e cila në ndërveprim me barriera të ndryshme (si kushte të veçanta shëndetësore ose infrastruktura e dobët), pengon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri.

Në këtë kontekst, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në cilësinë e institucionit përgjegjës për Politikat e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, me mbështetjen e UNFPA-së, si edhe të gjithë grupeve të interesit, përgatit Dokumentin Politik të Moshimit 2025–2030 dhe Planin e tij të Veprimit.

[5] cens-2023.pdf

[6] https://www.instat.gov.al/media/3057/instat_paraprake.pdf

[7] https://www.instat.gov.al/media/14303/cens-2023.pdf

[8] https://www.instat.gov.al/media/14303/cens-2023.pdf

1.1. Kuadri ekonomik

Gjatë periudhës 2020–2024, ekonomia e Shqipërisë ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme. Prej vitit 2019, ekonomia shqiptare ka mundur të përballojë disa kriza dhe të sigurojë një rritje të qëndrueshme. Tërmeti i vitit 2019 dhe situata pandemike e krijuar nga COVID-19, shkaktuan rënien ekonomike prej 3.31% në vitin 2020. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) pësoi rritje të ndjeshme në vitin 2021 (8.97%) dhe ndonëse lufta në Ukrainë krijoi kushte të pafavorshme për ekonominë për shkak të krizës në tregun e mallrave dhe të shërbimeve dhe rritjes së inflacionit (mesatarisht 7.4% në vitin 2022), ekonomia shqiptare ishte e aftë të rritej me 4.83% për vitin 2022.

Ndonëse rritja ekonomike u ngadalësua në 3.94% në vitin 2023, kryesisht për shkak të dobësimit të konsumit dhe investimeve private, në vitin 2024, ekonomia shënoi një rritje prej 3.96%, e nxitur nga sektori i turizmit, ndërtimit dhe rritja e konsumit privat. Për sa i përket inflacionit, pas një rritjeje në vitet e mëparshme, ai ka shënuar një tendencë rënëse, duke u ulur në 1.9% në shtator 2024, dhe pritet të stabilizohet pranë objektivit prej 3% të Bankës së Shqipërisë në vitin 2025[9].

Kontributi kryesor në rritjen e PBB-së, i atribuohet zgjerimit të aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektorët e industrisë dhe të bujqësisë kanë pasur një ecuri më të ngadaltë dhe më të luhatshme.

Gjatë periudhës 2020–2024, konsumi privat dhe investimet në Shqipëri kanë pësuar ndryshime të rëndësishme. Ndonëse Pandemia COVID-19, shkaktoi një tkurrje të konsumit privat dhe investimeve, për shkak të masave kufizuese dhe pasigurisë ekonomike, gjatë vitit 2021, me lehtësimin e masave dhe rimëkëmbjen ekonomike, konsumi privat dhe investimet filluan të rriten, duke kontribuar në një rritje ekonomike prej 8.97%. Gjatë vitit 2022, rritja e çmimeve dhe pasiguria globale, ndikuan negativisht në konsumin privat dhe investimet, duke çuar në një ngadalësim të rritjes ekonomike, situatë e cila vijoi edhe në vitin 2023, që rezultoi në rritjen ekonomike prej 3.94%. Që nga fillimi i vitit 2024, sektori i turizmit dhe ndërtimit u rritën, duke nxitur konsumin privat dhe investimet, dhe duke çuar në një rritje ekonomike prej 3.96%.

Ruajtja e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë ekonomike, ndikimi i masave për uljen e varfërisë dhe nxitjen e përfshirjes sociale, është një nga përparësitë kyçe të qeverisë, sepse këto masa do të ndihmojnë në çlirimin e potencialit të konsiderueshëm njerëzor të pashfrytëzuar në Shqipëri, si dhe uljen e ndikimit pengues të pabarazisë mbi rritjen ekonomike.

1.2. Vështrim i përgjithshëm mbi situatën demografike

Popullsia banuese në Shqipëri, sipas censit 2023 rezultoi 2.402.113, prej të cilëve 49,6 për qind janë meshkuj dhe 50,4 për qind femra. Referuar Censit të Popullsisë dhe Banesave 2011, popullsia banuese në Shqipëri ishte 2.821.977, me një rënie prej 420 mijë banorë. Kjo rënie përshtatet me trendin e vërejtur gjatë tri dekadave të fundit, që prej censit të vitit 1989.

Dinamikat e popullsisë përcaktohen nga katër faktorë: lindjet, vdekjet, emigrimi dhe imigrimi. Efekti i secilit prej tyre në numrin e popullsisë jepet në ekuacionin e bilancit të popullsisë: P2023 = P2011 + L – V + I – E, ku P2023 dhe P2011 janë përkatësisht numri i popullsisë sipas censeve 2023 dhe 2011. Popullsia e Shqipërisë nisi të zvogëlohet që prej vitit 1990, i cili shënoi një fazë të re në zhvillimin politik, ekonomik dhe demografik të Shqipërisë. Para vitit 1990, vendi përjetoi një rritje të qëndrueshme të popullsisë. Gjatë periudhës pasuese, normat e ulëta të lindshmërisë dhe emigracioni ishin faktorët kryesorë, që kontribuan në zvogëlimin e popullsisë. Gjatë periudhës midis censeve 2001–2011, vlerësohet se rreth 500 mijë individë emigruan nga Shqipëria, një mesatare prej rreth 50 mijë individë në vit. Ky trend emigracioni qëndron pothuajse i njëjtë me mesatarisht 50 mijë emigrant në vit. Numri i lindjeve ka ardhur në rënie, nga 53 mijë në vitin 2001 në 34 mijë në vitin 2011, ndërsa, numri i vdekjeve në këtë periudhë mbeti në nivele të qëndrueshme, rreth 20 mijë vdekje në vit, duke rezultuar me një shtesë natyrore pozitive. Gjithashtu, referuar periudhës 2011–2023, popullsia e Shqipërisë karakterizohej nga një shtesë natyrore pozitive deri në vitin 2020 dhe në vitin 2021 mbas pandemisë COVID-19, numri i vdekjeve tejkaloi numrin e lindjeve. Për vitin 2023, nga të dhënat administrative rezultuan rreth 24 mijë lindje dhe 22

[9] INSTAT, 2025.

mijë vdekje, duke shënuar rikthim në shtesën natyrore pozitive.

Faktorët ndikues të lindjeve, vdekjeve dhe migracionit ndërkombëtar/brendshëm sollën ndryshimin e strukturës së popullsisë, në censin e 2023[10]. Piramida e popullsisë bazuar në censin e 2023,[11] së bashku me atë të censit 2011 të spostuar me 12 vjet lart, thekson zhvillimet në strukturën e popullsisë, sipas moshës dhe gjinisë.

Duke analizuar grup-moshën 50–69 vjeç në piramidën e popullsisë, vërehet një zgjerim që përputhet me një periudhë lindjesh, midis mesit të viteve 1950–1970. Shqipëria gjatë kësaj periudhe është karakterizuar nga një rritje e normave të lindshmërisë, njohur si *"baby boom"*. Normat e ulëta të lindshmërisë dhe trendi në rënie, kombinuar me emigracionin e popullsisë në moshë riprodhuese, solli ngushtimin e bazës së piramidës së popullsisë. Lindshmëria nën nivelin e zëvendësimit prej vitit 2001, rritja e jetëgjatësisë, si dhe migracioni mbeten faktorët kryesorë të moshimit të popullsisë. Të dhënat e censit 2023 tregojnë se një në pesë individë (19,7 për qind) janë 65 vjeç e lart, krahasuar me një në nëntë individë (11,3 për qind) në censin e vitit 2011 dhe 7,5 për qind në censin e 2001.

Tranzicioni drejt një popullsie më të vjetër, vihet re edhe në raportet e varësisë. Raporti i varësisë së të rinjve[12] pësoi rënie në 24,0 për qind nga 30,4 për qind vlerësuar në censin e 2011-s dhe raporti i varësisë së të moshuarve[13], pësoi rritje në 30,4 për qind nga 16,7 për qind më 2011-n. Nga analiza e realizuar në nivel qarku, Kukësi dhe Gjirokastra mbajnë pozicione të kundërta, në termat e raporteve të varësisë: Kukësi ka raportin e varësisë së të rinjve më të lartë (31,8 për qind) dhe raportin më të ulët të varësisë së të moshuarve (19,9 për qind). Ndërkohë që Gjirokastra ka raportin e varësisë së të rinjve më të ulët (19,0 për qind) dhe raportin më të lartë të varësisë së të moshuarve (46,1 për qind). Mosha mesatare e popullsisë është 42,5 vjeç, nga 35,3 vjeç që ishte në censin 2011. Në vitin 2023 kishte 102.5 individë të moshuar për 100 të rinj.

Raporti gjinor i popullsisë rezulton 98,2 (numri i meshkujve për 100 femra). Ky raport është më i ulët se vlerësimi global i njohur (101,0)[14], por më i lartë së raporti gjinor i BE-së, i vlerësuar në 2022 prej 95,64[15]. Në moshat e vogla deri në 10 vjeç, numri i meshkujve tejkalon atë të femrave, me një raport gjinor më të lartë se 108. Ky raport përmbyset në moshat 40 dhe pas të 80-ve, me një rënie të madhe, për shkak të jetëgjatësisë së lartë të femrave, krahasuar me meshkujt. Raporti gjinor në popullsinë mbi 80 vjeç është 82,1, si dhe pesë në gjashtë individë të moshës 100 vjeç e lart janë femra.

1.3. Kuadri social

Në Planin Kombëtar për Integrim Evropian[16] 2023–2025, për kapitullin 19, "Politikat sociale dhe punësimi", theksohet se:

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (SKMS 2015–2023), procesi i zhvillimit institucional u bazua në një rishikim të plotë të funksioneve ekzistuese të programeve të bazuara në cash (NE dhe aftësisë së kufizuar), si dhe të funksioneve të menaxhimit të shërbimeve të kujdesit social. Pushteti vendor ka një rol parësor, në ngritjen dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit social, që ofrohen për personat vulnerabël. Reforma e kujdesit social inicioi me miratimin e ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", i cili përcaktoi shportën e shërbimeve, me fokus shërbimet komunitare (VKM nr. 518/2018); përcaktimin e roleve të pushtetit qendror dhe atij vendor, që synon ngritjen e njësive të vlerësimit dhe referimit të rasteve; ngritjen dhe funksionimin e një sistemi elektronik të integruar të shërbimeve shoqërore (VKM nr. 136/2018); krijimin e një mekanizmi mbështetës financiar (Fondi Social i krijuar me VKM-në nr. nr. 111/2018, i ndryshuar me VKM nr. 613, datë 2.10.2024 dhe metodologjia e llogaritjes/shpërndarjes së fondeve VKM nr. 150/2019, ndryshuar me VKM-në nr. 224, datë 9.4.2024), për të mundësuar mbulimin më të mirë të nevojave të individit/familjes me ofrimin e shërbimeve më pranë tyre.

Të dhënat tregojnë një angazhim të vazhdueshëm të qeverisë shqiptare, për të mbështetur shtresat në nevojë dhe për të siguruar një sistem mbrojtjeje sociale efektive, gjatë

[10] https://www.instat.gov.al/media/14303/cens-2023.pdf
[11] cens-2023.pdf
[12] Raporti i numrit të individëve nën moshën e punës (0–14 vjeç), me numrin e individëve në moshë pune (15–64 vjeç), shprehur në përqindje.
[13] Raporti i numrit të individëve të moshuar, mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e individëve në moshë pune (15–64 vjeç), shprehur në përqindje.
[14] World Bank estimates: https://databank.worldbank.org/source/population-estimates-and-projections#
[15] https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-population/demography-2023#more-women-than-men
[16] https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN-2023-2025.pdf

periudhës 2020–2024. Shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe kanë pasur një peshë të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, duke reflektuar angazhimin për të mbështetur shtresat në nevojë dhe për të siguruar mirëqenien sociale. Sipas një analize të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, shpenzimet për mbrojtjen sociale për vitin 2020, ishin pak më shumë se 40% e buxhetit total. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve (26.3%) u përdor për sigurimet shoqërore[17]. Në periudhën e pas krizës COVID-19, funksioni i mbrojtjes sociale zë 29.30% të totalit të shpenzimeve, duke përfaqësuar peshën më të lartë ndër funksionet publike[18].

Sistemi i mbrojtjes shoqërore në Shqipëri ka pësuar reformim të thellë, shumëdimensional e cilësor, duke synuar përafrimin e ofrimit të shërbimeve në përputhje me nevojën, sipas grupeve dhe shpërndarjes gjeografike.

Ndihma ekonomike dhe përfitimet e tjera. Përgjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka avancuar në reformimin e programit të asistencës sociale, që është skema kryesore e mbështetjes sociale me vlerë monetare për familjet e varfra në Shqipëri, ndërsa ka demonstruar një angazhim serioz në përmirësimin e efektivitetit, eficiencës dhe transparencës të programeve të asistencës sociale. Procesi reformues nisi për të adresuar problematikat e vërejtura të programit, si përjashtimi nga skema të aplikative, procese të ndërlikuara të aplikimit, sisteme dhe kapacitete të dobëta të mbikëqyrjes, kontrollit dhe informacionit.

Zbatimi i programit të reformuar ka racionalizuar procesin e aplikimit dhe të përzgjedhjes së përfituesve të Ndihmës Ekonomike, ka përmirësuar dukshëm procesin e shënjestrimit dhe të përzgjedhjes së familjeve, që janë në nevojë, duke përdorur një formulë pikëzimi *(proxy means test)* të inkorporuar në një Sistem Informativ të Menaxhimit, që administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), ka rritur rolin e pushtetit vendor në administrimin e programit të ndihmës, si dhe në vendimmarrjen e drejtpërdrejtë për familjet, që padrejtësisht mund të rezultojnë të përjashtuara, për shkak të formulës së pikëzimit, por që janë në nevojë për mbështetje duke i vendosur në dispozicion fondin prej 6% të buxhetit të Ndihmës Ekonomike, për ofrimin e kësaj pagese. Ai ka rritur pagesat për familjet përfituese më të shenjestruara, ka eliminuar pagesat e pjesshme dhe është fokusuar në Programin Kombëtar për daljen nga skema e ndihmës ekonomike, veçanërisht sa i takon riintegrimit ekonomik në tregun e punës, të përfituesve të Ndihmës Ekonomike në moshë pune.

Në vitin 2023, 36,4 % e popullsisë do të vlerësohej në rrezik për të qenë të varfër, nëse te të ardhurat e disponueshme do të përjashtoheshin të gjitha përfitimet sociale (duke përfshirë edhe pensionet e pleqërisë/familjare) krahasuar me 37,9% që ishte në vitin 2020. Nëse në nivelin e të ardhurave të disponueshme do të përfshiheshin pensionet e pleqërisë/familjare, por jo përfitime të tjera sociale, rreziku për të qenë i varfër do të vlerësohej 23,3 % krahasuar me 24,8% që ishte në vitin 2020.

Aftësia e kufizuar. Programi i mbështetjes së aftësisë së kufizuar, gjatë viteve të fundit, ka kaluar në një proces reformimi. Reforma e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, u mbështet në përvojën ndërkombëtare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në sistemin jokontribues, duke marrë në konsideratë kontekstin kulturor, socioekonomik, legjislativ dhe politiko-administrativ të Shqipërisë. Ajo u mbështet në Dokumentin Politik mbi Reformën e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe në Planin e Veprimit 2019–2024, që shërbeu si udhërrëfyes për aplikimin dhe shtrirjen e reformës në të gjithë vendin.

Për personat me aftësi të kufizuara u indeksuan pagesat në vitin 2020 me 1.8%, në vitin 2021 me 2.2 % dhe në vitin 2022 me 7.5 %. Gjithashtu, një rritje prej 1000 lekësh është bërë si një mbështetje shtesë për energjinë për kategoritë para- dhe tetraplegjikë dhe të verbrit. Nga kjo rritje përfituan 11,411 individë. Skema e re e aftësisë së kufizuar e rrit këtë indeksim në 150% të pensionit social për çdo vit.[19] Nga viti 2023 indeksimi për pagesat e PAK-së bëhet në bazë të indeksimit të pensionit social, ndërsa për paratetraplegjikët dhe të verbrit, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit, përkatësisht në vitin 2023 – 4,2% dhe në vitin 2024 – 2,1%.

[17] https://qeverisjavendore.gov.al
[18] Open Data Albania.
[19] Reflektuar koment i Drejtorisë së Politikave të Mbrojtjes Sociale në MSHMS.

Shërbimet e kujdesit social[20]**.** Me zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2020–2023, Shqipëria ka avancuar me reformimin e sistemit të shërbimeve sociale, duke zhvilluar një qasje të integruar dhe decentralizuar në ofrimin e kujdesit social, paralelisht dhe në mbështetje të skemave të reformuara të asistencës sociale (përkatësisht, NE dhe PAK), si dhe në funksion të fuqizimit të individit dhe familjes, për kapërcimin e situatave të përjashtimit social dhe riintegrimin. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në vitet e fundit, është udhëhequr nga tri parime thelbësore, përshkruar, gjithashtu, si Reforma 3D-dimensionale (deinstitucionalizim, diversifikim dhe decentralizim).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të reformës së kujdesit social, ka përfshirë si reformë prioritare edhe programin e digjitalizimit të shërbimeve të kujdesit social, me përfshirjen e të gjithë aktorëve në nivel qendror dhe vendor. Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Social (MIS) është një sistem informacioni i integruar për administrimin (identifikimin, referimin, ndërhyrjen dhe monitorimin) e shërbimeve të kujdesit social, duke përdorur një mekanizëm unik identifikimi me një logim të vetëm, për të tria sistemet e informacionit. Ndihma ekonomike; personat me aftësi të kufizuara dhe shërbime sociale.

Qëllimi i funksionimit i MIS-së është: i. lehtësimi i procedurave për aplikantët dhe shmangia e burokracive; ii. marrja e informacionit për çdo qytetar aplikues në kohë reale; iii. menaxhimi dhe ndjekja e rasteve nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, duke ndërvepruar me çdo nivel lokal ose qendror; iv. të rrisë cilësinë dhe transparencën e shërbimeve të ofruara; v. të mbledhë dhe përpunojë të dhëna të unifikuara cilësore dhe në kohë reale.

Pensionet: Reforma e pensioneve në Shqipëri, e iniciuar në vitin 2014 synoi përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe drejtësisë sociale, në sistemin e sigurimeve shoqërore. Ndryshimet kryesore përfshinin rritjen graduale të viteve të kontributit nga 35 në 40 deri në vitin 2029, si dhe rritjen e moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj në vit, për të arritur në 63 vjeç në vitin 2032. Pas këtij viti, mosha e daljes në pension për burrat do të rritet me një muaj në vit dhe për gratë me dy muaj në vit, duke arritur në 67 vjeç për të dy gjinitë në vitin 2056. Njëkohësisht, u hoq tavani i pensionit maksimal dhe u unifikuan skemat urbane dhe rurale, duke synuar një sistem më të drejtë dhe të qëndrueshëm financiarisht.

Në vijim, qeveria ka ndërmarrë hapa për të rritur nivelin e pensioneve. Në vitin 2024 u miratua një rritje prej 4.1 % e pensioneve, duke tejkaluar inflacionin prej 1.6%, që përfaqëson një rritje reale të përfitimeve. Kjo rritje përfshiu pensionet e plota, të pjesshme, të reduktuara, të parakohshme të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare, si në qytet ashtu edhe në fshat. Gjithashtu, u planifikua që pensioni minimal të arrijë në 17 888 lekë dhe pensioni social 9 710 lekë, duke synuar përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe sigurimin e një standardi jetese më të lartë për ta.

Kujdesi shëndetësor: Reforma e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, ka qenë një proces i vazhdueshëm, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për qytetarët. Një nga hapat kryesorë ishte miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025, e cila synon forcimin e kujdesit shëndetësor parësor, (KSHP) për të reduktuar nevojën për shërbime spitalore të shmangshme dhe për të ofruar shërbime të bazuara në fakte, duke trajtuar pabarazitë dhe duke mbuluar grupet vulnerabël.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030 dhe dokumentet e saj strategjike, kanë synuar përmirësimin e shëndetit publik, përmes programeve të parandalimit të sëmundjeve jo të transmetueshme, kontrollit të kancerit dhe vaksinimit kundër COVID-19. Këto politika kanë rritur aksesin në shërbime pa pagesë, për komunitetet vulnerable, si komuniteti rom, egjiptian, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe popullatat rurale.

Programet për shërbimet spitalore dhe paraspitalore kanë synuar modernizimin e spitaleve publike, përmirësimin e infrastrukturës dhe zgjerimin e shërbimeve në spitalet rajonale, për të garantuar trajtim të shpejtë dhe cilësor afër vendbanimeve të qytetarëve. Investimet përfshijnë pajisje të reja biomjekësore, financimin e urgjencës

[20] Raportprogresi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019–2023.

kombëtare mjekësore dhe zgjerimin e flotës së urgjencës paraspitalore, me 218 autoambulanca në shërbim. Këto masa synojnë përmirësimin e përgjigjes ndaj emergjencave, si dhe garantimin e diagnostikimit, trajtimit dhe rehabilitimit të pacientëve në të gjithë vendin.

Pavarësisht rritjes së buxhetit për sektorin e shëndetësisë me mbi 80% gjatë dekadës së fundit, shpenzimet publike për shëndetësinë në Shqipëri mbeten në nivelin 3.1% të PBB-së[21], nën mesataren e vendeve të BE-së prej 8%. Komisioni Evropian vlerëson se sistemi shëndetësor në Shqipëri është i nënfinancuar dhe rekomandon, që shpenzimet publike për shëndetësinë të arrijnë në 12% të shpenzimeve totale publike, për të lejuar zgjerimin e paketës së shërbimeve të mbuluara nga fondet publike dhe për të siguruar një paketë të plotë shërbimesh të KSHP-së për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga statusi i tyre i sigurimit shëndetësor.

2. Reformimi i politikave shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe të pensioneve për një jetë dinjitoze të të moshuarve

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale[22] 2024–2028, ka në fokus krijimin e mekanizmave institucionalë për monitorimin dhe reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social, i cili do të shoqërohet me politika publike të targetuara dhe akses në të drejta dhe shërbime, që mundësojnë pjesëmarrjen në shoqëri, përfshirjen sociale efektive dhe diversitet social. Përmirësimi i treguesve në vazhdimësi, përmes rishikimit periodik të kuadrit dhe analizës së kontekstit të politikave në dinamikën e tyre sociale, si dhe përmes krijimit të kapaciteteve teknike dhe administrative për zbatimin e këtij plani kombëtar për moshimin, si pjesë e Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale, rrit efikasitetin në mbledhjen e të dhënave. Me këtë synohet, përmirësimi i njohurive analitike dhe rritja e ndërgjegjësimit, mbi rëndësinë që ka mbrojtja dhe përfshirja sociale dhe jeta dinjitoze e të moshuarve për kohezionin social, zhvillimin ekonomik dhe politik të Shqipërisë, në kontekstin e procesit të anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian (BE).

Shqipëria ka bërë progres në mbrojtjen e të drejtave, dinjitetit dhe pavarësisë së të moshuarve, si prioritet kombëtar, për më shumë se 30 vjet. Akti i Sigurimeve Shoqërore u miratua në vitin 1993, për të mbështetur mirëqenien ekonomike dhe të përgjithshme të të moshuarve. Më pas në vitin 2011 u miratua ligji "Për ofrimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë". Tashmë është e pranuar se moshimi i shoqërisë i jep parandalimit shëndetësor dhe zbulimit të hershëm një rol vendimtar në rritjen e cilësisë së jetës, ndërsa në të njëjtën kohë përmban kosto mjekësore. Programi i ri i kontrollit *(check up),* i prezantuar në vitin 2015, është një investim për një cilësi më të mirë për jetën e individit, duke përmirësuar aksesin e tyre në kujdesin bazë shëndetësor. Në të njëjtën kohë, ekziston një ndërgjegjësim i qartë për përfshirjen e shërbimeve, detyrave dhe burimeve specifike për kujdesin e përkushtuar për të moshuarit.

Të dhënat demografike dhe shëndetësore tregojnë se jetëgjatësia e shqiptarëve ka vazhduar të rritet duke qenë ndër më të lartat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, vdekshmëria e standardizuar sipas moshës, nga shumica e sëmundjeve jo të transmetueshme, gjatë dhjetë vjetëve të fundit ka filluar të bjerë. Reformat shëndetësore dhe sociale e kanë ndihmuar Shqipërinë të vazhdojë të jetë një vend që ka arritur "shëndet të mirë me kosto të ulët", me një jetëgjatësi shumë të lartë, duke pasur parasysh nivelin e saj të zhvillimit ekonomik.

Gjatë periudhës 2020–2024, politikat e kujdesit shëndetësor në Shqipëri janë fokusuar në përmirësimin e shërbimeve për të moshuarit, me qëllim garantimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës për këtë grup të rëndësishëm të shoqërisë. Një nga hapat kryesorë ka qenë rritja e aksesit në shërbimet shëndetësore pa pagesë, veçanërisht për ata që jetojnë në zona rurale ose janë pjesë e grupeve vulnerabël, si komuniteti rom dhe egjiptian. Politikat e rimbursimit të barnave, ku përfshihen terapitë për sëmundjet kronike, kanë mbuluar plotësisht më shumë se 450,000 qytetarë kronikë, duke përfshirë shumë të moshuar, që kanë nevojë për trajtim të rregullt dhe të përshtatshëm.

Me vendimin nr. 492, datë 24.7.2024, "Për një ndryshim në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme', të ndryshuar", qeveria miratoi rimbursimin nga Fondi

[21] https://shëndetsia.gov.al

[22] Vendim nr. 544, datë 28.8.2024, për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale 2024–2028.

i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të fishave të diabetit për pacientët e grup-moshës 0–25 vjeç dhe nga 65 vjeç e më shumë, si dhe invalidët e punës dhe personat me aftësi të kufizuara të grup-moshës 25–65 vjeç, ku janë 50 mijë të moshuar mbi 65-vjeç, që përfitojnë nga kjo paketë.

Reforma në kujdesin parësor dhe modernizimi i qendrave shëndetësore, duke i bërë ato të aksesueshme dhe të përditësuara, ka sjellë përfitime të mëdha për të moshuarit. Qendrat e mjekësisë familjare, që ofrojnë shërbim 24 orë dhe kujdes socioshëndetësor, janë një hap përpara për këtë grup, pasi ato mundësojnë ofrimin e shërbimeve të integruara për trajtimin e problemeve të shëndetit mendor dhe fiziologjik, që janë më të shpeshta te të moshuarit. Po kështu me krijimin e protokolleve të reja, për trajtimin e sëmundjeve jo të transmetueshme në kujdesin parësor është rritur efikasiteti i trajtimit të sëmundjeve, si hipertensioni dhe diabeti, të cilat janë shumë të përhapura mes të moshuarve.

Një tjetër politikë me ndikim te të moshuarit ka qenë mbështetja e shërbimeve të shëndetit mendor, ku është shtuar përfshirja e psikologëve dhe punonjësve socialë në qendrat shëndetësore. Ky shërbim ka kontribuar në trajtimin dhe mbështetjen e shëndetit mendor të të moshuarve, duke i ndihmuar ata të përballojnë sfidat e moshës dhe ndryshimet e lidhura me shëndetin. Po ashtu, investimet në shërbimet spitalore dhe urgjencën paraspitalore kanë garantuar një përgjigje më të shpejtë dhe efikase për urgjencat që mund të kenë të moshuarit, duke rritur sigurinë dhe mbështetje për ata në raste të nevojshme shëndetësore.

Aktualisht të moshuarit janë përfitues të programeve të mbrojtjes sociale nëpërmjet pagesave monetare, në natyrë, si dhe e shërbimeve sociale pranë vendbanimit.

Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar dhe që nuk trajtohen me pension pleqërie, apo pension social, aktualisht përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes. Për vitin 2024, numri mesatar i familjeve përfituese, nga skema e ndihmës ekonomike është 54,000 familje, ku nga këta 7,644 persona në moshë pensioni, janë përfitues të ndihmës ekonomike.

Në skemën e pagesës së aftësisë së kufizuar trajtohen me pagesa 146,132 persona, nga të cilët rreth 40% janë të moshuar me aftësi të kufizuara të komisionuar nga KMCAP-të. Për personat me aftësi të kufizuara u indeksuan për vitin 2022 pagesat me 7.5%. Gjithashtu, një rritje prej 1,000 lekësh është bërë si një mbështetje shtesë për energjinë për kategoritë para- dhe tetraplegjikë dhe të verbrit. Nga kjo rritje përfituan 11,411 individë. Për vitin 2023 pagesat për aftësinë e kufizuar u indeksuan në masën 4.1% dhe në vitin 2024 në masën 2.1%. Për përfituesit e pagesave, pjesë e skemës së biopsikosociale, indeksimi ka qenë i njëjtë me përfituesit e skemës së pensioneve, respektivisht 8.6% për vitin 2023 dhe 4.1% për vitin 2024.[23]

Qeveria ka reformuar sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke futur një sistem të ri të vlerësimit bazuar në modelin biopsikosocial dhe duke ndryshuar nivelet e përfitimeve përfitimet kane ndryshuar nga dy nivele që ishin më parë në 4 nivele përfitimi, ndërsa për ndihmësin personal nga 1 nivel në dy nivele.

Megjithatë, kjo reformë kërkon konsolidim dhe harmonizim me paketën e mbështetjes sociale në nivel kombëtar. Reforma e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është e nevojshme të ketë një vizion afatgjatë, në lidhje me mbështetjen që duhet t'u ofrohet personave me aftësi të kufizuara. Përfitues të kësaj reforme janë edhe të moshuarit me aftësi të kufizuara, përkatësisht:

- 54,675 PAK mendor fizik, nga të cilët 5,077 mbi 60 vjeç;
- 71,838 invalidë pune, nga të cilët 12,164 mbi 65 vjeç;
- 13,976 të verbër (nuk ka të dhëna të ndara me grup-moshë);
- 5,643 paratetraplegjike (nuk ka të dhëna të ndara me grup-moshë)[24].

MSHMS-ja ka rritur pagesën për paketën higjieno-sanitare me 4,000 lekë në muaj më shumë; nga 16,000 në 20,000 lekë/muaj.[25]

Në kuadër të Paketës së Rezistencës Sociale, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, më datë 1 prill 2022 filloi shpërndarjen e të gjitha pensioneve të indeksuara, që trajtohen sipas legjislacionit në fuqi,

[23] Raportprogresi i Dokumnetit Politik për Moshimin 2020–2025 dhe Planit të Veprimit (burimi të dhënave MSHMS).

[24] Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, tetor 2024.

[25] Reflektuar komenti i Drejtorisë Politikave të Përkujdesjes dhe Shërbimeve Sociale të Integruara/ MSHMS, ardhur më datë 24 prill.

në masën 3.3%, me një efekt financiar prej 3.3 miliardë lekësh. Nga ky indeksim përfituan 673,813 pensionistë në mbarë vendin. Në kuadër të rritjes së mjaftueshmërisë për personat me statusin pensionist, në vite janë ndërmarrë masa afatshkurtra, nëpërmjet akordimit të bonuseve vjetore për këtë kategori, duke pasur në fokus kategoritë më vulnerable përfituesit të pensionit të invaliditetit apo të pensionit familjar.

Vëmendja e qeverisë dhe e partnerëve të saj kundrejt reformimit të sistemit të shërbimeve shërbimit të përkujdesjes shoqërore ka ardhur duke u rritur. Në këtë kuadër, problemet kritike që shqetësojnë të moshuarit, si një nga kategoritë më të rrezikuara nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, kanë filluar të trajtohen me përparësi, në nivel qendror dhe lokal. Për rrjedhojë, shërbimet e përkujdesjes shoqërore që ofrohen për të moshuarit, janë rritur 20% në krahasim me vitin 2023.

Në vitin 2023 në Shqipëri ofroheshin 50 shërbime sociale për të moshuarit, publike dhe jopublike, të siguruara nga 43 institucione[26], publike dhe jopublike, ndërsa sot këto shifra janë dyfishuar. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka mbështetur financiarisht këto shërbime, nga programi buxhetor i "Përkujdesjes sociale", zëri fondi social. Në kuadër të këtij fondi, shërbimet komunitare dhe shërbimet në familje për të moshuarit, janë ngritur 25 shërbime të ngritura gjatë viteve 2020–2025, përfitues 11,640 të moshuar.

Në planin e buxhetit afatmesëm 2025–2027, Fondi Social në kuadër të Programit të Kujdesit Social, është parashikuar si një seksion i veçantë, 350 milionë lekë për çdo vit, i cili mund të mbulojë, të paktën ngritjen e 10 shërbimeve të reja sociale për çdo vit.

Në krahasim me vitin 2023, numri i institucioneve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të shërbimeve që këto institucione ofrojnë, si edhe të përfituesve të tyre është rritur me 20%, ku 15% e institucioneve janë kombëtare dhe mbulojnë të gjithë territorin, 14% janë rajonale dhe mbulojnë përkatësisht qarqet në të cilat institucionet janë ngritur dhe funksionojnë, ndërsa 71% e institucioneve janë lokale dhe sigurojnë shërbime për bashkitë përkatëse.

Të moshuarit në vitin 2023 përfaqësonin kategorinë e tretë të përfituesve, ndërsa sot janë kategoria e dytë, pas individëve në nevojë ekonomike, me rreth 16% të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ku një vend të veçantë zënë shërbimet nëpërmjet qendrave komunitare (20%), si edhe ato të shërbimeve në familje (12%). Shërbimet për të moshuarit funksionojnë në 65% të bashkive, ose 30% më shumë se sa 2 vjet më parë.

Kategoria e të moshuarve dhe nevojat e tyre janë parashikuar në planet sociale të të gjitha bashkive. Megjithatë, ende vetëm 49%[27] e nevojave të të moshuarve për shërbime është plotësuar. Rreth 35% e aplikimeve të të moshuarve për shërbime të përkujdesjes shoqërore nuk plotësohen, për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore ose financiare.

3. Arritje të Planit të Veprimit 2020–2024

Plani Kombëtar i Moshimit 2020–2024 u miratua me VKM-në nr. 864, datë 24.12.2019, "Për miratimin e Dokumentit Politik Kombëtar për Moshimin".

Tri shtyllat strategjike të këtij dokumenti ishin:

Politika 1: Mbrojtje dhe përfshirje sociale për të moshuarit.

Politika 2: Shërbime sociale dhe shëndetësore të përshtatshme dhe të integruara për të moshuarit.

Politika 3: Promovimi i shëndetit, mirëqenies së të moshuarve dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi moshimin.

Nga analiza e shkallës të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të planit rezulton se janë realizuar:

Politika 1:

- Përshtatje graduale brenda 5 vjetëve e pensioneve me pensionin minimal.
- Intensifikimi i informimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi pensionet sociale, me synim uljen e numrit të atyre që nuk e përfitojnë thjesht për arsye informimi dhe burokracie.
- Ofrim sistematik nga ana e bashkive të aktiviteteve kulturore e sociale, me përfshirje të të moshuarve të vetmuar, si vizita turistike në qytete të Shqipërisë, konkurse letërsie dhe muzike, përkujtimore të personave të shquar etj.
- Përmirësim i ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi, mbi mundësitë që ofron tregu i punës për punësimin e të moshuarve.

[26] PNUD, 2023, Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore.

[27] PNUD, 2025, Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore – draft.

Politika 2:

- Përgatitje e një pakete bazë shërbimesh sociale dhe shëndetësore për të moshuarit në komunitet.

- Krijimi i qendrave të reja ditore pranë bashkive. Qendrat do të shërbejnë si mjedise të sigurta për të moshuarit më në nevojë dhe do të ofrojnë, veç të tjerash, edhe kujdes shëndetësor e social.

- Përgatitje e udhërrëfyesve dhe e standardeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit.

- Përgatitje e manualit të vetëndihmës për kujdesin e të moshuarit në kushtet e shtëpisë, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

- Përgatitje e protokolleve dhe e instrumenteve specifike për mjekët dhe infermierët e kujdesit shëndetësor parësor, lidhur me vlerësimin e problemeve mbizotëruese te të moshuarit.

- Përgatitje e një programi intensiv për trajnimin mbi geriatrinë në nivel kombëtar.

Politika 3:

Rritje e përdorimit sistematik të programeve të kapjes së hershme të hipertensionit dhe diabetit te popullata mbi 50 vjeç, nga shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Përgatitje e instruksioneve/standardeve për personat mbi 70 vjeç, për parandalimin e rrëzimeve të të moshuarve në institucionet e kujdesit dhe në vendbanim.

Përfshirje e institucioneve të shëndetit dhe të mbrojtjes sociale, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, në fushatat për mbrojtjen e dinjitetit të të moshuarve, sidomos personave invalidë dhe inkurajimi i vetëvlerësimit të tyre, përmes luftës kundër çdo forme paragjykimi, neglizhence, abuzimi dhe diskriminimi.

Zbatimi i planit të veprimit 2020–2024 ndikoi në:

- Hapjen e debatit politik mbi moshimin, problemet e tij kritike, si edhe nevojën për hartimin e politikave të veçanta të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.

- Analizën e nevojës shumëdimensionale shëndetësore e sociale të moshës së tretë dhe identifikimin e modelit më të përshtatshëm të shërbimeve të përkujdesjes, shërbimeve të integruara shëndetësore e sociale.

- Rritjen e ndërgjegjësimit të qeverisjes vendore mbi nevojën për shërbime për moshën e tretë, si edhe përgjegjësitë e tyre, gjë që rezultoi në përfshirjen e këtyre shërbimeve në planet sociale të bashkive dhe financimin e shërbimeve nëpërmjet fondit social.

- Megjithatë, disa nga aktivitetet e parashikuara, si instrument i realizimit të objektivave të formuluar, u realizuan pjesërisht ose nuk u realizuan. Mbështetur mbi këtë bazë, si dhe në përputhje me prioritetet politike e sociale të qeverisë dhe në konsultim me grupet e interesit, u hartua Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani Kombëtar i Veprimit, 2025–2030.

PJESA II
KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Kuadri politik, strategjik dhe institucional

Plani i Veprimit mbi Moshimin, përveç analizës së nevojave dhe identifikimit të sfidave të moshimit në popullatën e Shqipërisë, ka konsideruar dhe është mbështetur mbi disa parime të përfshira në dokumente të Bashkimit Evropian mbi moshimin e shëndetshëm dhe aktiv, Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Parimet e OKB-së për të moshuarit) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (Shëndet 2020). Ky dokument respekton parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjeve bazë në Shqipëri.

Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani Kombëtar i Veprimit, 2025–2030, hartohet në përputhje me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale, 2024–2030; Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale 2024–2028; Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022–2030); si edhe Dokumentin e Politikave Prioritare 2024–2026.

Në këtë kontekst, ky dokument strategjik është drejtpërsëdrejti i lidhur me synimin themelor të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022–2030), përkatësisht: "për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë, duke e transformuar atë në një vend të integruar në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së jetës për qytetarët, forcimin e institucioneve dhe sundimin e ligjit, si dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme".

Në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, të moshuarit konsiderohen si një nga grupet me nevoja të veçanta. Plani i Veprimit mbi Moshimin është në përputhje me vizionin për mbrojtjen sociale, bazuar në qasjen e ciklit të jetës.

Plani i Veprimit mbi Moshimin është në përputhje me strategjinë MIPA/RIS.

Theksi kryesor i strategjisë, i njohur si MIPA/RIS, është: "të përfshijë shqetësimet e

moshimit në të gjitha fushat e politikave, me synimin për të siguruar politikat të koordinuara dhe të integruara të ndjeshme gjinore dhe të bazuara në prova për t'i sjellë shoqëritë dhe ekonomitë në harmoni me ndryshimet demografike".

Përfshirja e moshimit *(mainstreaming),* integrimi dhe pjesëmarrja, rritja ekonomike, sigurimi social, tregjet e punës, të mësuarit gjatë gjithë jetës, cilësia e jetës, jeta e pavarur dhe shëndeti, barazia gjinore, mbështetje për familjet që ofrojnë kujdes, si dhe B\bashkëpunimi rajonal përbëjnë drejtimet kryesore të kësaj Strategjie.

Ajo që duhet të sillet në vëmendje është fokusi te gratë e moshuara. Gratë e moshuara janë më të shumta në numër se meshkujt e moshuar, numër i cili rritet gjithnjë e më shumë me rritjen e moshës. Situata e grave të moshuara kudo, duhet të jetë një prioritet për politikat dhe masat që duhet të merren në zbatim të tyre. Njohja e ndikimit diferencial të moshimit te gratë dhe burrat është thelbësore për sigurimin e barazisë së plotë midis grave dhe burrave dhe për zhvillimin e masave efektive dhe efikase për të adresuar këtë çështje. Është tejet thelbësore të sigurohet integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe legjislacionin.[28]

Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani Kombëtar i Veprimit, 2025–2030, është ndërtuar në harmoni të plotë me OZHQ-në, përkatësisht me:

- OZHQ 1. Zhdukje e varfërisë kudo dhe në të gjitha format;
- OZHQ 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat
- OZHQ 4. Sigurimi i arsimimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë
- OZHQ 5. Arritje e barazisë gjinore dhe fuqizim i grave
- OZHQ 8. Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë
- OZHQ 10. Reduktimi i pabarazive
- OZHQ 11. Qytete për të gjithë, të sigurta dhe të qëndrueshme
- OZHQ 16. Mirëqeverisja: Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta

Ky dokument mbështetet mbi shumë dokumente strategjike sektoriale, kryesisht të politikave shëndetësore, arsimore, punësimit dhe mbrojtjes sociale, zhvillimit ekonomik kombëtar dhe rajonal, si edhe të Decentralizimit dhe Qeverisjes vendore.

2. Qëllimi, vizioni dhe parimet mbi të cilat mbështetet PKVM

Qëllimi i Dokumenti Politik i Moshimit dhe Plani Kombëtar i Veprimit, 2025–2030, është "Zhvillimi i një strategjie të integruar dhe afatgjatë për menaxhimin e sfidave që sjell moshimi i popullsisë, duke garantuar një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv të mbështetjes sociale – shëndetësore dhe ekonomike për të moshuarit.

Kjo përfshin aspekte të ndryshme, për të siguruar mundësinë e një jetese dinjitoze dhe të pavarur për moshën e tretë.

Vizioni i këtij dokumenti është: "Të punojmë për një shoqëri 2030, të shëndetshme dhe aktive për të gjitha moshat.

Parimet mbi të cilat mbështetet ky dokument janë:

- Njeriu në qendër;
- Të moshuarit meritojnë një jetë dinjitoze;
- Kohezioni Social dhe Mbrojtja e të drejtave;
- Decentralizimi, deinstitucionalizimi dhe diversifikimi i politikave dhe aksesit;
- Përfshirja sociale në komunitet (pavarësia financiare, punësim, vullnetarizëm, strehim, kujdes shëndetësor dhe social);
- Barazia gjinore;
- Qëndrueshmëria financiare dhe kosto efektive.

Synimet e përgjithshme strategjike të Planit të Veprimit mbi Moshimin, 2025–2030, janë:

- Deri në vitin 2030, të sigurojë krijimin dhe funksionimin e një mjedisi mundësues për një jetë dinjitoze për të moshuarit 60+.
- Deri në vitin 2030, të ndikojë në ndërgjegjësimin e shoqërisë për një moshim dinjitoz dhe domosdoshmërinë e marrjes së masave efektive për parandalimin e vetmisë dhe moshimin e shëndetshëm.

Me qëllim përballjen me sfidat e moshimit është e nevojshme të ndjekim të dhënat në vijim që u referohen hipotezave dhe projeksioneve publikuar 26.2.2019.

[28] Political Declaration and Madrid International Plan of Action on Ageing, Second World Assamble for Ageing.

Projeksioni i treguesve të ndryshimeve demografike[29]:

Niveli i fertilitetit

Projeksioni i fertilitetit lidhet me 3 tregues kryesorë: niveli total i fertilitetit (TFR), mosha mesatare në lindje (në rritje lineare) dhe raporti gjinor në lindje (prirje drejt normalizimit).

Në rastin e hipotezës së fertilitetit të lartë, TFR-ja parashikohet të arrijë nga 1.37 lindje për grua më 2018-n në 1.8 lindje për grua në 2031. Në rastin e fertilitetit të ulët, TFR-ja është projektuar të arrijë në 1.2 lindje për grua në vitin 2031.

Jetëgjatësia në lindje

Në skenarin me vdekshmëri të ulët, jetëgjatësia në lindje për meshkujt dhe për femrat parashikohet të rritet në 81.5 dhe 85 vjeç në vitin 2031.

Në skenarin me vdekshmëri të lartë, jetëgjatësia në lindje për meshkujt dhe për femrat parashikohet të rritet, në 78.5 dhe 82 vjeç në vitin 2031.

Struktura moshore

Popullsia e Shqipërisë do të vazhdojë procesin e moshimit dhe mosha medinë e saj pritet të arrijë në 42.1 vjeç në 2031. Ky proces i moshimin shoqërohet me rritjen e shpejtë të raportit të varësisë së të moshuarve, në rreth 35.0 të moshuar për çdo 100 persona në moshë pune në vitin 2031. Gjatë kësaj periudhe, raporti i varësisë së të rinjve do të mbetet në nivele konstante prej rreth 25.0 të rinjsh për 100 persona në moshë pune.

Si pasojë e hipotezave të reja mbi projeksionet e popullsisë, këta tregues do të jenë objekt përditësimi

3. Procesi i zhvillimit të planit të veprimit dhe metodologjia e përdorur

Hartimi i Planit të Veprimit mbi Moshimin mbështetet në disa kritere:

Kriteri 1: Ndërsa rivlerëson politikat ekzistuese, plani i veprimit sugjeron masa të reja politike dhe institucionale, në përputhje me kuadrin ekzistues legjislativ, detyrimet ndërkombëtare, si edhe modele referencë, plotësisht të zbatueshme në kontekstin shqiptar.

Kriteri 2: Plani i Veprimit përfshin si nivelin qendror, ashtu edhe atë vendor.

Kriteri 3: Plani i Veprimit trajton politika dhe masa ndërsektoriale.

Kriteri 4: Plani i Veprimit përmban edhe detyrimet institucionale, që burojnë nga domosdoshmëria e realizimit të tij, përfshirë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.

Procesi përgjatë të cilit u mundësua përgatitja e Planit, kaloi nëpër katër faza themelore, përkatësisht:

- Rishikimi i të gjitha materialeve ekzistuese, politike dhe studimore, me qëllim riverifikimin e informacioneve, rivlerësimin e grupeve më vulnerabël brenda grupimit të përcaktuar, si "Mosha e tretë", si edhe riformulimin e problemeve më kritike që cenojnë të drejtën e të moshuarve për shërbime cilësore të mirëqenies sociale.
- Plotësimin e informacionit nëpërmjet intervistave me grupe të fokusuara, kryesisht me hartues të politikave në nivel qendror dhe zbatues të politikave në nivel qendror dhe vendor.
- Mbledhja e opinioneve dhe komenteve nga shoqëria civile, organizatat që mbrojnë të drejtat e të moshuarve, ose ofrojnë shërbime për të moshuar.
- Përgatitja e draftit të Planit të Veprimit dhe diskutimi i tij me grupet e interesit.

Gjatë fazës së parë u analizuan dokumentet përkatëse në këndvështrimin e vlerësimit të përshtatshmërisë së politikave ekzistuese të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, si dhe rezultatet konkrete të tyre, duke evidentuar edhe shkaqet që kanë penguar dhe vështirësuar arritjen e objektivave të politikave ekzistuese.

Faza e dytë ndihmoi në saktësimin e përfundimeve të analizës së dokumentacionit të realizuar gjatë fazës së parë. Në fazën e dytë, analiza u mbështet tek "opinionet" përkatësisht të hartuesve të politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si edhe të kujdesit shëndetësor (MSHMS), të politikave ekonomike dhe financiare (MEF), të zbatimit të politikave në nivel qendror, përkatësisht të Shërbimeve Sociale (SHSSH), të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), të Sigurimeve Shëndetësore (FSDKSH), të mbrojtjes në punë (Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, ISHPSHS), të mbrojtjes së shëndetit (Instituti i Shëndetit Publik, ISHP), si edhe të zbatimit të politikave në nivel vendor.

Faza e tretë përfshiu diskutimet me aktorët joqeveritarë. Kjo përqasje u konsiderua thelbësore për të mbledhur të dhënat e nevojshme dhe për të propozuar politika efektive, të zbatueshme në afatshkurtër, si edhe në afatgjatë.

[29] https://www.instat.gov.al/media/5221/hipotezat-e-projeksioneve-t%C3%AB-p%C3%ABrdit%C3%ABsuara-t%C3%AB-popullsis%C3%AB-2019-2031.pdf

Diskutimet në grup u zhvilluan në formën e intervistave gjysmë të strukturuara të organizuara sipas një pyetësori udhëzues.

Faza e katërt përfshin analizën e të dhënave dhe informacionit, si edhe ballafaqimin e tij me sugjerimet e literaturës, me qëllim formulimin e strategjive më të përshtatshme dhe të zbatueshme në kontekstin shqiptar, bazuar mbi profilin demografik të varfërisë dhe përjashtimit social.

PJESA III
QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, MASAT PRIORITARE DHE TREGUESIT E NDIKIMIT

1. Politika A: Mbrojtja ekonomike dhe sociale e të moshuarve në nevojë

1.1. Qëllimi i politikës A

Krijimi i një mjedisi mundësues, për një jetë dinjitoze për gratë 60+ dhe burrat e moshuar të moshës 65 vjeç +.

1.2. Rezultati i pritshëm

Mbrojtja e të moshuarve më në nevojë përmes përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të pensioneve dhe instrumenteve të tjerë financiarë në përputhje me standardet evropiane dhe ato ndërkombëtare, dhe rritjes së aksesushmërisë së ofrimit të shërbimeve sociale e shëndetësore të integruara dhe cilësore përgjatë gjithë ciklit të jetës.

1.3. Objektivat specifikë

Objektivi specifik A.1: Promovimi i pavarësisë financiare për burrat dhe gratë e moshës së tretë, nëpërmjet krijimit të mundësive që të moshuarit të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe mbështetje ekonomike përmes pensioneve dhe mundësive për punësim të mundshëm.

Objektivi specifik A.2: Përmirësimi i aksesit në shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme, të integruara dhe cilësore për të moshuarit, sa më pranë individit.

Objektivi specifik A.3: Përfshirja e moshimit në të gjithë sektorët dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha niveleve të qeverisjes.

1.4. Aktivitetet sipas objektivave specifikë

Objektivi specifik A.1: Promovimi i pavarësisë financiare për burrat dhe gratë e moshës së tretë nëpërmjet krijimit të mundësive që të moshuarit të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe mbështetje ekonomike përmes pensioneve dhe mundësive për punësim të mundshëm.

Aktiviteti A.1.1: Zhvillimi i politikave për rritjen e të ardhurave për pensionistët.

Ruajtja dhe zhvillimi i reformimit gradual dhe në mënyrë të qëndrueshme i moshës së daljes në pension për burrat dhe gratë, është një nga mënyrat për të krijuar një pavarësi financiare për pensionistët. Përmirësimi gradual i të ardhurave të pensioneve më të ulëta, duke ofruar mbështetje financiare të qëndrueshme për të moshuarit më të varfër, është domosdoshmëri.

Kjo do të arrihet nëpërmjet rishikimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Institucionet përgjegjëse për zbatimin janë Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore **(MEKI, ISSH)**.

Të moshuarit janë grupimi më i prekshëm nga varfëria, kjo për shkak se reforma e pensioneve e vitit 2015 aktualisht nuk ofron mundësinë e pavarësisë financiare të të moshuarve dhe përballimin e standardeve dinjitoze të jetesës.

Diferenca të konsiderueshme në të ardhurat nga pensionet kanë të moshuarit që jetojnë në zonat rurale nga ata që jetojnë në zonat urbane. Edhe pse në reformën e mëparshme u miratua e drejta e pensionit social për ata që nuk ishin kontribues të skemës së pensioneve, numri i përfituesve të pensioneve sociale mbeti shumë i ulët, për shkak të mungesës së informimit të qytetarëve.

Skema aktuale e pensioneve ka nevojë të rishikohet, duke rivlerësuar moshën e daljes në pension për burrat dhe gratë, si dhe duke rishikuar formulën. Një element tjetër në fokusin e reformës që ka filluar të hulumtohet dhe praktikohet nga qeveria shqiptare, është edhe indeksimi i pensioneve, i cili synohet që me skemën e re të bëhet i diferencuar sipas të ardhurave nga pensionet, nëpërmjet përmirësimit gradual të të ardhurave të pensionistëve, e kryesisht pensioneve më të ulëta, me qëllim rritjen e tyre.

Politika që aktualisht po zbatohet është ajo e rishikimit të masës së pensionit minimal, atij mesatar dhe pensionit social, shoqëruar me më shumë fushata informuese.

Një nga elementet që ka ndikuar në skemën kontributive të pensioneve, si edhe në skemën e sigurimeve shoqërore është mosderdhja e kontributeve për shkak të informalitetit të lartë apo mosdeklarimeve reale të pagës. Kjo ka bërë që të ardhurat në të dy skemat kontributive, atë të

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të arkëtohen në masën 59% për sigurimet shoqërore dhe 60% për sigurimet shëndetësore.

Nga ana tjetër, zhvillimet demografike të publikuara referuar censit 2023, qartazi evidentojnë se popullsia në moshën 60+ përbën rreth 1/4 e popullatës në Shqipëri (27.8%), trend i cili po thellohet gjithnjë e më shumë.

Të dhënat e censit 2023, por edhe të raportprogresit të zbatimit të Dokumentit Politik mbi Moshimin dhe Planit Kombëtar të Veprimit, 2020–2024, evidentuan se me gjithë progresin e bërë nga reforma e pensioneve apo mbështetja që Qeveria Shqiptare ka dhënë për të moshuarit, çështja e pavarësisë financiare të të moshuarve e në mënyrë të veçantë, të moshuarve të vetmuar, burrave dhe grave, mbetet prioritet për një jetesë dinjitoze.

Për të gjithë emigrantët shqiptarë është një hap shumë efektiv firmosja e marrëveshjeve qeveritare në fushën e pensioneve me një numër të konsiderueshëm vendesh, së fundmi edhe me Italinë. Është me shumë interes firmosja e marrëveshjes së pensioneve me Greqinë, ku dhe numri i emigrantëve shqiptarë është më i larti.

Rezultatet e pritshme të aktivitetit: Zbatimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe programeve të veçanta të shtetit, të adresuara për pensionistët; rritja e përfitimeve në raport me ndryshimin e indeksit të çmimeve dhe zhvillimit të kontributeve; garantimi i qëndrueshmërisë financiare të sistemit në harmoni me strategjinë dhe dokumentin e politikave të pensioneve.

Treguesit e performancës:

- Ndryshime të ligjit nr. 7703, datë 11.5 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Treguesit e ndikimit;
- Rritja në masën 50% e pensionit mesatar;
- Përfitimi i pensionit të trembëdhjetë;
- Miratimi i formulës së indeksimit të diferencuar të pensioneve;
- Rritja e moshës së daljes në pension;
- Rritja 100% e numrit të përfituesve të pensionit social;
- Firmosja e marrëveshjes së pensioneve me Greqinë.

Aktiviteti A.1.2: Stimuj për kontribuesit e punësuar në sektorin privat në moshë pensioni pleqërie dhe ofrimi i mundësive për punësim të përshtatur për të moshuarit.

Ofrimi i stimujve për individët që vazhdojnë të kontribuojnë për pensionet dhe sigurimet shoqërore deri në moshën e vonë të jetës, për të siguruar një mbështetje më të madhe financiare në periudhën që paralelisht përfitojnë pension pleqërie dhe njëkohësisht janë dhe kontribues si të punësuar në sektorin privat, është një mundësi për të motivuar financiarisht popullatën në moshë pensioni, jo vetëm të jetë aktive, por edhe të mundësojë rritjen e të ardhurave dhe sigurojë pavarësinë financiare. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përmirësimeve ligjore. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij aktiviteti janë Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore **(MEKI, Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ISSH).**

Rritja e fuqisë blerëse të të moshuarve ka sjellë zhvillimin e "ekonomisë së argjendtë"[30]. Bizneset po përshtatin gjithnjë e më shumë produktet dhe shërbimet e tyre për këtë grup-moshë, duke përfshirë sektorë si turizmi, koha e lirë, mallrat e personalizuara dhe shërbimet e kujdesit. Si rezultat, moshimi i shoqërisë po shndërrohet në një mundësi të re ekonomike.

Ndërsa varfëria mes punonjësve të moshuar është rritur, diskriminimi moshor, përfshirë atë në vendin e punës, konstatohet dukshëm. Ankthi te të moshuarit dhe të rinjtë për pensionet që do të marrin në të ardhmen janë tregues të nevojës për reformim.

Punëdhënësi mund të krijojë mundësi për përfitime sociale dhe shëndetësore për të moshuarit që vazhdojnë të kontribuojnë në sektorin privat edhe pas daljes në pension, sikurse janë: ofrimi i këshillimit psikologjik, aktivitete fizike (palestra apo konkurse sportive) apo fleksibiliteti në ambientin ku punojnë, të cilat ndihmojnë në uljen e stresit dhe ankthit, dhe në jetën aktive të të moshuarve.

Mbledhja e praktikave pozitive dhe organizimi i një dialogu publik mbi praktikat pozitive mund të shërbejnë për të ndihmuar ata që punojnë pas mbushjes së moshës së pensionit. Mënyrë tjetër është nxitja e kontributeve te skemat e pensioneve

[30] https://unece.org/statistics/documents/2024/11/presentations/ageing-and-world-work-ilos-latest-commitments-dorothea

private, me qëllim përfitimin e një pensioni privat që mund të rrisë të ardhurat në të ardhmen.

Rezultatet e pritshme të aktivitetit: Politika aktive të tregut të punës për aktivizimin e të moshuarve; përditësimi i standardeve ndërkombëtare të punës dhe plotësimi i boshllëqeve; siguria dhe shëndeti në punë; puna miqësore me moshën; lufta kundër moshës.[31]

Treguesit e performancës:

- Rishikim i kornizës ligjore në drejtim të uljes së **normave të tatimit për të ardhurat e të punësuarve në moshë pensioni;** bonuse për qëndrueshmëri dhe performancë; mbështetje për pensione private; fleksibilitet të orareve të punës.

Treguesit e ndikimit:

- Të paktën 30,000 individë kontribues në moshë pensioni përfitojnë nga stimujt.

- 300 subjekte private të kenë krijuar kushtet për punësim të përshtatshëm për të moshuarit.

- Mbledhja e praktikave pozitive dhe organizimi i një dialogu publik mbi praktikat pozitive çdo vit.

Aktiviteti A.1.3: Përgjigjja ndaj krizave.

Rritja e aftësisë së skemës së ndihmës ekonomike për t'u përgjigjur në kohë situatave të krizave dhe emergjencave është një nga mënyrat efikase për të zvogëluar ndikimin e krizave mbi grupet vulnerabël, përfshirë të moshuarit. Megjithëse fatkeqësitë prekin të gjitha nivelet e shoqërisë, ato kanë një efekt më të madh në popullatat e cenueshme. Këto grupe, duke përfshirë gratë, banorët e zonave rurale, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, shpesh mbajnë barrën më të rëndë të trajtimit të efekteve të menjëhershme të katastrofës dhe të pasojave pasuese të rimëkëmbjes.[32]

Popullsia e moshuar me rritje të shpejtë është një nga grupet më të cenueshme dhe më të brishta të shoqërisë. Përveç rritjes së sfidave shëndetësore, të moshuarit kanë, gjithashtu, më shumë gjasa të luftojnë me teknologjinë, si caktimi i takimeve për testimin ose vaksinimin, COVID-19 ose aksesi në paralajmërimet e fatkeqësive ose informacionet mbi iniciativat e ndihmës ndaj fatkeqësive ishin dëshmi e disa barrierave në situatat e krizave dhe pafuqisë ekonomike të të moshuarve për të përballuar kriza të tilla. Edhe pse qeveria shqiptare vaksinimin e të moshuarve gjatë periudhës COVID-19 e konsideroi prioritet, një sërë pasojash kanë ndikuar në vdekshmërinë e kësaj grup-moshe përgjatë situatës së krijuar dhe vështirësive me të cilat u përball. Krizat e njëpasnjëshme, si tërmeti i viti 2019, apo kriza e çmimeve si rezultat i luftës në Ukrainë, i gjetën të papërgatitur jo vetëm popullatën e grup-moshës 60+, por edhe strukturat në nivel qendror dhe lokal për t'iu përgjigjur situatës së krijuar, ashtu si në mbarë botën edhe në Shqipëri.[33]

Efektet e tërmetit të vitit 2019, situata pandemike COVID-19, si dhe efektet ekonomike në ofertën dhe çmimet në tregun e mallrave dhe të energjisë të luftës në Ukrainë, ishin eksperienca të reja për Shqipërinë, e cila situatat e emergjencës i ka pasur të lidhura kryesisht me problematikën klimaterike e fatkeqësitë natyrore si përmbytjet, zjarret etj. Situatat e viteve të fundit evidentuan aftësinë e kufizuar dhe boshllëqet e sistemeve të përgjigjes ndaj situatave emergjente përfshirë dhe atë të koordinimit, gjithëpërfshirjes, financiare, kapaciteteve të personeleve të ndryshme, komunikimit etj. Ato krijuan, gjithashtu, eksperienca të mira mbi mënyrën se si duhet të adresohen problematikat e krijuara.

Fondi i kontigjencës për financimin e emergjencave dhe përshtatjen e sistemit të mbrojtjes sociale, me skema shtesë të mbështetjes financiare dhe/apo me shërbime, aktualisht mungon, në të dy nivelet e qeverisjes, për të reaguar shpejt dhe në mënyrë efektive.

Analizat e situatave dhe një udhërrëfyes për ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje shoqërore të aftë për t'iu përgjigjur krizave dhe emergjencave do të ndihmonin për hartimin dhe zbatimin në praktikë të funksionimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe përfitimeve të tjera financiare në raste të mundshme krizash apo emergjencash. Regjistri Kombëtar duhet të përmbajë një modul të veçantë ku të evidentohen individët më vulnerabël në raste emergjencash, si dhe nevojat potenciale të tyre, personelin e trajnuar për t'iu ardhur në ndihmë në të gjitha nivelet, si dhe një plan të dedikuar komunikimi të informacionit. Një vëmendje të veçantë do t'u kushtohet përveç grupeve të tjera vulnerabël edhe të moshuarave, duke përdorur

[31] https://unece.org/statistics/documents/2024/11/presentations/ageing-and-world-ëork-ilos-latest-commitments-dorothea

[32] https://www.csis.org/analysis/disaster-risk-reduction-through-digital-transformation-western-hemisphere

[33] Raportprogresi i zbatimit të Dokumentit për Moshimin 2020–2024 dhe Planit të Veprimit.

vlerësime dhe analiza të fokusuara në nevojat specifike të këtyre grupeve.

Të gjitha këto veprime do të jenë në përmbajtje të skenarëve të ndryshëm për mbrojtjen sociale në raste krizash dhe emergjencash përfshirë përgatitjen, përballjen dhe rikuperimin nga krizat dhe pasojat shoqëruese, prezantimin e mekanizmave financiarë fleksibël, për ndryshimin e alokimeve buxhetore sipas nevojave, hartimin e kritereve dhe faktorëve për ndryshmin e tyre në raste të tilla, si dhe buxhetet e nevojshme me qëllim që, mbrojtja sociale të jetë e përgjegjshme dhe adaptive, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të menaxhuar goditjet që prekin grupet vulnerabël të popullsisë.

Ndërhyrjet do të ndihmojnë familjet dhe komunitetet që të kenë akses në burime për të ndërtuar ripërtëritjen dhe për të rikuperuar mjetet e tyre të jetesës kundër fatkeqësive natyrore dhe goditjeve. OJF-të dhe sektori privat janë partnerë të pazëvendësueshëm në këtë përpjekje, ndaj sigurimi i një bashkëpunimi efektiv me to, qysh në fazat planifikuese dhe më tej si faktorë kontribues në skenarët e përgjigjes ndaj emergjencave, është domosdoshmëri[34] **(MSHMS + Bashkitë).**

Rezultatet e pritshme: Sigurimi i mbrojtjes dhe mirëqenies së popullatës së moshës së tretë gjatë situatave të jashtëzakonshme, të tilla si fatkeqësitë natyrore, emergjencat shëndetësore, krizat sociale dhe ekonomike.

Treguesit e performancës:

- Përgatitja e një analize të situatave të mëparshme të krizave dhe emergjencave në përshtatje me kontekstin lokal, evidentimi i ndërhyrjeve konkrete për mbështetje dhe përgatitja e skenarëve të ndërhyrjes së bashku me efektet financiare për të moshuarit, në rast emergjencash të mundshme;

- Ngritja e kapaciteteve të personelit të ngarkuar me mbrojtjen sociale për të moshuarit në rastet emergjente si dhe krijimi i një databaze mbi personelin e trajnuar;

- Hartimi i një plani komunikimi për situatat e krizave dhe emergjencave që adreson vulnerabilitetet dhe nevojat e të moshuarve (sipas gjinisë, minoritetit, aftësisë së kufizuar etj.).

Tregues ndikimi:

- Krijimi i një fondi kontigjence për mbrojtjen e të moshurave në rastet e krizave.

Aktiviteti A.1.4: Krijimi i mundësive të punësimit në sektorët e gjelbër.

Ofrimi i mundësive për individët e moshës së tretë që të angazhohen në aktivitete të gjelbra, si: bujqësia e qëndrueshme, fermat, blegtoria etj. Kjo vlen për të gjithë të moshuarit e zonave rurale, që në pjesën më të madhe hyjnë në kategorinë e të moshuarve të vetmuar, por që aktualisht kanë aftësi fizike dhe mendore dhe janë aktivë. Në mënyrë të veçantë gratë e moshuara në zonat rurale, të cilat merren me bagëtitë apo me punët e shtëpisë, duke qenë pronare me burrat, nëpërmjet lehtësirave të formularëve të aplikimit dhe një diskriminimi pozitiv, mund të mbështeten për të përfituar nga grantet e AZHBR-së **(Ministria e Bujqësisë, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural).**

Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra është një tjetër mundësi për punësimin në sektorin e gjelbër. Kjo mund të zhvillohet në nivele të pushtetit lokal, duke vënë në dispozicion hapësira publike në pronësi të bashkive, për të nxitur zhvillimin e kopshtarisë (bashkitë).

Rezultatet e pritshme: Krijimi i mundësive të punësimit për individët e moshës së tretë, aktivizimi në punët vullnetare, që ndihmojnë jetesën aktive të tyre dhe përfshirjen në shoqëri dhe rritjen e të ardhurave.

Treguesit e performancës:

- Përmirësimi i kritereve dhe formularit të aplikimit për marrjen e granteve nga AZHBR duke përfshirë edhe përfituesit e moshës së tretë të ndarë sipas gjinisë burra e gra;

- Përfshirja në planet sociale lokale e aktiviteteve për rehabilitimin e hapësirave të gjelbra nga të moshuarit.

Treguesit e ndikimit:

- 100% e aplikantëve të moshuar përfitues nga grantet e AZHBR-së;

- 50% e bashkive kanë përfshirë në planet sociale lokale aktivitetin e të moshuarve në rehabilitimin e hapësirave të gjelbra në pronësi të bashkive.

Aktiviteti A.1.5. Nxitja e krijimit të ndërmarrjeve sociale si një instrument për punësim dhe vetëpunësim të të moshuarve.

[34] https://shëndetsia.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/VKM2024-03-13-152-1.pdf

Ndërmarrjet sociale janë një mundësi për punësimin e individëve të pafavorizuar nëpërmjet përdorimit të subvencioneve nga një fond i posaçëm i dedikuar për këtë qëllim që quhet Fondi i Ndërmarrjeve Sociale. Ligji për Ndërmarrjet Sociale[35] është miratuar në vitin 2016, por aktivizimi i tij është kryer për herë të parë në vitin 2018 mbi bazën e një vendimi "Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale" dhe një udhëzimi që rregullonte modalitetet e përdorimit të tij[36]. Fondi në mbështetje të ndërmarrjeve sociale sipas produktit përkatës të parashikuar në programin Objektivi i Politikës së Programit sipas PBA është "Riintegrimi social-ekonomik i grupeve të margjinalizuara".

Plani Buxhetor Afatmesëm "Përkujdesja sociale" për periudhën 2023–2025 është vendosur të jetë 240,000,000 (dyqind e dyzet milionë) lekë[37] **(MSHMS).**

Rezultati i pritshëm: Nxitja e punësimit të individëve të moshës së tretë, me qëllim përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë për këtë kategori.

Treguesit e performancës:

- Përqindja (%) e personave të punësuar në ndërmarrjet sociale në raport me numrin e të moshuarve në skemën e ndihmës ekonomike;
- Rishikimi i ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", me qëllim inkurajimin e bizneseve të mbështesin ndërmarrje sociale që punojnë me të moshuarit.
- Përqindja (%) e financimit të NS-së që kanë punësuar të moshuar në krahasuar me fondin vjetor të financimit të NS-së.

Treguesit e ndikimit:

- 2 ndërmarrje sociale që ofrojnë shërbime për moshën e tretë të financuara;
- 25 të moshuar përfitues të skemës NE të punësuar në ndërmarrje sociale.

Objektivi specifik A.2: Përmirësimi i aksesit në Shërbime Sociale e Shëndetësore të përshtatshme, të integruara dhe cilësore për të moshuarit, sa më pranë individit.

Aktiviteti A.2.1: Mirëqeverisja dhe mbështetja për kujdes afatgjatë përgjatë gjithë ciklit të jetës nëpërmjet zhvillimit të mekanizmave të sigurimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Në kuadrin e moshimit të popullsisë, trajtimi i nevojave të kujdesit afatgjatë mbetet një sfidë kyçe për shumë vende, përfshirë edhe Shqipërinë.

Mbështetja për një kujdes afatgjatë përgjatë gjithë ciklit të jetës, është një proces që kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe vendor, ku një nga drejtimet është dhe evidentimi i nevojave. Ajo është e lidhur me aspekte të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe shërbimeve sociale shëndetësore.

Nisur nga zhvillimet demografike të publikuara referuar censit 2023, qeveria shqiptare ka vendosur në prioritetet e veta zhvillimin e politikave për një kujdes afatgjatë përgjatë gjithë ciklit të jetës, jo vetëm me fokus mbrojtjen sociale, por edhe përfshirjen sociale nëpërmjet ngritjes dhe zhvillimit të mekanizmave për dhënien e kujdesit.

Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2024–2028[38], Strategjia e Mbrojtjes Sociale dhe Plani Veprimit 2024–2030[39]. Strategjia e Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025[40] shprehen, se: "politikat e përfshirjes sociale duhet të adresojnë njëherazi këto dimensione". Individët dhe grupet marrin pjesë në shoqëri në tri fusha të ndërlidhura të përfshirjes sociale: tregjet, hapësirat dhe shërbimet. Këto fusha përmbajnë pengesa, por njëkohësisht edhe mundësi për përfshirje sociale. Eliminimi i pengesave dhe qasja në shërbime është thelbësore për të përmirësuar kushtet dhe për të garantuar pjesëmarrjen në jetën social-ekonomike.[41]

Disa nga drejtimet e kujdesit afatgjatë mund të jenë:

- Sigurimi që kujdesi afatgjatë duhet të jetë në kohë, gjithëpërfshirës dhe i përballueshëm, duke lejuar një standard të mirë jetese për njerëzit me nevoja për kujdes afatgjatë;
- Sigurimi i kritereve dhe standardeve të cilësisë dhe ndërthurjes së shërbimeve profesionale të kujdesit afatgjatë (kujdesi në shtëpi, kujdesi në

[35] Ligji nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".

[36] 4 Udhëzimi nr. 602, datë 1.8.2018, "Për procedurat dhe dokumentacioni për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale".

[37] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/VKM2024-03-13-152-1.pdf

[38] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM2024-03-13-152_.pdf

[39] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM2024-03-13-152_.pdf

[40] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM2024-03-13-152_.pdf

[41] https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb229671.pdf VKM, vendim nr. 544, datë 28.8.2024, "Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale 2024–2028".

komunitet dhe kujdesi rezidencial), mbyllja e boshllëqeve territoriale në aksesin ndaj kujdesit afatgjatë, gjetja e zgjidhjeve digjitale të aksesueshme në ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe sigurimi që shërbimet dhe objektet e kujdesit afatgjatë të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;

- Angazhimi i qeverisë shqiptare në kuadër të kapitullit 19, për kujdesin afatgjatë është i cili është konkretizuar me një roadmap, ku do detajohen iniciativat ligjore, administrative dhe institucionale, sikurse janë: Përmirësimi i kuadrit rregullator në lidhje me shërbimin e asistentit personal profesional, duke filluar nga viti 2025 dhe zhvillimin e një përkufizimi dhe standardeve e protokolleve lidhur me shërbimin afatgjatë, me fokus qasjen e integruar të kujdesit shëndetësor dhe social, duke filluar nga viti 2026[42].

- Mobilizimi i fondeve adekuate dhe të qëndrueshme nga buxheti i shtetit apo buxhetet e bashkive për kujdesin afatgjatë, duke përfshirë përdorimin e fondeve të BE-së.[43]

Disa vende në rajon, përfshirë Armeninë, Austrinë, Bullgarinë, Kanadanë, Çekinë, Francën, Finlandën, Sllovakinë dhe Spanjën, kanë zhvilluar mekanizmat koordinues ndërinstitucionalë si këshilla ndërministrore, komitete ose grupe përpunuese, për të mbështetur zhvillimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave që trajtojnë moshimin dhe lehtësojnë përfshirjen e palëve të interesuara[44] (**MSHMS-SHSSH-Bashkitë**).

Rezultate të pritshme: Sigurimi i një qasje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme në ofrimin e kujdesit afatgjatë për individët, duke përmirësuar shërbimet, si dhe mekanizmat e ofrimit përgjatë gjithë ciklit të jetës, nga fëmijëria deri në moshën e pleqërisë.

Treguesit e performancës

- Përgatitja e analizës dhe rekomandimet për strukturat në nivel qendror dhe vendor për kujdesin afatgjatë përgjatë gjithë ciklit të jetës;

- Hartimi i termave dhe kushteve aktuale të pranimit dhe të drejtat e punonjësve të kujdesit afatgjatë dhe eksplorimi i mundësive të zhvillimit të skemave të kujdesit afatgjatë, përgjatë gjithë ciklit të jetës;

- Hartimi dhe zbatimi i protokolleve të detyrueshme për kujdes në shtëpi, qendra ditore dhe rezidenciale.

- "Ngritja dhe funksionimi i Linjës së Këshillimit për moshën e tretë".

Treguesit e ndikimit:

- Krijimi i një grupi pune për koordinimin e sektorëve socialë, shëndetësorë, operatorëve dhe bashkive[45];

- Të paktën 300 profesionistë (kujdestarë/ ndihmës personal) të certifikuar për shërbime të kujdesit afatgjatë;

- Fond i dedikuar në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e bashkive apo financimet e BE-së për kujdesin afatgjatë;

- Kryerja e kontrollit mjekësor bazë edhe për moshën 70+.

Aktiviteti A.2.2: Shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore për moshën e tretë.

Njohja dhe trajtimi i menjëhershëm i kushteve shëndetësore të të moshuarve janë të gjitha të lidhura me problematikat e shtuara që shfaqen te kjo kategori, si: sëmundjet kronike, problemet e shëndetit mendor për humbje të aftësive konjitive, apo aftësive fizike dhe të mungesës së lëvizshmërisë.

Probleme të shëndetit mendor (dhe kushteve neurologjike dhe të përdorimit të substancave) te të rriturit janë thelbësore.[46] Kjo duhet të ndjekë standardet për kujdesin e integruar për të moshuarit, i cili është i bazuar në komunitet dhe i fokusuar si në kujdesin afatgjatë të të rriturve të moshuar që kanë probleme të shëndetit mendor, ashtu edhe në edukimin, trajnimin dhe mbështetjen e kujdestarëve. Zakonisht rekomandohet një ndërthurje e ndërhyrjeve të shëndetit mendor, krahas mbështetjeve të tjera për të adresuar shëndetin, kujdesin personal dhe nevojat sociale të individëve.

Ngritja e qendrave të shërbimeve rehabilituese sociale shëndetësore "shtëpi mbështetëse" është një tjetër nevojë për individët e moshës së tretë. Riaftësimi fizik dhe emocional për të përballuar pasojat e moshës për individët e moshës së tretë është një mundësi për t'u rikthyer në një nivel më të mirë të shëndetit dhe jetesës së pavarur. Qendrat rehabilituese, gjithashtu, ofrojnë shërbime për

[42] Reflektuar komenti i Drejtorisë së Politikave të Përkujdesjes dhe Shërbimeve Shoqërore të Integruara/MSHMS, ardhur më datë 24 prill.

[43] **https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_5169 » A European Care Strategy for caregivers and care receivers**

[44] https://unece.org/population/events/ministerial-conference-ageing-2022

[45] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Zhvillimit-t%C3%AB-Kujdesi-Paresor-2020-2025.pdf

[46] https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/mental-health-of-older-adults

parandalimin e përkeqësimeve të mëtejshme të shëndetit, si: humbja e masës muskulore, problematikat me ekuilibrin dhe rrezikun për rënie, dhe çrregullime të tjera që janë të zakonshme në moshën e tretë.

Një tjetër nevojë për individët e moshës së tretë është edhe hapja e klinikave për kujdesin e shëndetit oral dhe atë të syve. Shëndeti oral dhe ai i syve janë pa diskutim pasoja të moshës. Kujdesi oral dhe ai i syve janë të lidhura ngushtë me shëndetin e përgjithshëm të individëve të moshuar. Investimi në kujdesin e këtyre dy aspekteve mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së jetës, në parandalimin e sëmundjeve serioze dhe në ruajtjen e pavarësisë dhe dinjitetit të të moshuarve.

Për trajtimin e tyre, pa dyshim ka nevojë për protokolle dhe standarde të miratuara të shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe atyre të integruara **(MSHMS + ASCSHSH).**

Grupet që duhen marrë në konsideratë:

a) të moshuarit (pilotimi i kujdesit geriatrik, kujdesi në familje, krijimi i një modeli të integruar të kujdesit mjekësor-social etj.);

b) pacientët me sëmundje kronike – vlerësim/monitorim i pacientëve me morbiditet të shumëfishtë/shtresëzimi i popullatës së mbuluar;

c) personat me aftësi të kufizuara – më shumë kujdes social se sa shëndetësor; komuniteti rom – ata kanë nevojë për integrim/shumë të varfër/ probleme me edukimin/shpesh kanë probleme me aksesin në shërbime/shpesh nuk iu rimbursohen barnat;

d) kujdes për fëmijë me nevoja të veçanta, duke përfshirë autizëm, s. Down etj.;

e) shëndeti i adoleshentëve;

f) vlerësimi, përditësimi dhe zbatimi i protokolleve (protokollet e miratuara në vitin 2016).

Rezultate të pritshme: Sigurimi i një kujdesi të integruar dhe koordinuar për adresimin e nevojave të shëndetit dhe nevojat për asistencë shtëpiake për personat e moshuar, me qëllim përmirësimin e mirëqenies fizike dhe sociale.

Treguesit e performancës:

- Mbështetje e QSH-ve nga NJVKSH-ja dhe OKSH-ja për vlerësimin e nivelit të riskut dhe vulnerabilitetit në popullatën që ata mbulojnë (të moshuarit, gratë, fëmijët, pacientët me sëmundje kronike, grupet etnike etj.), me qëllim përshtatjen e vazhdueshme të shërbimeve me nevojat; [47]

- Trajnimi i personelit të kujdesit shëndetësor mbi nevojat specifike, komunikimin dhe menaxhimin e rasteve në grupet e margjinalizuara;

- Ndërtimi dhe promovimi i modeleve të bashkëpunimit të suksesshëm midis agjencive rajonale të operatorit, Pushtetit Vendor dhe ekipeve të qendrave shëndetësore me organizatat joqeveritare, me synim mbështetjen e grupeve vulnerabël brenda komuniteteve, si edhe për "fuqizimin" *(empowerment)* e këtyre grupeve, me qëllim që ata të marrin në dorë zgjidhjen e problemeve të tyre shëndetësore;

- Hartimi i udhëzuesit për qendrat e rehabilitimit për të moshuarit;

- Akreditimi i shërbimeve geriatrike dhe gerontologjike.

Treguesit e ndikimit:

- Ndërtimi i 2 qendrave të rehabilitimit shëndetësor dhe social të quajtura "shtëpi mbështetje", për personat me çrregullime të rënda mendore (2027–2030), rehabilitimi i qendrës së të moshuarve Libohovë (2025) dhe 2 qendrave rezidenciale për të moshuar, gjatë periudhës 2027–2030.

- 30 shërbime të integruara socioshëndetësore komunitare dhe shërbime të asistencës shtëpiake për të moshuarit.

- Hapja dhe financimi i 2 klinikave për kujdesin oral dhe 2 klinikave për kujdesin e shëndetit të syve në spitalet rajonale/përgatitja e studimit nga ekspertë të fushës për përllogaritjen e burimeve përkatëse.

- 1500 punonjës të KSHP-së kanë kryer trajnimet e nevojshme dhe kanë marrë njohuritë për të trajtuar individët e moshës së tretë.

Aktiviteti A.2.3: Ngritja e shërbimeve cilësore sociale shëndetësore të lëvizshme dhe në shtëpi për të moshuarit dhe ngritja e kapaciteteve të figurave profesionale, shoqëruara me digjitalizimin e tyre.

Nxitja dhe mbështetja e shërbimit në familje për moshën e tretë është parashikuar edhe nga Strategjia e Kujdesit Shëndetësor Parësor.[48] Në kuadrin e moshimit të popullsisë, trajtimi i nevojave të kujdesit afatgjatë mbetet një sfidë kyçe për shumë vende përfshirë edhe Shqipërinë. Duke vlerësuar pamjaftueshmërinë e shërbimeve për moshën e

[47] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Zhvillimit-t%C3%AB-Kujdesi-Paresor-2020-2025.pdf

[48] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Zhvillimit-t%C3%AB-Kujdesi-Paresor-2020-2025.pdf

tretë, një vëmendje e posaçme për këtë kategori do të kushtohet për vitet në vijim, me qëllim parandalimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit te të moshuarit.

Kujdesi afatgjatë për të moshuarit do të ofrohet përmes: shërbimeve komunitare, shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore, qendrave ditore, vizitave të infermierëve dhe kujdestarëve profesionalë; shërbime të bazuara në shtëpi, ndihmë në shtëpi, përfitimet në para për kujdestarët, grupet mbështetëse për kujdestarët; kujdes institucional më pak intensiv; kujdesi intensiv institucional. Në ofrimin e shërbimeve për moshën e tretë do të mbahen në konsideratë diferencat gjinore mes grave dhe burrave të moshuar, duke ofruar shërbime që u përshtaten nevojave specifike të tyre. Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit afatgjatë do të synojë të rrisë mirëqenien e të moshuarve, ndërsa mbështeten familjet dhe zhvendosen përgjegjësitë nga kujdestarët e papaguar të familjes te punëtorët e kualifikuar, të zvogëlohet numri i hospitalizimeve të panevojshme në mjediset e kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar për ata që nuk kanë mundësi të tjera.[49]

Problemet lidhur me aksesin e pacientëve në shërbime laboratorike dhe diagnostike vërehen sidomos te të moshuarit në zonat rurale, si dhe për individët e vetmuar apo me humbje të autonomisë. Zhvillimet e telemjekësisë aktualisht mundësojnë vizitat e mjekut të familjes në distancë, duke përfunduar deri të ndërhyrjet kirurgjikale në distancë. Por, ndërsa kjo është shumë e vështirë në vendin tonë, kohët e fundit telemjekësia ka hedhur hapa të rendësishëm nëpërmjet qendrës së telemjekësisë në Shqipëri.

MSHMS-ja ka bërë progres në drejtim të zhvillimit të konsultave mjekësore nëpërmjet kësaj qendre. Nevoja për digjitalizimin u ndie në mënyrë të veçantë në kohën e COVID-19, kur në kushtet e izolimit ishte e pamundur të kryheshin fizikisht një pjesë e vizitave mjekësore të mjekut të familjes për të moshuarit apo edhe pamundësia për t'iu ofruar mbështetje psikologjike dhe emocionale. Sistemet e referimit në sektorin shëndetësor, *e-Receta* etj., janë hapa të cilët tregojnë për futjen e metodave digjitale edhe në sektorin e shëndetësisë dhe që pa dyshim janë shumë atraktivë. Sistemi i menaxhimit të informacionit për shërbimet sociale, ka bërë të mundur ndjekjen e rasteve të referuara për shërbime sociale, që nga identifikimi i rastit dhe deri në rehabilitim **(MSHMS + Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor + Shërbimi Social Shoqëror + Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore dhe Shoqërore).**

Rezultatet e pritshme: Sigurimi i mbrojtjes sociale të përshtatur dhe cilësore për individët e moshës së tretë të vetmuar, apo që kanë humbur aftësitë, sipas rastit edhe duke përdorur teknologjinë digjitale.

Treguesit e performancës:

- Përgatitje e udhërrëfyesve dhe standardeve të kujdesit në shtëpi për të moshuarit të diferencuara për burrat dhe gratë;
- Përgatitje e manualit të vetëndihmës për kujdesin e të moshuarit në kushtet e shtëpisë, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Organizim i një kursi afatshkurtër të trajnimit dhe i një uebsite (faqe interneti) me informacion mbi kujdesin në shtëpi për të moshuarit;
- Përgatitja e Strategjisë së Figurave Profesionale për Shërbimet Shoqërore, ku përfshihet dhe ndihmësi personal për të moshuarit dhe përcaktimi i mekanizimit të financimit të tyre.
- Hartimi dhe zbatimi i protokolleve të detyrueshme për kujdes në shtëpi, qendra ditore dhe rezidenciale.

Treguesit e ndikimit:

- Të paktën 300 të moshuar çdo vit do të marrin shërbime në qendrat rezidenciale për të moshuar[50];
- Rritja me 100% e numrit të shërbimeve në shtëpi, të financuara nga Fondi Social;
- Rritja me 50% e numrit të përfituesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe shoqëror për të moshuarit.

Aktiviteti A.2.4: Rritja e kapaciteteve geriatrike dhe gerontologjike te profesionistët shëndetësorë dhe socialë[51].

Puna me të moshuarit dhe kujdesi për ta duhet të adresojë shumë specifika të shfaqjes së problemeve shëndetësore të tyre, si: paraqitja atipike e sëmundjeve, multipatologjitë, kombinimi i shumë mjekimeve, kombinimi i nevojave shëndetësore me ato sociale dhe çështje specifike të komunikimit me të moshuarit.

Kapacitetet në geriatri dhe gerontologji janë të pamjaftueshme në të gjitha nivelet. Këtu përfshihen

[49] Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030.

[50] Sipas PBA 91307AK.

[51] https://archive.org/details/vkm-nr.-864-date-24.12.2019-per-miratimin-e-dokumentit-politik-kombetar-per-m

boshllëqet në njohuri te mjekët e përgjithshëm e profesionistët e tjerë shëndetësorë dhe në kualifikimin e specializuar në geriartri. Edhe pse në paketën e shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor parësor janë përfshirë një sërë shërbimesh me natyrë geriatrike kushtuar të moshuarve, vërehen ende shumë probleme lidhur me cilësinë e kujdesit të ofruar, të cilat vijnë për shkak të mungesës së trajnimit të përshtatshëm në fushën e kujdesit për të moshuarit.

Nëse për infermierët dhe punonjësit socialë janë përfshirë disa elemente lidhur me geriatrinë dhe gerontologjinë në programet e arsimit të lartë, kjo nuk ka ndodhur me arsimin e lartë të mjekëve. Edhe pse në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës janë futur dhe zhvilluar kurrikulat për geriatrinë dhe gerontologjinë, akoma ka vend për t'u zhvilluar. Ndërkohë, kanë munguar trajnimet e edukimit të vazhduar në këtë fushë. Investimi në këtë fushë do të ishte ndërhyrja me kosto efektive për fuqizimin e sistemit shëndetësor me fokus të moshuarit dhe rritjen e kapaciteteve të përgjithshme të shëndetit publik.

Mbështetja për nevojat e veçanta që lidhen me moshimin është e lidhur me përshtatjen e proceseve të planifikimit dhe monitorimit të burimeve njerëzore në sistemin e kujdesit shëndetësor e social, në mënyrë që të sigurohen numrat dhe kualifikimet e përshtatshme të personelit për një popullatë gjithmonë e më të moshuar **(MSHMS).**

Rezultate të pritshme: Të krijohet një sistem më i qëndrueshëm dhe më efikas që mund të përballojë sfidat e një popullate të moshuar, duke siguruar kujdes më të mirë shëndetësor dhe social dhe më të integruar për individët e moshuar.

Tregues performance:

- Protokolle të kujdesit shëndetësor parësor lidhur me vlerësimin e problemeve mbizotëruese te të moshuarit, të tilla si: rënia e aftësive konjitive, dhembja, rënia e shikimit dhe e dëgjimit, rënia e lëvizshmërisë dhe hapësirës jetike, menaxhimi i multipatologjive, kështillimi mbi medikamentet etj.;

- Udhërrëfyes specifikë lidhur me shërbimet e kujdesit oral, oftalmologjik, audiologjik dhe fizioterapeutik për të moshuarit;

- Përgatitje e një programi intensiv për trajnimin mbi geriartrinë në nivel kombëtar. Organizim i kurseve afatshkurtra të trajnimit si pjesë e edukimit të vazhduar: 5 kurse të akredituara;

- Rishikimi i planit spitalor me qëllim riorganizimin e shërbimeve me shtretër dhe përmirësim i normave që garantojnë shpërndarje të përshtatshme të shtretërve spitalorë për kujdesin afatgjatë për të moshuarit.

- Futja e specializimit në Geriatri në universitete, bursa për studime jashtë dhe hapja e njësive geriatrike në spitalet rajonale.

- Trajnime të detyrueshme, bonuse performance dhe ngritja e profilit të kujdestarit geriatrik si profesion i mirëfilltë

Tregues ndikimi

- Pilotim i njësive kushtuar kujdesit geriatrik në Qendrën Spitalore Universitare dhe në 2 spitale rajonale me standard orientues minimal, 2 shtretër për 1,000 banorë mbi 65 vjeç, përfshirë shtretër psikiatrikë për të moshuar. Përcaktim i shtretërve kushtuar kujdesit paliativ[52];

- Protokolli klinik dhe udhërrëfyesi i përgatitur për shërbimet e kujdesit dentar, oftalmologjik, audiologjik dhe fizioterapeutik për të moshuarit;

- 400 qendra shëndetësore të pajisura me paketën e instrumenteve përkatëse.

Objektivi specifik A.3: Përfshirja e moshimit në të gjithë sektorët dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha niveleve të qeverisjes.[53]

Aktiviteti A.3.1: Ngritja e strukturave koordinuese dhe këshilluese në nivele të larta të qeverisjes qendrore dhe vendore për ndjekjen e politikave të përfshirjes për të moshuarit.

Përfshirja e moshimit në të gjitha nivelet, kërkon një qasje të gjithë institucioneve qeveritare, ministrive të linjës dhe përfaqësues nga agjenci të specializuara, si Instituti i Statistikave. Vëmendje duhet t'i kushtohet edhe angazhimit nga parlamenti, si dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesve nga pushtetit lokal.

Qasja e gjithë shoqërisë synon përfshirjen e palëve të interesuara, si shoqëria civile dhe grupet e interesit. Këto qasje mund të ndihmojnë në informim për zhvillimin e kornizës strategjike për integrimin e moshimit, që marrin parasysh perspektivat shtetërore dhe shoqërore. Në të njëjtën kohë mund të nxisë ndërgjegjësimin dhe të mbështesë integrimin e moshimit, në çështjet

[52] Është transferuar i gjithë aktiviteti nga dokumenti politik për moshimin dhe plani i veprimit, 2020–2024, pasi është i parealizuar dhe rekomandim në raportprogresin për zbatimin e tij.

[53] https://unece.org/sites/default/files/2021-03/Stage-3-visions-and-directions.pdf

përkatëse sipas mandateve, politikave dhe programeve institucionale. Një mekanizëm koordinues qeveritar, në nivel më të lartë, mund të ndihmojë në sigurimin e koherencës përmes koordinimit ndërsektorial (horizontal) dhe shumënivelësh (vertikal) **(Parlamenti + Këshilli i Ministrave + MSHMS + Bashkitë)**.

Rezultatet e pritshme: Përfshirja e të moshuarve në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Treguesit e performancës:

- Përgatitja e një udhëzuesi për strukturat e përkohshme në nivel qendror dhe vendor, me qëllim politikat e integruara të moshimit;
- Përgatitja e akteve ligjore për ngritjen e strukturave koordinuese dhe këshilluese *Ad-hoc* në nivel të lartë qendror dhe vendor dhe përcaktimi i funksioneve dhe përgjegjësive.

Tregues ndikimi:

- Ngritja e Këshillit Kombëtar dhe/ose Lokal i të Moshuarve me përfshirjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit;
- Ngritja e Nënkomitetit Parlamentar për Moshimin;
- Ngritja e kapaciteteve të pikave fokale për moshën e tretë në nivel qendror dhe vendor.

Aktiviteti A.3.2: Qasja drejt zhvillimit të llogarive kombëtare të transfertave.

Moshimi është një nga sfidat më të mëdha në shoqëritë moderne pas tranzicionit të tyre demografik. Ndryshimet në strukturën e moshës së popullsisë ndikojnë në organizimin socioekonomik. Për të studiuar ndikimin e moshimit dhe shtrirjen natyrore të tij, Llogaritë Kombëtare të Transferimit janë burime të vlefshme të dhënash. Ato ofrojnë profile kombëtare të moshës, të variablave kryesorë ekonomikë (të tregut dhe jotregut), duke informuar se si burimet prodhohen, ndahen dhe konsumohen nga individë të moshave të ndryshme që bashkëjetojnë në të njëjtin moment.

Llogaritë Kombëtare të Transferimit kanë potencialin për të studiuar ekonominë gjeneruese, duke përfshirë edhe dividendin demografik – si ndikon moshimi në rritjen ekonomike – dhe efektet e moshimit në sistemin e mirëqenies. Në përgjithësi, Llogaritë Kombëtare të Transferimit kanë dëshmuar në vende të ndryshme se janë burim i çmuar i të dhënave për të pasuruar analizën e efekteve të moshimit në shoqëritë tona.[54]

Llogaritë Kombëtare të Transferimit për moshimin janë kornizë e përdorur për të analizuar rrjedhën ekonomike të burimeve midis grup-moshave të ndryshme brenda një popullsie. Ato ofrojnë një mënyrë gjithëpërfshirëse për të vlerësuar se si transferohen burimet midis individëve të moshave të ndryshme, veçanërisht duke u fokusuar në modelet e të ardhurave, konsumit dhe kursimeve gjatë gjithë jetëgjatësisë.

Sistemi i Llogarive Kombëtare të Transferimit ndihmon për të kuptuar ciklin e jetës ekonomike, veçanërisht për sa i përket mënyrës se si popullsia në moshë pune mbështet grup- moshat që nuk punojnë, si fëmijët dhe të moshuarit. Ky aktivitet do të përfshihet në Programin e Ri të Statistikave Zyrtare në përfundim të programit aktual 2022–2026.

Në kontekstin e moshimit të popullsisë, Llogaritë Kombëtare të Transferimit i lejojnë politikëbërësit të vlerësojnë se si të dhënat demografike mund të ndikojë në ekonomi, duke theksuar: mbështetjen në rritje të të moshuarve në transfertat nga popullsia në moshë pune; barrën financiare të mbështetjes së individëve të moshuar, ndërsa normat e lindshmërisë bien dhe jetëgjatësia rritet; potencialin për transferime ndërmjet brezave dhe ndryshimet në raportin e varësisë (raporti i njerëzve që janë zakonisht të varur, si fëmijët dhe të moshuarit, ndaj popullsisë në moshë pune).[55]

Rezultate të pritshme: Mundësimi i analizës të profileve kombëtare të moshës, të variablave kryesorë ekonomikë (të tregut dhe jo-treg), duke informuar se si burimet prodhohen, ndahen dhe konsumohen nga individë të moshave të ndryshme që bashkëjetojnë në të njëjtin moment **(INSTAT + MF + Partnerë ndërkombëtarë).**

Tregues perfomance:

Përgatitja e një studimi të detajuar si fazë e parë për zhvillimin e llogarive kombëtare të transfertave.

Tregues ndikimi:

Përgatitja e një studimi të detajuar si fazë e parë për zhvillimin e llogarive kombëtare të transfertave.

Aktivieti A.3.3: Qytetet dhe komunitetet miqësore të moshave

[54] https://www.researchgate.net/publication/375790721_Using_National_Transfer_Accounts_to_Address_Ageing

[55] https://www.ntaccounts.org/wwwb/nta/show/Methodology

Numri i të moshuarve po rritet me shpejtësi. Ky ndryshim demografik ndikon thellësisht te sistemet e ndryshme ndërkombëtare të kujdesit shëndetësor dhe të mirëqenies. Shumica dërrmuese e të moshuarve dëshirojnë të moshohen në vendin e tyre. Shumë përdorin shërbimet e kujdesit afatgjatë, duke përfshirë kujdesin në shtëpi, shërbimet e rehabilitimit dhe mbështetjen sociale, si dhe modifikimet dhe teknologjinë në shtëpi, megjithëse, në kundërshtim me besimin popullor, kjo nuk është shumica e të moshuarve.

Një mënyrë për të mbështetur të moshuarit për të jetuar jetën që dëshirojnë është përmes iniciativës: Qytetet dhe Komunitetet Miqësore të Moshave, një program mbarëbotëror i nisur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në 2007, me qëllim që qytetet t'u përshtaten më shumë nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të moshuar.

Organizata Botërore e Shëndetësisë i përkufizon Qytetet dhe Komunitetet Miqësore të Moshave, si më poshtë: "Në një komunitet miqësor ndaj moshës, politikat, shërbimet dhe strukturat që lidhen me mjedisin fizik dhe social janë krijuar për të mbështetur dhe aftësuar të moshuarit të "moshohen në mënyrë aktive" – domethënë të jetojnë në siguri, të gëzojnë shëndet të mirë dhe të vazhdojnë të marrin pjesë plotësisht në shoqëri"[56].

Aktivitete miqësore mjedisore, si energjia e rinovueshme, menaxhimi i mbetjeve, ndihma për ruajtjen e biodiversitetit krijojnë një ndikim pozitiv për individët e moshës së tretë dhe për shoqërinë.

Nga ana tjetër komunitetet mund të jenë miqësore ndaj moshës dhe rezistente ndaj klimës: një aleancë gri-jeshile. Të moshuarit shpesh goditen më rëndë nga moti ekstrem, cilësia e dobët e ajrit dhe ndikimet e tjera klimatike, dhe aktualisht nga vala e të nxehtit. Por shumë zgjidhje miqësore për moshën tashmë harmonizohen edhe me çështjet e ndryshimeve klimatike.

Për shembull:

- Transporti publik më i mirë i ndihmon të moshuarit të lëvizin duke reduktuar emetimet e karbonit.

- Më shumë parqe dhe hapësira të mbuluara me pemë i mbajnë komunitetet më të freskëta gjatë valëve të të nxehtit, ndërkohë që krijojnë vende të këndshme për t'u mbledhur së bashku.

Duke shtuar zyrtarisht elasticitetin klimatik si një fushë, komunitetet mund të ndajnë më mirë njohuritë dhe strategjitë, duke avancuar përfundimisht objektivat miqësorë ndaj moshës dhe qëndrueshmërinë ndaj klimës**.**

Nxitja e vullnetarizimit në nivel vendor është, gjithashtu, një vlerë e shtuar për të ndihmuar të moshuarit e vetmuar në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore **(Bashkitë + Qarqet + Rajonet)**.

Rezultate të pritshme: Përfshirja e të moshuarve në jetën komunitare dhe ruajtja e aftësive fizike dhe mendore, nëpërmjet një komuniteti miqësor në territorin ku banojnë.

Treguesit e performancës:

- Hartimi i një studimi për 12 qarqet, që të përfshijë nevojat, mundësitë, hapësirat dhe identifikojë kostot dhe burimin e financimin për përfshirjen e të moshuarve dhe krijimin e një qyteti miqësor për moshën e tretë;

- Përgatitja e një raporti mbi ndryshimet klimatike në territorin e vendit dhe impakti te të moshuarit. Rekomandimet për zbatim;

- Politika mbështetëse lokale për strehimin dhe promovimin e jetesës së pavarur të individëve të moshës së tretë (bonuse qiraje, përfitimi nga banesat e specializuara, programet e shërbimeve sociale-shëndetësorë, transport falas, ekonomia e gjelbër etj.).

- Krijimi i një sistemi ku të rinjtë grumbullojnë orë për vullnetarizëm që më pas u njihen si kredi sociale apo përfitime të tjera në të ardhmen.

Treguesit e ndikimit:

- 30% e bashkive kanë përfshirë në planet dhe programet e tyre hapa konkretë për përfshirjen e të moshuarve në jetën komunitare dhe kanë pranuar iniciativën "Qytetet dhe Komunitetet Miqësore të Moshave", sipas planeve strategjike të bashkive;

- Në çdo bashki janë regjistruar jo më pak se 20 vullnetarë dhe 3 organizata të shoqërisë civile që punojnë me të moshuarit duke zhvilluar kështu edhe partneritetin shtet – shoqëri civile;

- Në çdo bashki do të zhvillohet çdo vit një aktivitet sportiv dhe një aktivitet artistik për moshën e tretë. (Shembull: kampionat futbolli, basketbolli, shahu, dominoje, dhe/ose konkursi "Zëri më i bukur ", "Vallja më e bukur ", "Grupi popullor vokal më i mirë".)

[56] https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC7914698/Age-Friendly Cities and Communities: State of the Art and Future Perspectives

- Krijimi i një regjistri për të moshuarit që jetojnë vetëm, në çdo bashki, shërbime të rregullta vizitash në shtëpi dhe programe ndërbreznore me vullnetarë të rinj.

2. Politika B: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për moshimin

2.1. Qëllimi i politikës B

Ndërgjegjësimi i shoqërisë për moshimin dinjitoz dhe masat për parandalimin e vetmisë dhe moshimin e shëndetshëm.

2.2. Rezultati i pritshëm

Një shoqëri me në qendër familjen, që mbështet dhe promovon moshimin e shëndetshëm, aktiv dhe miqësor, duke parandaluar abuzimin, diskriminimin dhe vetminë e të moshuarve.

2.3. Objektivat specifikë

Objektivi specifik B.1: Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut nëpërmjet fushatave mediatike.

Objektivi specifik B.2: Ndërveprimi ndërmjet brezave nëpërmjet programeve edukative të trinimit për të rinjtë dhe komunitetin dhe krijimi i mundësive për aktivizim dhe pjesëmarrje.

2.4. Aktivitetet sipas objektivave specifikë

Objektivi specifik B.1: Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut nëpërmjet fushatave mediatike.

Aktiviteti B.1.1. Përgatitja e posterave dhe broshurave dhe organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit.

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve festohet çdo vit në mbarë botën më 1 tetor, që kur është miratuar zyrtarisht nga OKB-ja, në dhjetor të vitit 1990. Kjo ditë është një mundësi për të njohur zyrtarisht kontributet e të moshuarve në shoqëri dhe për të promovuar zhvillimin e një bote që përfshin moshën.

Shoqata Amerikane për Moshimin ka identifikuar 9 tetorin 2024, si "Ditën e Ndërgjegjësimit për Moshimin".

Dita Ndërkombëtare kundër Abuzimit me të Moshuarit – 15 qershori apo edhe 10 dhjetori - Dita për të Drejtat e Njeriut, janë ditë të cilat u dedikohen fushatave ndërgjegjësuese për moshën e tretë.

Fushatat e ndërgjegjësimit i referohen stereotipave (si mendojmë), paragjykimeve (si ndihemi) dhe diskriminimit (si veprojmë), ndaj të tjerëve ose vetvetes bazuar në moshën. Mosha ndikon negativisht në shëndetin dhe mirëqenien tonë, sigurinë tonë financiare dhe ekonominë, në shumë forma, që nga ndërveprimet personale deri tek te politikat publike.

Mbrojtja e të moshuarve nga abuzimi është gjithashtu kritike. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë politikat dhe ligjet kundër diskriminimit, ndërhyrjet arsimore dhe aktivitetet ndër breza. Një sërë ndërhyrjesh mund të hartohen në lidhje me veprimtarinë e kujdestarëve të moshës së tretë, duke përfshirë standardet e përkujdesjes, monitorimin e zbatimit të tyre, këshillat, edukimin, mbështetjen financiare dhe ndërhyrjet psikologjike, të cilat ndikojnë në mbajtjen e një marrëdhënie të mirë dhe të shëndetshme përkujdesjeje që shmang abuzimin e të moshuarve.

Lajmi i mirë është se ne mund të bëjmë diçka për ndërgjegjësimin e shoqërisë, dhe ne fillojmë duke përhapur fjalën në Ditën e Ndërgjegjësimit të Moshimit.[57]

Pjesëmarrës në fushata mund jenë njerëz që do të ndërmarrin veprime për të krijuar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të moshës, kujdestarët dhe familjet, ndikuesit, të moshuar, organizatat e fokusuara në shëndetin/ofruesit e shëndetit dhe kujdesit, profesionistët e shërbimeve, të rinjtë/brezat e rinj/grupet ndër breza.

Reagimi ndaj abuzimit të të moshuarve është gjithashtu kritik. Ndërhyrjet premtuese përfshijnë raportimin e detyrueshëm të abuzimit, grupet e vetëndihmës, linjat e ndihmës dhe strehimit e urgjencës, programet psikologjike për abuzuesit, trajnimin e ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe ndërhyrje të tjera mbështetëse të kujdestarëve.

Strategjitë e promovimit dhe parandalimit të shëndetit mendor për të moshuarit fokusohen në mbështetjen e moshimit të shëndetshëm. Kjo nënkupton krijimin e mjediseve fizike dhe sociale që mbështesin mirëqenien dhe u mundësojnë njerëzve të bëjnë atë që është e rëndësishme për ta, pavarësisht humbjeve në kapacitet.

Përgatitja e fletëpalosjeve, posterave, apo materialeve të tjera vizuale, promocionale, apo edhe video ilustruese me praktika pozitive, do të japin edhe informacionin e nevojshëm për të gjithë individët dhe shoqërinë në tërësi për edukimin dhe ndërgjegjësimin se moshimi është një etapë e jetës

[57] https://www.asaging.org/ageism-awareness

me të cilën do të përballen të gjithë **(MSHMS + SHSSH + BASHKITË + AMA**).

Rezultatet e pritshme: Edukimi i shoqërisë se moshimi është një etapë e jetës të cilën do ta kalojnë të gjithë individët dhe shoqëria.

Treguesit e performancës:

Përgatitja e fletëpalosjeve, posterave, video dhe materiale promocionale dhe informuese për edukimin e shoqërisë për qëndrimet që duhet të mbajnë ndaj steriotipave, paragjykimeve, diskriminimit apo abuzimit të të moshuarve.

Treguesit e ndikimit:

- 3 fushata sensibilizuese/vit;
- 1 emision televiziv i dedikuar për moshimin;
- Miratimi i kodit të sjelljes për kujdestarët e të moshuarve.

Aktiviteti B.1.2: Fushata sociale dhe angazhimi i influencuesve.

Fushatat sociale mund të angazhojnë ekspertë të shëndetit, psikologë dhe profesionistë të fushës së moshimit, apo edhe punonjës të nivelit qendror dhe lokal, të cilët mund të japin informacion mbi moshimin dhe mënyrat e përkujdesjes ndaj shëndetit, duke përfshirë këtu këshillime për mirushqyerjen, aktivitetin fizik, nevojën për një jetë aktive dhe informacion për sistemet e referimit dhe mekanizmat e kujdesit.

MSHMS-ja apo bashkitë mund të përzgjedhin një numër të caktuar të influencuesve (rrjeti i influencuesve), të cilët të japin mesazhe mbi përfitimet për jetën e shëndetshme të të moshuarve, rëndësinë e kujdesit për shëndetin mendor dhe fizik, si dhe rëndësinë e përdorimit të teknologjisë. Influencuesit mund të nxisin dialogun, duke inkurajuar të moshuarit të ndajnë eksperiencat e tyre, pyetje e përgjigje mbi moshimin etj. Ata mund të ndikojnë në përmirësimin e perceptimit mbi moshimin duke promovuar mesazhet pozitive mbi moshimin. Kjo mund të përfshijë përdorimin e hashtageve dhe ngjarjeve për t'i bërë çështjet e moshimit më të prekshme dhe më të dukshme (**MSHMS + SHSSH + Bashkitë + Rrjeti i influencuesve**).

Rezultatet e pritshme: Ndryshimi i perceptimeve sociale për të inkurajuar një shoqëri më të vëmendshme ndaj problemeve të moshimit dhe nevojave të të moshuarve.

Treguesit e performancës:

- Identifikimi dhe miratimi i listës së influencuesve (rreth 10–15), aktivistëve dhe profesionistëve për moshimin në nivel qendror dhe vendor që do të merren me nxitjen e fushatave sociale;
- Përgatitja e një plani të detajuar të fushatave sociale dhe një udhëzim i miratuar me mesazhe të qarta për çdo fushatë.

Treguesit e ndikimit:

- 3 fushata sociale çdo vit;
- 500 të moshuar të përfshirë në dialogun për moshimin;
- 10–15 influencues dhe mbi 50 profesionistë apo punonjës të institucioneve në nivel qendror dhe vendor të përfshirë në dialog.

Aktiviteti B.1.3: Forumet publike dhe ngjarjet për ndërgjegjësimin e moshimit.

Organizimi i forumeve të diskutimit, të cilat u japin mundësinë të moshuarve të diskutojnë për jetën dhe eksperiencat e tyre ndihmojnë jo vetëm në jetën e tyre aktive, por edhe në uljen e nivelit të ankthit ndaj problemeve të moshës, apo për përfshirjen e të moshuarve të vetmuar në jetën shoqërore. Kjo ndihmon të moshuarit edhe në aspektin e kujdesit për shëndetin mendor, në ripërtëritjen e kujtesës, apo marrjen e informacioneve dhe ndarjen e opinioneve për ngjarje të ndryshme. Pjesëmarrja e grave në këto forume apo diskutime, apo e të moshuarve nga zonat rurale do të ishte një mundësi shumë e mirë për përfshirjen e tyre dhe ndarjen e eksperiencave. Përfshirja e të rinjve në këtë dialog është e rëndësishme për ndërveprimin ndërmjet brezave **(MSHMS + SHSSH + ISHP + Bashkitë).**

Të tilla aktivitete mund të organizohen edhe nga njësitë administrative në pushtetin lokal, duke përdorur edhe qendrat komunitare të shërbimeve sociale që janë ngritur apo do të ngrihen në bashki, në zbatim të planeve sociale lokale.

Rezultatet e pritshme: Sigurimi i ndihmës ndaj të moshuarve për përballimin e sfidave të moshimit.

Treguesit e performancës:

- Përfshirja e organizimit të forumeve të dialogut dhe tematikat që do të diskutohen nga 12 qarqet (61 bashki) në planet sociale lokale;
- Identifikimi i listës së të moshuarve nga 61 bashki, sipas specifikave (të vetmuar dhe/ose aktivë, të shëndetshëm dhe/ose me sëmundje kronike).

Treguesit e ndikimit:

- 3 aktivitete/vit, në çdo bashki;
- 30–40 pjesëmarrës të moshuar pjesëmarrës për secilin aktivitet nga të cilët 50% gra;

- Numri i publikimeve dhe përhapja e mesazheve të forumit apo ngjarjes në media (si gazeta, televizion, platforma *online)* mund të tregojë se sa është shpërndarë informacioni për moshimin në nivelin më të gjerë.

Objektivi specifik B.2: Ndërveprimi ndërmjet brezave nëpërmjet organizimit të programeve edukative për të rinjtë dhe komunitetin dhe krijimi i mundësive për aktivizim dhe pjesëmarrje.

Aktiviteti B.2.1: Krijimi i Institucionit të Arsimit të Lartë Profesional për Moshën e Tretë [58].

Institucioni i Arsimit të Lartë Profesional për Moshën e Tretë është një organizatë arsimore unike, inovative dhe globale për njerëzit e moshës 50 vjeç e lart. Ai u ofron të rriturve të moshuar mundësinë për të vazhduar mësimin dhe zhvillimin e tyre personal në një shumëllojshmëri të gjerë aktivitetesh dhe lëndësh përmes studimit me kohë të pjesshme dhe ndërveprimit social dhe kohezionin social.

Për të moshuarit, lidhja sociale është veçanërisht e rëndësishme për të reduktuar faktorët e rrezikut si izolimi social dhe vetmia. Në këtë fazë të jetës, aktivitetet shoqërore kuptimplotë mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin mendor, rrisin kënaqësinë nga jeta dhe cilësinë e jetës, ato gjithashtu mund të zvogëlojnë simptomat e depresionit. Shembuj të ndërhyrjeve përfshijnë nismat e miqësisë me komunitetin dhe grupet mbështetëse, trajnimin e aftësive sociale, grupet e arteve krijuese, shërbimet e kohës së lirë dhe arsimore dhe programet e vullnetarizmit.

Institucioni i Arsimit të Lartë Profesional për Moshën e Tretë u ofron mundësi të moshuarve, për të mësuar gjatë gjithë jetës, ndërveprim social dhe pjesëmarrje në komunitet.

Kurset do të krijohen nga anëtarët për anëtarët dhe mbulojnë një gamë të gjerë interesash, duke përfshirë artet, profesionet, gjuhët, historinë, shkencën, filozofinë, çështjet aktuale dhe më shumë.

Institucioni i Arsimit të Lartë Profesional i Moshës së Tretë (U3A) ka rezultuar një lëvizje shumë e suksesshme për edukimin e të rriturve, i cili ofron mundësi për të rriturit e moshuar që të marrin pjesë një sërë aktivitetesh që lidhen me mirëqenien në jetën e mëvonshme. Dy qasje thelbësisht të ndryshme, kanë qenë modelet pozitive që janë përdorur: qasja origjinale franceze dhe ajo britanike, e cila u zhvillua disa vite më vonë, janë bërë modelet dominuese, të miratuara nga vende të ndryshme. Brenda shumë vendeve komunikimet ndërmjet grupeve individuale të U3A janë të kufizuara; mes vendeve ka edhe më pak komunikim **(MSHMS + MAS + MEKI)**.

Rezultatet e pritshme: Stimulimi i aktivitetit mendor, nëpërmjet mësimit gjatë të gjithë jetës, që krijon lidhje sociale duke reduktuar ndjenjën e vetmisë, si edhe ndikon në eksplorimin e interesave që të moshuarit nuk kanë mundur t'i zhvillojnë më parë, pra promovimin e jetës aktive.

Treguesit e perfomancës:

- Iniciimi dhe miratimi i akteve ligjore për hapjen e Institucionit të Arsimit të Lartë Profesional për Moshën e tretë
- Përgatitja e programeve: kurset, aktivitetet dhe ngjarjet të ofruara për anëtarët (p.sh., arsimore, kulturore, sociale).

Treguesit e ndikimit:

- Krijimi i një modeli të institucionit të arsimit të lartë profesional për moshën e tretë në Tiranë;
- 80 Individë të moshuar të cilët ndjekin kurset e këtij Institucionit të Arsimit të Lartë Profesional për Moshën e Tretë.

Aktiviteti B.2.2: Inicimi i një projekti pilot ku "të moshuarit të birësojnë një shkollë".

MSHMS-ja, në bashkëpunim me SHSSH-në, MAS-in dhe pushtetin vendor, do të iniciojë një projekt të dedikuar për moshën e tretë, i cili trajton marrjen nën kujdes apo birësimin e një shkolle nga një grupim i caktuar të moshuarish dhe/ose shoqatë të moshuarish.

Kjo do të ndihmonte në ndërveprimin ndërmjet brezave, duke angazhuar vullnetarisht të moshuarit në mentorim, diskutime, dhënie leksionesh etj., duke shfrytëzuar kohën e lirë të nxënësve për ndarjen e përvojave apo kurseve në lëndë të caktuara si: matematika, gjuha, arti, fizika, fizkultura etj.

Pjesëmarrja e të rinjve së bashku me të moshuarit në forume, seminare, aktivitete sportive e kulturore, në komunitete dhe më gjerë, mbjellja e pemëve, apo aktivitete të tjera në lidhje me klimën, krijojnë mundësi ndërveprimi dhe mentorimi dhe krijon gjithashtu një ndërveprim të zbatimit të politikave sociale, shëndetësore dhe ndihmojnë përfshirjen e të moshuarve në jetën komunitare.

[58] https://seniorocity.com.au/university-of-the-third-age-u3a-everything-you-need-to-know/

Ofrimi i kurseve dhe i seminareve në shkolla, universitet dhe komunitete për t'u mësuar të rinjve mbi vlerat e moshimit dhe si të respektojnë të moshuarit është i nevojshëm. Kjo mund të përfshijë diskutime mbi diskriminimin ndaj të moshuarve, etikën sociale dhe ndihmën për të moshuarit.

Kjo është një formë për angazhimin e të moshuarve që janë të shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht dhe të aftë profesionalisht, por që ndihmon shkollën dhe prindërit **(MSHMS + MAS + OJF)**.

Rezultate të pritshme: Krijimi i mundësive për aktivizim dhe pjesëmarrje të individëve të moshuar dhe ndërveprimin ndërmjet brezave.

Tregues performance:

- Hartimi i projektit, inicimi nga MSHMS-ja nëpërmjet nxitjes së donatorëve, partnerëve, OJF-ve për zbatimin e projektit, apo e një bashkie;

- Përgatitja e TOR-së për akademikët apo ish-mësuesit, apo profesionistë që do të angazhohen në këtë projekt.

Tregues ndikimi:

- Krijimi i një modeli nëpërmjet zbatimit të projektit "Të birësojmë një shkollë".

Aktiviteti B.2.3: Nxitja e rolit të familjarëve në kujdesin për të moshuarit.

Duke qenë se në themel të shoqërisë sonë është familja, roli i familjarëve në kujdesin për të moshuarit është shumë i rëndësishëm. Nga eksperiencat e deritanishme familjarët shpesh luajnë edhe rolin e kujdestarit informal për të moshuarit, pjesëtarë të familjes. Por në të njëjtën kohë ka edhe raste të abandonimit të të moshuarve nga familjarët. Raportimet e rasteve të neglizhencës, abuzimit e dhunës nga të moshuarit duhet të raportohen, por në të njëjtën kohë edhe stresi apo kostoja financiare e familjarëve që kanë në përbërjen familjarë të moshuar duhet të mbështeten me këshillime psikologjike, apo asistencë sociale, sidomos për rastet kur të ardhurat financiare të familjes janë të pamjaftueshme.

Familjarët kanë një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien sociale dhe jetëgjatësinë e anëtarëve të moshuar të familjes. Ata luajnë rol mbështetës edhe në angazhimin social të anëtarëve të moshuar të familjes, si: shëndeti mendor dhe mirëqenia e përgjithshme, mbështetja për sjellje të shëndetshme, veçanërisht në drejtim të kujdesit për mirushqyrjen, shëndetin fizik, kujdesin ndaj mospirjes së duhanit apo kufizimin e alkoolit, si dhe zbatimin e programeve shëndetësore dhe sociale të posaçme për grupet vulnerabël dhe ata që jetojnë me një gjendje kronike shëndetësore.

Për të gjitha këto arsye është e nevojshme që familjarët të instruktohen nga profesionistët e fushës.

Rezultate të pritshme: Individët e moshuar kanë jetë të shëndetshme brenda familjes.

Treguesit e performancës:

- Përgatitja e një studimi mbi situatën aktuale të familjeve që kanë të moshuar;

- Hartimi i një udhëzuesi bazë për ndikimin e kujdesit familjar ndaj të moshuarve.

Treguesit e ndikimit:

- Mundësimi i një kursi këshillimi për familjarët që kanë në shtëpi të moshuar;

- 300 familjarë certifikohen si kujdestarë/ndihmës personal.

Aktiviteti B.2.4: Promovimi i shëndetit dhe aktiviteti fizik për të moshuarit.

Të rrisim ndërgjegjësimin dhe informacionin mes personave mbi 50 vjeç lidhur me mënyrat, sjelljet e praktikat për moshimin e shëndetshëm aktiv dhe për jetën autonome në moshë të vjetër. Shëndeti në moshë të vjetër është rezultat i kushteve dhe i stilit të jetesës së një individi gjatë gjithë jetës së tij. Duke u përpjekur për një stil jetese më të shëndetshëm në faza të ndryshme të jetës dhe duke u përshtatur me ndryshimet që lidhen me moshën, individët mund të ndikojnë në moshimin e tyre të shëndetshëm. Gjithashtu, lidhja midis parandalimit të sëmundjeve kronike dhe moshimit të shëndetshëm është nënvizuar në dokumentet bazë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kjo ndërhyrje fokusohet në grup-moshat e fillimit të moshimit, ata mbi 50 vjeç, dhe përfshin veç parandalimit parësor, edhe atë dytësor e tretësor. Më tej, pa harruar aktivitetet kundër duhanpirjes, abuzimit me alkoolin dhe kontrollit të peshës trupore, theksi do të vendoset në tri grupe aktivitetesh që janë më specifike për cilësinë e jetës së të moshuarve dhe janë provuar si më efektive për të siguruar një jetë autonome në moshë të vjetër: **aktiviteti fizik, parandalimi i rrëzimeve dhe kapja e hershme e depresionit.**

Aktiviteti fizik është ndër treguesit më efektivë të moshimit të shëndetshëm, sidomos për moshat shumë të vjetra. Ai mund të përmirësojë funksionet respiratore dhe të lëvizshmërisë, si dhe të ulë rrezikun për sëmundje kronike, depresion dhe

demencë. Rrëzimet te të moshuarit janë ndër shkaqet kryesore të uljes së lëvizshmërisë dhe përbëjnë rrezik madhor për humbje të autonomisë funksionale. Disa prej tyre (si p.sh., frakturat e femurit) kërkojnë zakonisht procedura spitalore me kosto shumë të lartë. Rreziku i rrëzimeve rritet shpejt me rritjen e moshës. Megjithatë, shumica e rrëzimeve mund të parandalohen. Megjithëse Programi Kombëtar i Kontrollit Shëndetësor Bazë ka përfshirë edhe grupe të personave mbi 65 vjeç, përdorimi i disa teknikave të identifikimit dhe menaxhimit të hershëm të problemeve shëndetësore, siç është depresioni, mbetet në nivele mjaft të ulëta **(ISHP + Bashkitë + OJF).**

Rezultatet e pritshme: Rritja e ndërgjegjësimit dhe informacionit për sjelljet dhe praktikat për moshimin e shëndetshëm aktiv dhe jetën autonome në moshë të vjetër.

Treguesit e performancës

- Përgatitje e instruksioneve/standardeve për personat mbi 70 vjeç për parandalimin e rrëzimeve të të moshuarve në institucionet e kujdesit dhe në vendbanim. Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse *(hip protectors)* për personat mbi 70 vjeç në rrezik të lartë;
- Rritje e përdorimit sistematik të programeve të kapjes së hershme të hipertensionit dhe diabetit te popullata mbi 50 vjeç nga shërbimet e kujdesit shëndetësor. Rritje e ndërgjegjësimit mbi depresionin te të moshuarit dhe lufta kundër stigmës, në kuadër të identifikimit të hershëm të shenjave dhe menaxhimit të përshtatshëm në shërbimet e kujdesit parësor;
- Zbatimi i Planit të Promocionit Shëndetësor nga Instituti i Shëndetit Publik.

Treguesit e ndikimit:

- 500 institucione kanë filluar t'i aplikojnë instruksionet/standardet për personat mbi 70 vjeç për parandalimin e rrëzimeve të të moshuarve;
- 500 pajisje të shpërndara[59];
- Përgatitja e një studim vlerësimi me fokus ekzaminimet e hipertensionit, diabetit dhe pyetësorin e depresionit; 80% e personave mbi 50 vjeç ka kryer të paktën një ekzaminim për hipertensionin dhe diabetin dhe 50% e popullatës mbi 50 vjeç ka kryer pyetësorin e depresionit në programin e kontrollit bazë shëndetësor.

PJESA IV
MONITORIMI I PLANIT KOMBËTAR

4.1. Mekanizmat e zbatimit dhe koordinimit

Plani i veprimit do të zbatohet përgjatë periudhës 2025–2030. Rol udhëheqës në zbatimin e tij do të ketë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni përgjegjës për fushën e mbrojtjes sociale. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë dhe çdo ndërhyrje brenda masës është përcaktuar në dokument, sipas secilës politikë, objektiv specifik dhe aktivitet.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në fushat e përgjegjësisë shtetërore të miratuar me VKM-në nr. 508, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

Me urdhrin nr. 205, datë 23.10.2024, të Kryeministrit; "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", brenda Drejtorisë së Politikave të Përfshirjes Sociale është krijuar "Sektori i Ekipit Burimor", në zbatim të Dokumentit Politik të Përfshirjes Sociale, i cili është përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike ndërsektoriale, përfshirë edhe Dokumentin për Moshimin dhe Planin e Veprimit për zbatimin e tij, duke grumbulluar informacionin e nevojshëm nga të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin, informacion që lidhet me zbatimin e dokumenteve strategjike dhe duke përgatitur analizën cilësore (kualitative).

Grumbullimi i të dhënave sasiore (kuantitative), apo statistikore bëhet nga Drejtoria e Analizave dhe Statistikave në MSHMS.

Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar të informacionit të planifikimit (SIPI/IPSIS)", me qëllim planifikimin, analizën, përgatitjen e të gjitha llojeve të dokumenteve strategjike, si dhe për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuar, krijoi një sistem IT për

[59] Të parealizuara nga Plani Kombëtar i Moshimit, 2020–2024.

lëshimin e pasaportave dhe treguesve të planeve të tyre të veprimit për dokumentet strategjike. Për të ndjekur monitorimin e dokumenteve strategjike, zbatimin e qëllimeve, objektivave strategjikë, indikatorëve të performancës dhe pasaportave të indikatorëve ekipi burimor duhet të zbatojë:

1. Manuali i Përdoruesit për Standardet e Monitorimit (IPSIS),

2. Udhëzuesin metodologjik për strukturën e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale;

3. Udhëzuesin strukturor për raportet e monitorimit për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale.

Me VKM-në nr. 642, datë 29.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës", është krijuar SASPAC.

Misioni i Agjencisë është të koordinojë ndihmën e huaj për programet dhe projektet e zhvillimit, të ndihmojë strukturat vendimmarrëse në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe të monitorojë zbatimin e saj, të ofrojë mbështetje metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me synim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e administrimit kombëtar për mbështetjen e projekteve shtetërore për të rritur procesin e zhvillimit. kapacitetet në fushën e programeve dhe projekteve zhvillimore.

Në të njëjtën kohë SASPAC-i ka në fushën e vet të përgjegjësisë administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit IPSIS.

IPSIS-i nuk është funksional aktualisht, ndërkohë që SASPAC-i është në negociata me ASHKI-n për rikthimin në funksion të IPSIS-it

MSHMS-ja do të raportojë në SASPAC për vlerësimin e monitorimit të këtij dokumenti nëpërmjet sistemit IPSIS dhe/ose duke dërguar manualisht raportin vjetor.

Një nga strukturat që ndjek performancën dhe raportimet e monitorimit të zbatimit të Dokumentit Politik mbi Moshimin dhe Planin e Veprimit, 2025–2030, është GMIP "Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara", kryesisht GMIP "Për zhvillimin e kapitalit njerëzor", nën grupet tematike "Mbrojtja sociale" dhe "Grupet e margjinalizuara", të cilat drejtohen nga zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

GMIP-ja është krijuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", dhe mblidhet 2 herë/vit. Raporti i monitorimit të Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planit të Veprimit 2025–2030 do të konsultohet në takimet e GMIP-së si një dokument ndërsektorial, ku merr një rëndësi dialogu i politikave dhe procesi i konsultimit.

Një ndër aspektet e rëndësishme të zbatimit është vlerësimi i kapaciteteve të strukturave në nivel qendror dhe rajonal për të garantuar që angazhimet e ndërmarra në këtë strategji do të realizohen. Vlerësimi i nevojës për burime njerëzore, financiare dhe rishikimet e nevojshme të strukturave zbatuese do të jetë hapi i parë për të ndërtuar strategjinë për garantimin e zbatimit në praktikë.

4.2. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit në lidhje me zbatimin e veprimeve dhe masave prioritare. Monitorimi gjurmon veprimet, ndërhyrjet, burimet financiare të alokuara dhe të shpenzuara në baza të rregullta dhe krahason ato me planin e veprimit për të vlerësuar se në çfarë mase po zbatohet Strategjia. Monitorimi i performancës nga ana tjetër, monitoron rezultatet e arritura në nivele të ndryshme: i. masat prioritare; ii. objektivat specifikë; dhe iii. synimet afatgjata të cilat përcaktohen si qëllimet e politikës (siç është shkalla e punësimit) kundrejt caqeve të caktuara. Monitorimi do të bëhet në bazë të informacionit të mbledhur rregullisht përmes sistemit të monitorimit. Megjithatë, monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve brenda masave prioritare, si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të bëhet në bazë të planit vjetor të punës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë si dhe sipas Planit Kombëtar të Veprimit.

Nga ana tjetër, monitorimi i performancës ose rezultateve do të bëhet në bazë të kornizës së monitorimit dhe vlerësimit që është përgatitur për këtë qëllim ku janë caktuar treguesit e performancës për aktivitetet, sipas objektivave specifikë dhe qëllimeve kryesore të politikës dhe është përcaktuar përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave.

Monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve, si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të realizohet nga grupi koordinues për zbatimin e Strategjisë së paku për çdo 6 (gjashtë) muaj, ndërsa monitorimi i performancës në baza vjetore. Ministria do të ketë përgjegjësinë të sistematizojë informacionin e monitorimit të gjeneruar nga institucione të ndryshme dhe të prezantojë në raportin që do t'i dorëzohet Qeverisë, por edhe do të diskutohet me aktorë më të gjerë.

Sa i përket vlerësimit të Planit do të kryhen dy ushtrime vlerësimi, i pari pas përfundimit të fazës së parë të Strategjisë (2024–2026) dhe një në përfundim të Strategjisë (2030). Grupi koordinues për zbatimin e PKVM-së do të jetë përgjegjës për koordinimin e vlerësimeve afatmesme dhe përfundimtare.

Ushtrimi i parë i monitorimit dhe vlerësimit do të analizojë zbatimin e masave prioritare, si dhe rezultatet e arritura. Duke bërë krahasimin me situatën bazë, vlerësimi i ndërmjetëm do të nxjerrë në pah ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm dhe do të gjykojë nëse objektivat, masat prioritare dhe ndërhyrjet mbeten të rëndësishme përpara fillimit të fazës së dytë të Planit për periudhën 2026–2028. Ky vlerësim do të shqyrtojë, gjithashtu, nëse ka ende një koherencë të plotë midis objektivave të planit dhe prioriteteve dhe politikave kombëtare. Vlerësimi i ndërmjetëm do të mbështetet në informacionin e nxjerrë nga sistemi i monitorimit dhe nga konteksti i përgjithshëm dhe do të ofrojë udhëzime për rishikimin e planit të veprimit por edhe për hartimin e planeve operative më të detajuara vjetore për periudhën e ardhshme, i cili do të mbulojë periudhën 2026–2028. Pjesë e monitorimit dhe vlerësimit të përvitshëm dhe atij afatmesëm dhe përfundimtar do të jetë konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Vlerësimi përfundimtar, që do të kryhet në vitet 2029 dhe 2030, do të gjykojë të gjithë ecurinë e Planit. Ky vlerësim do të raportojë mbi efektivitetin (d.m.th. shkallën në të cilën janë arritur rezultatet e pritshme), rëndësinë (d.m.th. masën në të cilën objektivat e politikës së punësimit iu përgjigjën nevojave dhe prioriteteve kombëtare), efikasitetin (d.m.th., nëse objektivat u arritën me koston më të ulët të mundshme) dhe qëndrueshmërinë (d.m.th. masën në të cilën rezultatet, përfshirë ndryshimet institucionale, janë të qëndrueshme me kalimin e kohës) e masave prioritare. Pjesë thelbësore e vlerësimit do të jetë analiza dhe vlerësimi financiar, përfshirë analizën e investimeve dhe hendeqeve financiare, vlerësimin e ndihmës së huaj si dhe evidentimin e instrumenteve financiare për të mbështetur zbatimin e plotë të Strategjisë dhe synimit për arritjen e rezultateve.

Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik, duke analizuar progresin dhe sfidat e secilës politikë prioritare. Raporti i standardizuar do të përmbajë të dhëna të sakta dhe të harmonizuara, bazuar në kornizën e indikatorëve të parashikuar nga ky plan kombëtar.

Raporti vjetor/dhe gjashtëmujor i monitorimit do të kryhet në përputhje me standardet/manualet e sistemit IPSIS në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave. Ky raport do të përdoret si një mjet për të informuar nivelin e lartë politik, donatorët dhe publikun mbi progresin e bërë në drejtim të zbatimit të reformave të ndërmarra për zbatimin e kuadrit strategjik. Raportet vjetor/dhe gjashtëmujore të monitorimit do të përdoren për të vlerësuar progresin e bërë në realizmin e qëllimeve të politikave, objektivave specifikë dhe masave të planifikuara në arritjen e reformave të planifikuara nëpërmjet vlerësimit të arritjeve të pasaportës të indikatorëve.

Në mbështetje të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit, treguesit e ndikimit do të përfshijnë rezultatet sasiore të siguruara nga studimi kombëtar mbi shëndetin dhe mirëqenien e të moshuarve, statistikat e përfshira në kornizën e indikatorëve mbi moshimin të parashikuara në këtë plan, si dhe informacionin cilësor të siguruar përmes përfshirjes së grupeve të të moshuarve.

Procesi i përgatitjes së raporteve të monitorimit për planin kombëtar të veprimit do të harmonizohet me përgatitjen e raportit kombëtar për Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), lidhur me progresin në zbatimin e Planit Ndërkombëtar të Veprimit mbi Moshimin të Madridit dhe Strategjisë Rajonale të Zbatimit (MIPAA/RIS).

PJESA V
VLERËSIMI I KOSTOVE DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIMIN E PLANIN E VEPRIMIT TË MOSHIMIT 2021–2030

Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove indikative dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të **Planit të Veprimit të Moshimit, 2025–2030**. Procesi i kostimit është realizuar në përputhje me **metodologjitë e planifikimit buxhetor**, duke u mbështetur në qëllimet, objektivat, treguesit e performancës/ndikimit të identifikuara për secilin aktivitet.

Përllogaritjet buxhetore janë kryer duke përdorur **detajimet e aktiviteteve**, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse, dhe janë harmonizuar me **Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023–2025,** për aq sa ka qenë e mundur. Ky proces është zhvilluar në konsultim me drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), bashkitë, institucionet e varësisë të përfshira në zbatimin e planit të veprimit, kostot historike të strategjive pararendëse, dhe të tjera si ajo e Strategjisë së Shëndetësisë, 2020–2030, Strategjia e promocionit, Strategjia e kujdesit parësor dhe kostot e produkteve të PBA-së (2023–2025).

Plani i veprimit shoqërohet me një kostim **analitik dhe të detajuar**, i cili përfshin një klasifikim të shpenzimeve në kategori të qarta:

- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime korrente;
- Trajnime dhe studime etj.;
- Investime.

Përllogaritjet janë realizuar sipas viteve financiare, duke paraqitur një shpërndarje të qartë të fondeve/për aktivitet/për objektiv/për qëllim.

- Kostoja totale për zbatimin e planit të veprimit për periudhën 2025–2030 është vlerësuar në 8,844,280,000 (tetë miliardë e tetëqind e dyzet e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë), total kostoje.

E cila shpërndahen si më poshtë:

- 7,578,027,000 (shtatë miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëzet e shtatë mijë), buxhet shteti;
- 278,267,000 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) donatorë;
- 987,985,000 (nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) GAP.

Tabela pasqyron në detaje kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë periudhës 2025–2030.

Planit Kombëtar i Veprimit për Moshimin, 2025–2030																		
Vizioni "Të punojmë për një shoqëri 2030, të shëndetshme dhe aktive për të gjitha moshat: promovimi i cilësisë së jetës dhe i moshimit aktiv"																		
Nr.		Institucionet përgjegjëse	Afati i zbatimit		VITET						Kostoja indikative (në 000/ ALL)	Burimi i mbulimit (në 000/ ALL)		Hendeku financiar (në 000/ ALL)	Kostoja indikative (në EURO)	Burimi i mbulimit (në EURO)		Hendeku financiar (në EURO)
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit	2025	2026	2027	2028	2029	2030		Buxheti i shtetit (000/ALL)	Financim i huaj (000/ALL)			Buxheti shtetit (EURO)	Financim i huaj (EURO)	
TOTALI					907,635	1,126,414	1,449,935	1,644,557	1,782,997	1,930,243	8,844,280	7,578,027	278,267	987,985	88,442,797	75,780,268	2,782,674	9,879,854
QËLLIMI I POLITIKËS A: Krijimi i një mjedisi mundësues, për një jetë dinjitoze për gratë dhe burrat e moshuar të moshës 60 vjeç +.					857,835	1,052,254	1,370,075	1,564,267	1,699,251	1,838,959	8,382,640	7,433,826	82,598	866,216	83,826,395	74,338,258	825,978	8,662,158
A.1	**Objektivi Specifik A.1:** Promovimi i pavarësisë financiare për burrat dhe gratë e moshës së tretë: Të krijohen mundësi që të moshuarit të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe mbështetje ekonomike përmes pensioneve dhe mundësive për punësim të mundshëm	MSHMS, MEKI, IPSH, ISSH, MF, BSH, AZHBR, MB	**2025**	**2030**	21,520	49,650	50,250	49,650	49,650	49,650	**270,370**	**270,370**	-	-	**2,703,700**	**2,703,700**	-	-
A.1.1	**Aktiviteti 1.1:** Zhvillimi i politikave për rritjen e të ardhurave për pensionistët (*).	(MEKI, ISSH)	2026	2030	-	-	-	-	-	-	**-**	**-**	-	-	**-**	**-**	-	-
A.1.2	**Aktiviteti 1.2:** Stimuj për kontribuesit e punësuar në sektorin privat në moshë pensioni pleqërie.	(MEKI, Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve shoqërore, ISSH)	2025	2030	18,000	18,000	18,000	18,000	18,000	18,000	**108,000**	**108,000**	-	-	**1,080,000**	**1,080,000**	-	-
A.1.3	**Aktiviteti 1.3:** Përmirësimi i aksesit në shërbime bankare dhe financiare.	MSHMS + MF + Banka e Shqipërisë	2026	2030	-	-	-	-	-	-	**-**	**-**	-	-	**-**	**-**	-	-
A.1.4	**Aktiviteti 1.6** Krijimi i mundësive të punësimit në sektorët e gjelbër.	Ministria e Bujqësisë, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	2027	2027	-	-	600	-	-	-	**600**	**600**	-	-	**6,000**	**6,000**	-	-
A.1.5	**Aktiviteti 1.7** Nxitja e krijimit të ndërmarrjeve sociale si një instrument për punësim dhe vetëpunësim të të moshuarve.	(MSHMS)	2026	2030	3,520	31,650	31,650	31,650	31,650	31,650	**161,770**	**161,770**	-	-	**1,617,700**	**1,617,700**	-	-
A.2	**Objektivi Specifik A 2: Përmirësimi i aksesit në Shërbime Sociale e Shëndetësore të përshtatshme, cilësore dhe të integruara për të moshuarit, sa më pranë individit**	MSHMS, SHSSH, ISKSH, OSHKSH, SHSSH, ASCK, QSUT, FDSKSH	2025	2030	807,778	972,238	1,285,446	1,478,023	1,612,571	1,749,600	**7,905,656**	**7,114,038**	-	**791,618**	**79,056,556.61**	**71,140,376.61**	-	**7,916,180**
A.2.1	***Aktiviteti 2.1*** Mirëqeverisja dhe mbështetja për kujdes afatgjatë përgjatë gjithë ciklit të jetës nëpërmjet zhvillimit të mekanizmave të dhënies (**)	(MSHMS – SHSSH – Bashkitë)	2025	2030	17,750	129,500.00	241,250.00	346,400.00	451,550.00	556,700.00	**1,743,150**	**1,743,150**	-	-	**17,431,500**	**17,431,500**	-	-
A.2.2	***Aktiviteti 2.2.*** Shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore për moshën e tretë. Hartimi i protokolleve të sëmundjeve të shëndetit mendor, diabetit, parkinsonit, alzhaimer etj. Kujdesi për shëndetin oral dhe atë të syve.	(MSHMS, FDSKSH, Operatori i kujdesit Shëndetësor)	2025	2030	60,070	113,850.00	303,712.50	359,012.50	359,012.50	359,012.50	**1,554,670**	**1,000,920**	-	**553,750**	**15,546,700**	**10,009,200**	-	**5,537,500**
A.2.3	**Aktiviteti 2.3** Ngritja e Shërbimeve cilësore sociale shëndetësore të lëvizshme dhe në shtëpi për të moshuarit dhe ngritja e kapaciteteve të figurave profesionale. Digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore dhe shoqërore	(MSHMS + Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor + Shërbimi Social Shoqëror + Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Kujdesit Shëndetësore dhe Shoqërore)	2025	2030	335,758	317,687.50	330,283.10	357,410.51	386,808.62	418,687.64	**2,146,636**	**2,010,768**	-	**135,868**	**21,466,357**	**20,107,677**	-	**1,358,680**
A.2.4	**Aktiviteti 2.4** Të rrisim kapacitetet gjeriatrike dhe gerontologjike te profesionistët shëndetësorë dhe social (***)	MSHMS, QSUT, FDSKSH	2025	2030	394,200	411,200.00	410,200.00	415,200.00	415,200.00	415,200.00	**2,461,200**	**2,359,200**	-	**102,000**	**24,612,000**	**23,592,000**	-	**1,020,000**
A.3	**Objektivi Specifik A 3: Përfshirja e moshimit në të gjithë sektorët dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha niveleve të qeverisjes**	**INSTAT + MF + Partnerë ndërkombëtarë**	**2025**	**2030**	28,536	30,366	34,379	36,594	37,029	39,709	**206,614**	**49,418**	**82,598**	**74,598**	**2,066,138**	**494,182**	**825,978**	**745,978**
A.3.1	**A.3.1 Ngritja e strukturave koordinuese dhe këshilluese në nivele të larta** të qeverisjes qendrore dhe vendore për ndjekjen e politikave të përfshirjes së moshimit		2025	2030	10,236	10,236	10,236	10,236	10,236	10,236	**61,418**	**49,418**	**12,000**	-	**614,182**	**494,182**	**120,000**	-
A.3.2	**Aktiviteti 3.2** Qasja drejt zhvillimit të llogarive kombëtare të transfertave.	INSTAT + MF + Partnerë ndërkombëtarë	2027	2028	-	-	2,000	2,000	-	-	**4,000**	-	-	**4,000**	**40,000**	-	-	**40,000**
A.3.3	**Aktiviteti 3.3** Qytetet dhe Komunitetet Miqësore të Moshave (***)		2025	2030	18,300	20,130	22,143	24,357	26,793	29,472	**141,196**	-	**70,598**	**70,598**	**1,411,957**	-	**705,978**	**705,978**
Qëllimi i Politikës B: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për një moshim dinjitoz dhe masat për parandalimin e vetmisë dhe moshimin e shëndetshëm					**49,800**	**74,160**	**79,860**	**80,290**	**83,746**	**91,284**	**461,640**	**144,201**	**195,670**	**121,770**	**4,616,402**	**1,442,010**	**1,956,696**	**1,217,696**

B.1	**Objektivi specifik B1: Fushata ndërgjegjësimi dhe Edukimi i publikut - Fushata mediatike**	**MSHMS + SHSSH + BASHKITË + AMA + Network i influencuesve**	**2025**	**2030**	49,800	52,250	54,650	57,080	60,536	64,683	**338,999**	**115,800**	**159,450**	**63,750**	**3,389,992**	**1,158,000**	**1,594,496**	**637,496**
B.1.1	**Aktiviteti B 1.1. Përgatitja e posterave dhe broshurave. Fushata ndërgjegjësimi**	MSHMS + SHSSH + BASHKITË + AMA	2025	2030	2,973	3,423	3,423	2,973	2,973	2,973	**18,736**	**4,636**	**-**	**14,100**	**187,364**	**46,364**	**-**	**141,000**
B.1.2	**Aktiviteti B.1.2:** Fushata sociale dhe angazhimi i influencuesve	MSHMS + SHSSH + Bashkitë + Network i influencuesve	2025	2030	10,000	12,000	14,400	17,280	20,736	24,883	**99,299**	**-**	**49,650**	**49,650**	**992,992**	**-**	**496,496**	**496,496**
B.1.3	**Aktiviteti B 1.3** Forumet publike dhe ngjarjet për ndërgjegjësimin e moshimit	MSHMS, BASHKI	2025	2030	36,827	36,827	36,827	36,827	36,827	36,827	**220,964**	**111,164**	**109,800**	**-**	**2,209,636**	**1,111,636**	**1,098,000**	**-**
B.2	**Objektivi specifik B.2 Ndërveprimi ndërmjet brezave – Programe edukative trajnimi për të rinjtë dhe komunitetin dhe krijimi i mundësive për aktivizim dhe pjesëmarrje**	MSHMS, MAS, OJF, BASHKI	**2026**	**2030**		21,910	25,210	23,210	23,210	26,601	**122,641**	**28,401**	**36,220**	**58,020**	**1,226,410**	**284,010**	**362,200**	**580,200**
B.2.1	***Aktiviteti B.2.1 Krijimi i*** Institucionit të Arsimit të lartë profesional për Moshën e tretë	(MSHMS + MAS + MEKI	2026	2030	-	14,000	16,700	16,100	16,100	16,100	**79,000**	**11,600**	**33,400**	**34,000**	**790,000**	**116,000**	**334,000**	**340,000**
B.2.2	***Aktiviteti B.2.2. Inicimi i një projekti pilot ku "të moshuarit të birësojnë një shkollë"***	**(MSHMS + MAS+ OJF) + Bashki**	2026	2030	-	2,000	2,600	1,200	1,200	1,200	**8,200**	**2,000**	**-**	**6,200**	**82,000**	**20,000**	**-**	**62,000**
B.2.3	**Aktiviteti B.2.3 Nxitja e rolit të familjarëve në kujdesin për të moshuarit**		2026	2030	-	3,410	3,410	3,410	3,410	6,801	**20,441**	**14,801**	**2,820**	**2,820**	**204,410**	**148,010**	**28,200**	**28,200**
B.2.4	**Aktiviteti B.2.4 Promovimi i Shëndetit dhe Aktiviteti Fizik për të moshuarit**		2025	2030	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	**15,000**	**-**	**-**	**15,000**	**150,000**	**-**	**-**	**150,000**

Kufizimet dhe nevoja për rivlerësim

Në përllogaritjen e kostove janë identifikuar disa kufizime që kërkojnë rishikim të mëtejshëm, pas përfundimit të legjislacionit përkatës dhe vlerësimit të saktë të efekteve ekonomike. Këto kufizime lidhen me aktivitetet kryesore të planit, si më poshtë:

(Aktiviteti 1.1) Zhvillimi i politikave për rritjen e të ardhurave për pensionistët

- Përllogaritja aktuale është bërë mbi bazën e skemave ekzistuese të pensioneve, duke marrë në konsideratë pensionin mestar sipas të dhënave të ISSH-së, me numrin e përfituesve.

- Megjithatë, ndryshimet ligjore të pritshme për rritjen e pensioneve në skemën e pensioneve mund të ndikojnë ndjeshëm në koston përfundimtare.

- Efektet ekonomike të këtyre ndryshimeve do të jenë të qarta vetëm pas miratimit të legjislacionit të ri dhe aplikimit të tij.

(Aktiviteti 1.2) Mirëqeverisja dhe mbështetja për kujdesin afatgjatë për të moshuarit (70+)

- Kostoja është bazuar në PBA 2025–2027, e cila përllogarit një mesatare për individët mbi 70 vjeç, duke u bazuar në koston për njësi të *Check up*.

- Miratimi i ndryshimeve ligjore është një faktor kyç që do të ndikojë në përllogaritjen përfundimtare të buxhetit.

(Aktiviteti 2.4) Rritja e kapaciteteve geriatrike dhe gerontologjike për profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe social

- Ky aktivitet nuk është realizuar në strategjinë e mëparshme dhe është shtyrë, për shkak të mungesës së protokolleve të qarta spitalore.

- Kostoja aktuale është vlerësuar mbi bazën e praktikave bazuar kryesisht te shërbimi psikiatrik, por duhet riparë sapo të finalizohen standardet kombëtare për trajnimet geriatrike dhe gerontologjike.

(Aktiviteti 3.3) Qytetet dhe komunitetet miqësore për të moshuarit

- Një nga sfidat kryesore është identifikimi i burimeve të financimit nga bashkitë, për të cilat është e vështirë mbledhja e informacionit.

- Financimi do të vlerësohet gjatë fazës së monitorimit, duke u mbështetur në strategjitë dhe planet sociale të secilës bashki.

Konkluzionet dhe hapat e mëtejshëm

Bazuar në analizën e mësipërme, rishikimi i kostove dhe burimeve të financimit mbetet një proces dinamik që do të varet nga disa faktorë kyç:

- Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe ndikimi i tyre ekonomik;

- Përshtatja e protokolleve shëndetësore për shërbimet geriatrike dhe gerontologjike;

- Angazhimi i bashkive për financimin e projekteve komunitare për të moshuarit;

- Identifikimi i burimeve të reja financiare nga donatorët ndërkombëtarë.

Një rishikim i detajuar i kostove do të kryhet pasi të finalizohen ndryshimet e legjislacionit dhe të përcaktohen qartë efektet ekonomike të politikave të reja.

VENDIM
Nr. 27, datë 29.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 29.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 28 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: EDMOND MAMUSHI

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokuror Arqile Koca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 22/22-2018-127, datë 17.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2024-1285, datë 11.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 31, 31/a, 71

dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Edmond Mamushi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për kryerjen e veprave penale "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", të parashikuara nga nenet 78, paragrafi i dytë dhe 22, si dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimin nr. 22/22-2018-127, datë 17.4.2018, ndër të tjera, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të kërkuesit, nga "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i dytë dhe 22 të KP-së, në "Vrasja me paramendim", të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi i parë dhe 22 të KP-së, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e kësaj vepre, si dhe duke e dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Po kështu, ajo gjykatë ka vendosur edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës tjetër penale në ngarkim të kërkuesit, nga "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, i KP-së, në veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, duke e deklaruar atë fajtor për këtë vepër, duke e dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Në aplikim të neneve 55 dhe 56 të KP-së, në bashkim të dënimeve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 22/22-2018-127, datë 17.4.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Ndaj këtij vendimi, më datë 18.11.2018, ka paraqitur rekurs kërkuesi. Gjithashtu, rezulton se në datat 6.3.2023 dhe 5.7.2024 kërkuesi ka paraqitur edhe dy akte të tjera në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet të cilave ka parashtruar pretendimet e tij për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1285, datë 11.7.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe provave të marra e të administruara në këtë gjykim dhe se pretendimet e kërkuesit për moskryerjen e ekspertimit teknik të armës, eksperimentit hetimor për këtë armë dhe fishekëve të saj nuk e cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të cilat, bazuar në nenin 152 të KPP-së, i kanë çmuar provat në tërësi në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën nga ato. Po sipas Kolegjit Penal, nuk konstatohet që gjykatat e faktit nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

5. Më datë 30.10.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

6.1 *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në ankim nga kërkuesi, të cilat lidheshin me cenimin e

parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, rezulton se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim, nuk ka arsyetuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, si dhe aktet e tjera të paraqitura nga ai, që kishin të bënin me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prezumimit të pafajësisë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në aktet e tjera të paraqitura nga kërkuesi, por as nuk i ka pasqyruar ato në pjesën e vendimit ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, konkretisht me vendimin nr. 19, datë 7.7.2022.

6.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, në vlerësimin e tyre, u janë referuar vetëm dëshmive dhe provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe në asnjë moment nuk u janë referuar dëshmitarëve ose provave të paraqitura nga kërkuesi. Dëshmitë e marra në shqyrtim nga gjykatat nuk janë të mjaftueshme për të formuar bindjen e tyre për fajësinë e kërkuesit dhe ato nuk kanë administruar asnjë provë për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Mënyra sesi kanë vepruar ato gjykata, vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës së mbrojtjes.

7. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

7.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi bazuar në nenin 415, pika 2, të KPP-së, ai që ka bërë ankim ka të drejtë të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në ankim, ndërkohë, në rastin konkret, kërkuesi nuk ka paraqitur parashtrime, por ka paraqitur shtesë rekursi. Gjithashtu, parashtrimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs kanë të bëjnë me çështje provash dhe nuk paraqitet asnjë argument, fakt ose provë e re që është kërkuar apo pretenduar nga kërkuesi, e cila nuk është shqyrtuar ose analizuar nga gjykatat më të ulëta.

7.2 I pabazuar është edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi referuar vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë është pasqyruar marrja e dëshmive të një sërë dëshmitarësh, dëshmitë e të cilëve ishin në harmoni më ngjarjen e pasqyruar. Gjithashtu, është shqyrtuar pretendimi i kërkuesit se ishte i pafajshëm dhe se ai nuk kishte kryer veprën penale, duke analizuar harmonizimin e të gjitha provave. Madje gjykata e shkallës së parë, në përfundim, ka bërë një rikualifikim të veprës penale në ngarkim të kërkuesit në favor të tij. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, duke marrë kjo e fundit në analizë të gjitha provat e gjykimit, të cilat, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, vërtetonin tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprën penale.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1,

shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.7.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datë 30.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen me cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si elemente të procesit të rregullt ligjor.

13. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuesi ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, në vlerësimin e tyre, u janë referuar vetëm dëshmive dhe provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe në asnjë moment nuk u janë referuar dëshmitarëve ose provave të paraqitura nga ai. Sipas kërkuesit, dëshmitë e marra në shqyrtim nga ato gjykata nuk janë të mjaftueshme për të formuar bindjen e tyre për fajësinë e tij dhe ato nuk kanë administruar asnjë provë për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se nuk rezulton që nga gjykatat të jetë hetuar se kujt i përkiste arma, e cila është përdorur në krim.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në procesin penal mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykimin penal, i garantuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim prezupozon që secilës palë duhet t'u ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimet nr. 13, datë 24.4.2018; nr. 16, datë 27.3.2012; nr. 5, datë 17.2.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar se cilave provave ose dëshmitarëve nuk u janë referuar gjykatat, të cilat ishin në favor të tij. Gjithashtu, bazuar në arsyetimin e gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të apelit, Gjykata konstaton se nuk rezulton që kërkuesi të jetë vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës. Atij i është dhënë mundësia që gjatë procesit të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij, provat mbi të cilat janë ngritur këto akuza, të debatojë për to, si dhe të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* është haptazi i pabazuar.

16. Për sa i përket pretendimit tjetër të parashtruar në ankimin kushtetues individual për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, Gjykata vëren se argumentet e kërkuesit kanë të bëjnë me qëndrimin që kanë mbajtur Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Lartë për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, të parashtruara përpara atyre gjykatave, të cilat kanë të bëjnë me parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuesi i ka ngritur këto pretendime edhe në këndvështrim të

vendimmarrjes së gjykatës së apelit, duke pasur parasysh jo vetëm natyrën e tyre, por edhe pozicionin e Gjykatës së Lartë në drejtim të verifikimit të respektimit dhe të standardeve kushtetuese, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, si dhe referuar akteve të paraqitura nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë (rekurs dhe aktet e tjera), ku në thelb ai ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata çmon të shqyrtojë në vijim, në themel, nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit dhe nëse, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit, i ka dhënë përgjigje përfundimtare të arsyetuar pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë

17. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim, nuk i ka dhënë përgjigje dhe nuk ka arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura prej tij. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në aktet e tjera të paraqitura nga ai, por as nuk i ka pasqyruar ato në pjesën e vendimit ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, konkretisht me vendimin nr. 19, datë 7.7.2022.

18. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar, duke argumentuar se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi, bazuar në nenin 415, pika 2, të KPP-së, ai që ka bërë ankim ka të drejtë të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në ankim, ndërkohë, në rastin konkret, kërkuesi nuk ka paraqitur parashtrime, por ka paraqitur shtesë rekursi. Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Përgjithshme, parashtrimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs kanë të bëjnë me çështje provash dhe nuk paraqitet asnjë argument, fakt ose provë e re që është kërkuar ose pretenduar nga kërkuesi dhe nuk është shqyrtuar ose analizuar nga gjykatat më të ulëta.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 11, datë 21.4.2022; nr.17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 47, datë 11.6.2024; nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në rastet kur pretendimet me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atyre nuk u jepet përgjigje, arsyetimi i vendimit të asaj gjykate nuk ka përmbushur një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 28, datë 11.4.2024; nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Po kështu, Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Kështu, parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 4 të këtij kodi, sipas të cilit i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në kuptim të sa më sipër, në këndvështrim të këtyre standardeve kushtetuese, Gjykata do të verifikojë, në vijim nëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar në vendimin e saj pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura përpara asaj gjykate, të cilat kanë të bëjnë me parimin

e prezumimit të pafajësisë dhe, më tej, do të vlerësojë nëse ajo gjykatë, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit, i ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe nëse u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare të arsyetuar.

22. Në rastin konkret, në vendimet e tyre gjykatat e faktit pranojnë se kërkuesi ka përdorur në vendin e ngjarjes një armë zjarri, me qëllim për të vrarë shtetasin J.H., por arma nuk ka realizuar qitje. Sipas tyre, arma e krimit nuk është gjetur as në vendin e ngjarjes dhe as i është sekuestruar kërkuesit. Nga ana tjetër, pranohet se arma e krimit është dorëzuar në ambientet e Komisariatit të Policisë Përmet, bashkë me disa fishekë, pas ndodhjes së ngjarjes, nga viktima e veprës penale J.H. dhe shtetasi E.Ç., i cili ka qenë në shoqërinë e të parit në vendin e ngjarjes. Te kjo armë nuk janë gjetur gjurmë papilare të kërkuesit. Arma dhe fishekët e dorëzuar në këto rrethana i janë nënshtruar ekspertimit teknik nga Instituti i Policisë Shkencore Tiranë duke u përpiluar akti nr. 12080, datë 7.11.2016, i cili, në vijim, është përdorur si prova e vetme shkencore për fajësinë e kërkuesit. Po ashtu, për veprimin e lëvizjes nga vendi i ngjarjes të armës së krimit, prokuroria ka ushtruar ndjekjen penale të shtetasit E.Ç. për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i KP-së, por që më pas hetimet për këtë shtetas janë pushuar me argumentin se veprimi i tij nuk ka pasur për qëllim të ndihmojë të pandehurin/kërkuesin për t'iu shmangur përgjegjësisë penale ose për të penguar zbulimin e së vërtetës, por për shkak se ka pasur frikë se arma mund të përdorej nga persona të tjerë kundër të pandehurit. Ndërkohë, kërkuesi gjatë gjithë procesit penal ka mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohej dhe, në veçanti, faktin e mbajtjes dhe përdorimit të armës të dorëzuar nga viktima e veprës penale J.H. dhe shtetasi E.Ç.

23. Referuar këtyre fakteve si dhe akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, i cili, në vijim, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe dy akte të tjera, në të cilat ka parashtruar pretendimet e tij ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Ato janë depozituar në Gjykatën e Lartë në datat 6.3.2023 dhe 5.7.2024. Referuar përmbajtjes së rekursit, rezulton se kërkuesi ka parashtruar si shkaqe se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, në shkelje të neneve 42 e vijues të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke dënuar një person të pafajshëm, si dhe duke e prezumuar atë të fajshëm, në një kohë që pafajësia e tij është provuar në të dyja shkallët e gjykimit. Po në mbështetje të parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuesi ka argumentuar në rekurs se gjykimi ndaj tij ka nxjerrë në pah faktin se organi i akuzës dhe gjykatat e kanë deformuar këtë parim dhe kanë deformuar edhe përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e organit prokurorisë për të provuar fajësinë e tij. Sipas kërkuesit, ky parim është cenuar prej gjykatave për shkak se arma me të cilën pretendohet se është kryer vepra penale nuk ka qenë e tij, por e viktimës. Gjykata konstaton se në aktin e datës 5.7.2024 drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkuesi, ndër të tjera, ka ngritur pretendime për mënyrën e marrjes së provave, duke argumentuar se prokuroria ka sekuestruar një armë tip pistoletë me tre fishekë, të dorëzuar nga shtetasi J.H., viktima e veprës penale dhe shtetasi E.Ç. dhe fishekët kanë dalë nga xhepi i këtyre të fundit. Këto shkaqe në thelbin e tyre lidhen gjithashtu me parimin e prezumimit të pafajësisë.

24. Referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse të tij, ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit, ai kolegj ka pasqyruar si pretendimet e parashtruara në rekurs, ashtu edhe ato të parashtruara në aktin e datës 6.3.2023. Ndërkohë, nuk rezulton që të jenë pasqyruar në vendim pretendimet e kërkuesit të paraqitura në aktin e datës 5.7.2024. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton, fillimisht, se pretendimet e kërkuesit të paraqitura në Gjykatën e Lartë me aktin e datës 5.7.2024 nuk rezulton të jenë pretendime të reja, por janë argumente në mbështetje të pretendimeve të ngritura më parë prej tij në rekurs, në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se mospasqyrimi i tyre në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk përbën shkelje të natyrës kushtetuese[1].

[1] Gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci, bazuar edhe në jurisprudencën kushtetuese sipas së cilës mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara në shtesën e rekursit përbën cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), mbajtën qëndrimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të pasqyronte në pjesën hyrëse të vendimit të tij edhe pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në aktet e paraqitura përpara Gjykatës së Lartë më datë 5.7.2024 për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

25. Për sa i përket përmbajtjes dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe në aktet e tjera të paraqitura përpara Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në drejtim të provueshmërisë së fajësisë të tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm, për sa i përket mbajtjes dhe përdorimit nga ai të armës e cila, sipas kërkuesit, i përkiste viktimës së veprës penale dhe është dorëzuar prej këtij të fundit *(shih paragrafin 23 më sipër)*. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuesi, për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë ka vlerësuar se nuk konstatohet që gjykatat e faktit të mos e kenë respektuar atë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt dhe nuk evidentohet zbatimi i gabuar i ligjit penal material i lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale dhe caktimin e dënimit ndaj të gjykuarit (neni 47 i KP-së), si dhe i ligjit procedural penal për çmuarjen dhe vlerësimin e provave, sipas nenit 152 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe provave të marra e të administruara në këtë gjykim dhe pretendimet e kërkuesit për moskryerjen e ekspertimit teknik të armës dhe eksperimentit hetimor për këtë armë dhe fishekëve të saj nuk e cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të cilat i kanë çmuar provat në tërësi, në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën prej tyre (*shih paragrafët 23–25 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

26. Duke iu referuar natyrës së këtij pretendimi, në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, të cilat janë të zbatueshme edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e asaj gjykate për kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor dhe parimin e subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhej të ishte ndalur në vlerësimin e këtij pretendimi, duke mbajtur një qëndrim të shprehur për të dhe duke dhënë arsyetim për bazueshmërinë e tij. Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë duhej t'i kishte dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për zbatimin e gabuar të ligjit procedural sa i takon çmuarjes së provave nga ana e gjykatave të faktit në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin nga ai në vendin e ngjarjes të armës të dorëzuar, në një distancë kohore pas ngjarjes, nga viktima e veprës penale dhe personi që shoqërohej me të, në raport me përfundimin e arritur nga ato për të provuarin tej çdo dyshimi të arsyeshëm të kryerjes nga ai të veprave penale për të cilat është gjetur fajtor.

27. Duke mbajtur një qasje formale në drejtim të vlerësimit të shkaqeve të rekursit në tërësinë e tyre, pa u ndalur në aspekte të veçanta të procesit gjyqësor që mbartin natyrë kushtetuese, për shkak të natyrës së pretendimeve, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe arsyetimi i kufizuar i atij kolegji, në këtë rast konkret, nuk përmbush detyrimin kushtetues për arsyetimin e vendimit gjyqësor, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor. Edhe pse pretendimi i ngritur nga kërkuesi, për sa i përket armës me të cilën është kryer vepra penale, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të të provuarit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ky pretendim nuk ka marrë përgjigje përfundimtare të arsyetuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është haptazi i paarsyeshëm dhe i pamjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues.

28. Nën këtë optikë, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesit për pretendimin e tij për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, ka vënë në dyshim respektimin e së drejtës së tij për të marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e ngritura përpara asaj gjykate, në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, janë të bazuara.

29. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1285, datë 11.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 29.4.2025.
Shpallur, më 28.5.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja
Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Edmond Mamushi, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 22/22-2018-127, datë 17.4.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 20-2018-830/104, datë 17.10.2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2024-1285, datë 11.7.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar në tërësinë e saj. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë, në vijim, argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se kërkuesi është dënuar me 15 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet për veprat penale të vrasjes me paramendim në tentativë dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake. Ndonëse, ai ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

4. Shumica i ka vlerësuar pretendimet e kërkuesit në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafin 16 të vendimit*). Ajo ka arritur në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formale në drejtim të vlerësimit të shkaqeve të rekursit në tërësinë e tyre, pa u ndalur në aspekte të veçanta të procesit gjyqësor që mbartin natyrë kushtetuese për shkak të natyrës së pretendimeve, duke dhënë një arsyetim të kufizuar për rastin, i cili bie ndesh me standardin kushtetues. Sipas shumicës, edhe pse pretendimi i ngritur nga kërkuesi që lidhej me armën luftarake, me të cilën është kryer vepra penale, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të të provuarit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ky pretendim nuk ka marrë përgjigje përfundimtare të arsyetuar, ndaj arsyetimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i paarsyeshëm dhe i pamjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

5. Nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardin kushtetues të arsyetimit, duke i treguar kërkuesit që është dëgjuar, duke i dhënë mundësinë atij ta kundërshtojë atë (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e ka cenuar procesin e rregullt ligjor, pasi ai është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 14, datë 21.6.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Çështja themelore që na ndan me shumicën lidhet me faktin nëse arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë konsiderohet përgjigje për pretendimin e kërkuesit lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë. Ashtu siç ka pohuar shumica, parimi i

prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes dhe se, sipas këtij parimi, asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur në konsideratë se garancitë kushtetuese të parimit të prezumimit të pafajësisë konkretizohen në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit procedues për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), theksojmë se parimi i prezumimit të pafajësisë në thelb është garanci procedurale në procesin penal, që lidhet, ndër të tjera, me barrën e provës, prezumimet ligjore dhe të faktit, të drejtën e individit për të mos dëshmuar kundër vetes, si dhe shprehjet paragjykuese nga gjykata ose zyrtarë të tjerë publikë rreth fajësisë së tij.

7. Nën këtë optikë, ne, gjyqtarët në pakicë, *së pari,* evidentojmë se gjykatat e faktit kanë përcaktuar faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në vendimmarrjen e tyre. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, se për fajësinë e tij nuk ekzistonte asnjë provë, gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin e fajësisë, duke shqyrtuar dhe vlerësuar një sërë provash, siç janë pyetja e rreth tetë dëshmitarëve, një pjesë e të cilëve kanë qenë të pranishëm në vendngjarje, akti i ekspertimit, rezultatet e përgjimit të kërkuesit me një shtetas të tretë. Lidhur me sekuestrimin e armës luftarake të dorëzuar nga viktima në organet e policisë dhe jo në vendngjarje, gjykatat kanë arsyetuar se ky fakt provohet jo vetëm nga dëshmitë e viktimës dhe të të pranishmëve në vendngjarje, por edhe nga procesverbali i Policisë Gjyqësore, sikundër kanë vënë në dukje se alibia e ngritur nga kërkuesi nuk mbështetej në prova, duke dhënë arsyet përse. Këto prova janë analizuar prej gjykatave, duke treguar përmbajtjen e tyre, pa i dhënë ndonjë prove fuqi provuese të paracaktuar dhe në harmoni me njëra-tjetrën, duke respektuar në këtë mënyrë rregullat për barrën e provës dhe prezumimet e faktit, për rrjedhojë edhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Në këtë mënyrë, vlerësimi i shumicës se arma nuk është sekuestruar në vendngjarje, por është dorëzuar nga viktima dhe shtetas të tjerë, në thelb nuk është gjë tjetër veçse vlerësim i fuqisë provuese të provave, që nuk i nënshtrohet juridiksionit kushtetues.

8. Së dyti, evidentojmë se Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme se vendimmarrja e gjykatave të faktit nuk është e cenueshme, për sa kohë që rekursi i paraqitur nga i gjykuari nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432, pika 1, i KPP-së dhe se gjykatat e shkallëve më të ulëta, në unison kanë disponuar për fajësinë e tij, ku gjykata e apelit ka bërë një analizë të hollësishme të dinamikës së fakteve dhe të provave të marra e të administruara në këtë gjykim. Po kështu, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, duke arsyetuar shprehimisht se gjykatat e faktit i kanë çmuar provat në tërësi, në përputhje me njëra-tjetrën, duke mos mbivlerësuar asnjërën prej tyre, ndaj nuk konstatohet që ato gjykata të mos kenë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë ose që ndaj kërkuesit të jetë zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar, ndërsa Gjykata e Lartë ka ushtruar plotësisht dhe në mënyrë korrekte funksionin e saj si gjykatë e ligjit, sikundër edhe funksionin për kontrollin edhe të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, bazuar në rolin e saj subsidiar.

9. Nga ana tjetër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen në themel të çështjes së kërkuesit, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon në drejtim të së drejtës së aksesit nëse gjykatat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të parashtruara përpara tyre dhe nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, gjë që, në rastin konkret, rezulton të jetë përmbushur si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Në këtë drejtim, ritheksojmë se vlerësimi kushtetues i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë prerogativat/rolin/funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e kthyer atë në një shkallë të katër gjykimi.

10. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së

drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të prezumimit të pafajësisë, është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 124, datë 30.5.2025

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Blendi Gonxhja kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 30.5.2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", morri në shqyrtim njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të planit të ndihmës shtetërore për projektin "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë".

I. Procedura

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 5312, datë 20.6.2024, "Mbi dhënien e autorizimit të ndihmës shtetërore projektit hidroenergjitik të Devollit", në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore"; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 8194/1, datë 20.9.2024, kërkoi të dhëna të detajuara mbi njoftimin e sipërcituar; MIE me shkresën nr. 5312/2, datë 6.1.2025 paraqiti të dhënat shtesë referuar projektit Hidroenergjetik të Devollit.

II. Përshkrimi i masës

II.I Kuadri strategjik në sektorin e hidroenergjisë për prodhimin e energjisë elektrike

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018, *"Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030" (Strategjia)*, është përcaktuar që ky dokument vjen si rrjedhojë e reformave të guximshme dhe të vështira që ndërmori qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, një reformë të thellë, produktet e së cilës tanimë janë të dukshme. Si një nga pikat kryesore të këtyre treguesve është theksuar ndërtimi i rreth 400 mw kapacitete të reja gjeneruese të energjisë elektrike në fushën e HEC-eve të vogla dhe kaskadës shumë të rëndësishme të Devollit me HEC-in e Banjës, tashmë të vendosur në operim që prej më shumë se një viti dhe HEC-in e Moglicës që është në fazën finale të ndërtimit.

3. Sipas Strategjisë përcaktohet se historikisht, gjenerimi i energjisë elektrike është përmbushur pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet, me një kapacitet total të instaluar prej 2,011 mw në fund të vitit 2016. Vendi ka shfrytëzuar afro 50% të potencialit të vet hidroenergjetik dhe zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është i mundur kryesisht përgjatë lumenjve Drin, Mat, Devoll dhe Bistricë.

4. Kapacitetet hidrike janë burimet natyrore të rinovueshme më të rëndësishme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë. Shqipëria importon energji elektrike nga vendet fqinje, megjithëse importet kanë rënë në mënyrë progresive në dhjetë vjetët e fundit pas rritjes së prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike dhe zvogëlimit të humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike) në sistemin e shpërndarjes, të cilat janë zvogëluar nga 45.04% më 2013-n në 25.04% deri në fund të vitit 2016 me një plan të qartë investimesh dhe menaxhimi për t'i ulur ato më tej në 17% deri në fund të 2020-s.

5. Parimet që udhëheqin zhvillimin e kësaj strategjie të energjisë janë në përputhje me objektivat e SKZHI-II, në mënyrë specifike, për:

- rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, ndërsa sigurohet rritje në mirëqenie;
- zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë, diversifikimi i burimeve të furnizimit dhe ndërlidhja me rrjetet evropiane të energjisë elektrike dhe gazit

natyror në përputhje me *acquis* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

- krijimi i një tregu konkurrues që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;

- ofrimin e incentivave për zbatimin e politikave të nevojshme të ndryshimeve klimatike, të tilla si arritjen e objektivave të BRE-së dhe të eficiencës së energjisë dhe për uljen e shkarkimeve të CO_2 dhe zbatimin e objektivave të KKE (NDC), në kuadër të UNFCCC-së.

6. Objektivat strategjikë afatgjatë, në vijim, janë identifikuar për të realizuar parimet udhëzuese dhe angazhimet aktuale që janë ndërmarrë nga qeveria shqiptare:

- përmirësimi i besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji;

- zhvillimi i burimeve të brendshme të energjisë primare në një mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;

- përmirësimi i efektivitetit të kostove të sistemeve të furnizimit me energji;

- arritja e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë të përcaktuara në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe për Burimet e Rinovueshme të Energjisë;

- zhvillimi i politikave dhe strategjive me kosto efektive për rritjen e performancës së energjisë në ndërtesat publike dhe ato rezidenciale;

- integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe të gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane; dhe

- arritjen e objektivave të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serë (GHG).

II.II Plani i investimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit

7. Kontrata e koncesionit "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në Lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë", është miratuar me ligjin nr. 10083, datë 23.2.2009. Kontrata e Koncesionit është ndryshuar në vijim me shtesën I të miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21.10.2010, shtesa II të miratuar me ligjin nr. 105/2013, shtesën III të miratuar me ligjin nr. 7/2015 dhe shtesën IV të miratuar me ligjin nr. 83/2023.

8. Projekti i hidrocentraleve në lumin Devoll vlerësohet si një investim strategjik. Projekti Hidroenergjetik i Devollit konsiston në projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe operimin e dy hidrocentraleve, HEC Banja dhe HEC Moglicë, me një kapacitet të instaluar prej rreth 269 mw dhe prodhim të rreth 700 gwh/vit. Vendimi për investimin e një hidrocentrali të tretë, HEC Kokël, do të shqyrtohet pas përfundimit të dy hidrocentraleve të parë. Ky projekt vlerësohet të sjellë rritje me 20% të prodhimit të energjisë elektrike, duke ndikuar në përmirësimin e bilancit valutor dhe tregtar të vendit. Projekti siguron furnizim më të mirë dhe me kosto të përshtatshme të energjisë për popullsinë, rritje të punësimit, përmirësim të sistemit rrugor etj.

9. Projekti filloi aktivitetet e para në terren në kuadër të fazës parandërtimore në vitin 2009, pas miratimit nga Parlamenti Shqiptar të Kontratës së Koncesionit. Në vitin 2013 filloi ndërtimi i HEC Banja, i cili përfundoi dhe hyri në operim në vitin 2016. Ndërtimi i HEC Moglicë filloi në vitin 2015 dhe operimi i hidrocentralit filloi në vitin 2020. Kostoja e investimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit është vlerësuar rreth 590 milionë euro. Ky investim ka sjellë impakt pozitiv në ekonominë e vendit dhe atë rajonale. Nga zbatimi i kësaj kontrate, për banorët e zonës janë aplikuar programe sociale strehimi dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme. Numri i të punësuarve, në fazën e zbatimit të projektit, ka qenë rreth 2000 punëtorë, ku shumica prej tyre kanë qenë të punësuar nga kontraktorët e Devoll Hydropower sh.a. (DHP). Gjithashtu, në zbatim të Shtesës së Tretë të Kontratës së Koncesionit, koncesionari mori përsipër të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastrukturën Zëvendësuese kundrejt një kompensimi të drejtë dhe të kënaqshëm për shpenzimet shtesë të saj. Infrastruktura zëvendësuese përfshinte ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banja – Gramsh, Ura e Trashovicës, rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglicë M03, të cilat janë përfunduar nga koncesionari dhe i janë dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, në cilësinë e entit shtetëror dhe në përputhje me marrëveshjen mes palëve.

10. Qëllimi i njoftimit të planit të ndihmës është:

Së pari, përmbushja e detyrimeve ligjore të parashikuara në:

- Shtesën nr. 2, paragrafi 4, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

"Autoriteti Kontraktues konfirmon që Komisioni shqiptar i Ndihmës Shtetërore ka miratuar termat dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe të kësaj Shtese të 2-të."

- Shtesën nr. 3, paragrafi 4, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

"Autoriteti Kontraktues konfirmon se Komisioni i Ndihmës Shtetërore shqiptare ka miratuar afatet dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe këtë Shtesë të 3-të."

- Shtesën nr. 4, paragrafi 6, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

"*Autoriteti Kontraktues konfirmon dhe bën të ditur që Komisioni shqiptar i Ndihmës Shtetërore shqiptare ka miratuar termat dhe kushtet e kësaj shtese të 4-t dhe/ose ka konfirmuar se nuk ka element të ndihmës shtetërore.*"

Së dyti, shoqëria koncesionare ka rezultuar fituese e procesit konkurrues për zhvillimin e Projektit, si pjesë e masave të parashikuara për zhvillimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike. Zhvillimi i Projektit ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të prodhimit vendës të energjisë elektrike, duke ndikuar në përmirësimin e treguesve në lidhje me energjinë duke ndikuar në arritjen e objektivave sipas strategjive dhe planeve kombëtare, si dhe ka nxitur konkurrencën në tregun e energjisë elektrike, duke rritur eksportet e energjisë së prodhuar në Shqipëri.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

11. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafit 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

12. Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

13. Gjithashtu, neni 71 *"Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike",* i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[2] përcakton se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*

14. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

14.1 Burimet shtetërore

Sipas ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar "Burime shtetërore" janë burimet e Buxhetit të Shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu. Në këtë kuptim, dhënia, të drejtave të veçanta ose ekskluzive që kanë një vlerë ekonomike, mund të nënkuptojë heqjen dorë nga burimet shtetërore dhe të krijojë një avantazh për përfituesit.

Komponenti 1

Neni 2.4.3 (a) i Kontratës së Koncensionit (miratuar me ligjin 10083, datë 23.2.2009) parashikon si vijon:

"Në çdo kohë gjatë afatit, autoriteti kontraktues do të:

a) zhdëmtojë shoqërinë koncesionare dhe koncesionarin nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e Taksave e cila:

i. e bën atë taksë specifike 20% më të lartë se mesatarja e parashikuar (e parashikuar mbi bazën e

[2] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare"".

GDP-së së vendeve anëtare) e asaj takse specifike brenda Bashkimit Evropian; ose

ii. shkakton, individualisht ose në total me rritjet dhe zbritjet e akumuluara të taksave të tjera që ishin vendosur ose që kishin lindur pas datës së hyrjes në fuqi, kostot vjetore shtesë për Projektin, prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) euro ose më shumë, kur krahasohen me kostot që do të ishin pësuar nëse do të ishin aplikuar normat e taksës që kishin qenë në fuqi që nga data e hyrjes në fuqi;

Për qëllime të këtij paragrafi (a), fjala "taksa" nuk do të përfshijë (x) taksat e arsyeshme, detyrime, tatime, tarifa, pagesa, taksa doganore ose tarifa të çdo lloji që paguhen në këmbim të një përfitimi të drejtpërdrejtë ekuivalent të një të drejte, shërbimi, licence ose titulli tjetër te koncesionari dhe (y) kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe sigurimin shëndetësor.

Ndërsa në nenin 2.4, i shtesës së 3-të, të Kontratës së Koncensionit (miratuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015), përcaktohet se:

"*Në nenin 2.4.3 shkronja (a) pika (i) fjalët "20%" do të fshihen, me efekt për rritjet e taksave që ndodhin mbas datës efektive të kësaj shtese të 3-të.*"

Komponenti 2

Bazuar në nenin 2.2.1. të Kontratës së Koncensionit, parashikohet se:

"1.2.1 Që nga data e hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit, i cili i pranon, të drejtat ekskluzive për të gjithë afatin, në mënyrë që:

"d) shesë dhe furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe mbledhë dhe mbajë të ardhurat nga këto shitje, me kusht që:

i. koncesionari të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë gjatë vazhdimësisë së këtij aktiviteti; dhe

ii. koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik, siç është përcaktuar në nenin 25, të ligjit nr. 9072, datë 22 maj 2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", *me kusht që koncesionari të kompensohet nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhura ose rritje në kosto të cilat ai mund t'i pësojë, për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve, ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.*

Bazuar në pikën 2.3, të shtesës së 3-të të Kontratës së Koncensionit, parashikohet se pika (ii) e paragrafit (d) të nenit 2.2.1 të Kontratës së Koncesionit, ndryshohet si vijon:

"ii. Koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik, siç përcaktohet aktualisht në nenin 25 të ligjit nr. 9072 datë 22 maj 2003 "Për sektorin e energjisë". Koncesionari do të kompensohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë *rënie në të ardhurat ose rritje në kosto, të cilat ai mund t'i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.* Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk paguan shpërblim për ndonjë kërkesë për rënie në të ardhura dhe/ose rritje të kostove, që duhet t'i paguhen koncesionarit dhe kjo gjë nuk është korrigjuar brenda (45dyzet e pesë) ditësh, pasi është dërguar njoftimi me shkrim për uljen e të ardhurave dhe/ose rritjen e kostove tek Autoriteti Kontraktues, *koncesionari ka të drejtë të kompensojë çdo tarifë koncesioni të pagueshme sipas nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit dhe çdo e të gjitha taksat e pagueshme kundrejt shpërblimit të lartpërmendur, në përputhje me parimet e nenit 7.2.7.6*; dhe".

Mbështetjet financiare të parashikuara në referencat ligjore të sipërcituara nëpërmjet:

a) zhdëmtimit të shoqërisë koncesionare dhe koncesionarit nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e taksave);

b) kompensimit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhurat ose rritje në kosto, të cilat ai mund t'i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve, ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë,

aktivizojnë burime shtetërore, të cilat do të lehtësojnë ndërmarrjen për mbulimin e shpenzimeve të cilat normalisht do të duhej të përballohen nga burimet të veta të saj dhe për këtë arsye ndërmarrja përfiton një avantazh ekonomik ndaj konkurrentëve të tij.

14.2 Avantazhi ekonomik

Masa i jep ndërmarrjes të drejtën të ndërtojnë dhe shfrytëzojnë investimin kundrejt skemës së

zhdëmtimit dhe atë të kompensimit, duke i dhënë një avantazh ndërmarrjes për të kryer investimet për projektin me objekt: *ndërtimi, prodhimi dhe tregtimi i energjisë elektrike.*

14.3 Selektiviteti

Masa lidhet me skemën e zhdëmtimit dhe të kompensimit të projektit të ndërtimit të dy hidrocentraleve në lumin Devoll, e cila është selektive, pasi favorizon një ndërmarrje që operon në sektorin e energjisë.

14.4 Efekti në konkurrencë dhe treg

Siç referohet në njoftim, bazuar në detyrimet që derivojnë nga zbatimi Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), në këtë plan parashikohej se prioritetet afatmesme (2008–2009) për fushën e energjisë janë:

- Zbatimi në kohë i projekteve të ndryshme që synojnë përmirësimin e infrastrukturës për prodhimin e energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen.

- Vazhdimi i zbatimit të angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, me objektiv ngritjen e një tregu konkurrues rajonal të energjisë.

Duke konsideruar dimensionin ndërkombëtar të funksionimit të aktivitetit ekonomik në sektorin e energjisë, përfshirë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe numrit të operatorëve aktivë në këtë sektor, Komisioni vlerëson se masa ka ndikim në tregun vendës dhe ndërkombëtar.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore, e cila në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

15. Komisioni vlerëson se MIE ka përmbushur detyrimin e saj sipas nenit 4, të ligjit nr. 9374/2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar duke e njoftuar masën përpara zbatimit të saj, duke e njoftuar masën në Komisionin e Ndihmës Shtetërore.

V. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

16. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar si vijon:

- Lidhur me skemën e zhdëmtimit të shoqërisë koncesionare dhe koncesionarit nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e taksave.

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, ndihma rajonale mund të lejohet:

- Nëse ajo mbulon deri në 50% të vlerës së investimit fillestar ose të kostos së pagave të punonjëse për dy vjet për vendet e reja të punës.

- Investimi dhe vendet e reja të punës duhet të ruhen për një periudhë prej pesë vjetësh. Në çdo rast, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75% të vlerës.

Bazuar në VKM-në nr. 815, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale'", masa e njoftuar përfshihet si një projekt investimi i realizuar me kostot e pranueshme për ndihmën për investim për zhvillimin e projektit hidroenergjetik të Devollit, në shumën 590 000 000 (pesëqind e nëntëdhjetë milionë) euro. Kosto e investimit të projektit përfshin si vijon:

- Kostoja për dy hidrocentralet: në Banjë dhe Moglicë;

- Kostoja e linjave të transmetimit që lidhin këto hidrocentrale me rrjetin kombëtar të transmetimit;

- Kostot mjedisore dhe sociale.

Në këtë rast, ndërmarrja ka detyrimin të ruajë investimi në rajon për të paktën 5 (pesë) vjet pas përfundimit të projektit dhe se ka kontribuar me një kontribut financiar prej të paktën 25% të kostove të pranueshme në një formë që nuk ka asnjë mbështetje publike. Kostoja e investimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit është vlerësuar rreth 590 milionë euro, nga ku kosto e ndërtimit për të dyja HEC-et është 529 milionë euro: 191 milionë euro HEC Banjë dhe 338 milion euro HEC Moglicë. Intensiteti i ndihmës është 1.56%, në përputhje me pikën 5, të vendimit të KNSH-së nr. 43, datë 11.9.2012, "Për miratimin e hartës rajonale të ndihmës shtetërore", që përcakton, se: "*në rajonet e nivelit NUTS II, intensiteti i ndihmës rajonale nuk duhet të kalojë 50% të ENG-së".*

- Lidhur me skemën e kompensimit për ofrimin e shërbimit publik

Në përputhje me nenin 13/3, "Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik", të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, ku parashikohet, se: *"Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik është ndihma në formën e kompensimit, e cila u jepet ndërmarrjeve të ngarkuara për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik dhe ekonomik."* Bazuar në VKM-në nr. 650, datë 14.9.2016, "Për përcaktimin e kritereve, intensitetit dhe të procedurës për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të

shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik", mandati i shërbimit publik duhet të përmbajë, në veçanti:

a) Përmbajtjen dhe përcaktimin sa më të detajuar të detyrimeve të shërbimit publik dhe, kur është e mundur, listën e shërbimeve publike që ndërmarrja përfituese duhet të kryejë;

b) Ndërmarrjen përfituese dhe territorin në të cilin duhet të ofrohet shërbimi publik;

c) Kohëzgjatjen e detyrimeve të shërbimit publik. Në parim, mandati nuk e kalon një periudhë dhjetëvjeçare, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimit detyrohet ose angazhohet të kryejë një investim të rëndësishëm, të papërdorshëm, i cili ka nevojë të amortizohet për një kohë më të gjatë, në përputhje me parimet kontabël përgjithësisht të pranuara;

ç) Mekanizmin e kompensimit dhe të parametrave për llogaritjen, monitorimin dhe rishikimin e kompensimit. Parametrat për llogaritjen e kompensimit duhet të jenë objektivë dhe të matshëm;

d) Masat për shmangien dhe kthimin e çdo mbikompensimi;

dh) Çdo të drejtë ekskluzive apo të veçantë që i është caktuar ndërmarrjes, të cilat duhet të parashikohen paraprakisht me ligj.

Dhënia e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit për shërbime publike duhet të jetë proporcionale dhe shuma e kompensimit për shërbime publike nuk duhet të kalojë koston neto të ofrimit të shërbimit publik, përfshirë dhe një marzh fitimi të arsyeshëm.

Për sa më sipër, dhënësi i ndihmës duhet të vlerësojë masën e kompensimit për koncensionarin për shërbimet publike të ofruara.

17. Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 20, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore "Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë", të njoftuar në bazë të ligjit nr. 10083, datë 23.2.2009, "*Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe AVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionare, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 50%. Përveç kostove të pranueshme, të lidhura me investimin në llogaritjen e intensitetit do të merren parasysh të gjitha përjashtimet apo lehtësimet nga taksat, si dhe të gjitha format e tjera të ndihmës.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës, në përputhje me nenin 21, të ligjit 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit të jetë dhënë në kuadër të këtij plani.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja
Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

VENDIM
Nr. 125, datë 30.5.2025

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "MBËSHTETJE PËR INCENTIVA TË REJA PËR GRUPET NË NEVOJË"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

- Z. Blendi Gonxhja kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 30.5.2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005,

"Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Bashkia e Tiranës mbi mbështetjen me grante nga buxheti i Bashkisë Tiranë për krijimin e mundësive për zhvillimin e bizneseve nga individë dhe grupe vulnerabël.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 347/1, datë 13.1.2025, ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore "Mbështetje për incentiva të reja për grupet në nevojë". Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*: Dhënia e përfitimit me fond nga buxheti i shtetit synon të stimulojë idetë dhe sipërmarrjet inovative të grupeve në nevojë, duke i ofruar mundësi për integrim në tregun e biznesit dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Skema mbështet krijimin e mundësive për zhvillimin e bizneseve nga individë dhe grupe vulnerabël.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës:* Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 131, datë 18.12.2024, "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, 2025–2027, dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025, nën programin e kujdesit social për familjen dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundjet dhe paaftësia".

4. *Kohëzgjatja:* Skema e ndihmës do të zbatohet gjatë vitit 2025.

5. *Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës:* Bashkia Tiranë.

6. *Përfituesit:* Përfitues janë të gjithë NMVM-të, duke iu nënshtruar një procesi ndarë në tri faza:

- ***Faza e parë:*** Kandidatët e pranueshëm aplikojnë me idenë e tyre bazë për biznes, përmes Formularit të aplikimit.
- ***Faza e dytë:*** Aplikantët e pranuar marrin pjesë në trajnime për aftësitë e përgjithshme të biznesit dhe zhvillimin e planit të biznesit, dhe vetëm atëherë ata dorëzojnë planet e biznesit. Këto plane do të konkurrojnë për mbështetje me grant.
- ***Faza e tretë***: Fituesit e njoftuar do të firmosin një kontratë 12-mujore për të marrë financimin e grantit dhe mbështetje këshilluese.

7. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Tiranë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës:* Skema e mbështetjes me ndihmë shtetërore është gjithsej 16.000.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë lekë). Çdo përfitues i skemës do të mbështetet në shumën 800.000 lekë, (tetëqind mijë lekë).

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton, se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore."

11. Gjithashtu, neni 71, "*Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike*", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë përcakton, se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plani i ndihmës i miratuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë financohet nga buxheti i miratuar për Bashkinë Tiranë, duke aktivizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë burimet shtetërore. NMVM-të do përfitojnë një avantazh ekonomik në formën e aksesit në financë. Avantazhi do të jepet për NMVM-të fituese si rezultat i procedurës së përzgjedhjes të aplikimeve fituese, të cilat do të

kryejnë aktivitet ekonomik në prodhimin e mallrave ose në ofrimin e shërbimeve që tregtohen ndërkombëtarisht. Prandaj, ndihma e njoftuar në këtë skemë mund të shtrembërojë konkurrencën dhe të ndikojë në tregtinë ndërmjet shteteve anëtare.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në bazë të nenit 4, të ligjit 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8 të ligjit 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

"Ndihma "De minimis" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis"*, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit", të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet, se: "1 .Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente."

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005m "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 605/2016, ndihma "*De minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon *14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë*, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se ndihma shtetërore për një ndërmarrje është deri në vlerën 800,000 (tetëqind mijë lekë).

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është një vit, duke plotësuar këtë kusht ligjor.

c) Ndihma është transparente. Ky kusht plotësohet sepse ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore" të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI :

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit "Mbështetje për incentiva të reja për grupet në nevojë", të miratuar me në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 131, datë 18.12.2024, "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, 2025–2027, dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025, nën programin e kujdesit social për familjen dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundjet dhe paaftësia".

2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës "*De-minimis"* dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Tiranë. Vlera totale e ndihmës e dhënë një ndërmarrjeje nuk duhet të kalojë *14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë*, për një periudhë financiare prej *tre vjetësh.*

3. Bashkia Tiranë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

VENDIM
Nr. 96, datë 12.5.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1664/1 prot., datë 9.5.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 2286 prot., datë 30.4.2025, protokolluar në ERE me nr. 1664 prot., datë 2.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe "Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin prill 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruara, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin prill 2025 në vlerën 7.82 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 7.82 lekë/kwh, në përputhje me përllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin prill 2025: 7.82 lekë/kwh;
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;
- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022": 1.55 lekë/kwh;
- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;
- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 28.3.2025–29.4.2025.
- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që

furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin prill 2025			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë	Lekë/kWh	7.82
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin	Lekë/kWh	0.23
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		**Lekë/kWh**	**11.51**

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 11.51 lekë/kwh për muajin prill 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2025 prej 11.51 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuara në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 97, datë 12.5.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GREEN ENERGY" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1172/17 prot., datë 7.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Green Energy' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria "Green Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1172 prot., datë 20.2.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 3.3.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Në datat 4.3.2025 dhe 5.3.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.

- Deri më datë 13.3.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të jetë paraqitur asnjë.

3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Me shkresat nr. 1172/4 prot. dhe nr. 1172/5 prot., datë 6.3.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 53/2025 dhe zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s për sqarimin e dokumentacionit të munguar, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore, me qëllim marrjen e qëndrimit të saj lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose vlefshmërinë e kontratës.

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE më datë 13.3.2025, mori pjesë vetëm përfaqësuesi i shoqërisë "Green Energy" sh.p.k., ndërsa nuk u paraqitën përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Gjatë seancës, shoqërisë iu sqarua dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht, i cili ishte njoftuar më herët edhe me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 6.3.2025, dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë u mor angazhimi për dorëzimin e tij. Në vijim, me qëllim përkujtesën e detyrimeve të lëna në seancë, shoqërisë iu dërgua një e-mail më datë 26.3.2025, i protokolluar në ERE me nr. 1172/6 prot. Shoqëria, me e-mailin e datës 7.4.2025, konfirmoi se ndodhet në fazën e mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar dhe se do ta dorëzojë atë pranë ERE-s në ditët në vijim.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së bordit

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, datë 7.4.2025, me anë të të cilit është kërkuar kohë shtesë për depozitimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, me vendimin nr. 65, datë 7.4.2025, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes.

- Në vijim të korrespondencës me shoqërinë, përmes shkresave të protokolluara nr. 1172/10 prot., datë 9.4.2025, nr. 1172/14 prot., datë 30.4.2025 dhe nr. 1172/16 prot., datë 2.5.2025, vlerësohet se mbetet ende për t'u sqaruar qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit, si dhe vlefshmëria e kontratës. Po ashtu, mbetet për t'u dokumentuar mbështetja financiare nga banka, e shoqëruar me formatin respektiv të korrespondencës zyrtare me Bankën.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Green Energy" sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Green Energy" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve duhet të depozitohet në ERE qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit nga shoqëria, si dhe mbështetja financiare sipas formatit respektiv të bankës.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Green Energy" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 98, datë 12.5.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SUNPRO" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË EOLIKE, ME KAPACITET PRODHUES 3 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.

109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1648/1 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SunPro' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Shoqëria "SunPro" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648 prot., datë 30.4.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit nga centrali gjenerues i energjisë eolike, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave ("a", "b" dhe "c"), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 29.4.2025 sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave ("a" dhe "d"). Konkretisht, ai ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur elektronikisht nga QKB-ja, më datë 23.4.2025.

- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave ("a" dhe "c"). Sipas germës "a" është depozituar vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, datë 23.4.2025, që konfirmon se shoqëria "SunPro" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera tatimore dhe të sigurimeve shoqërore/shëndetësore. Referuar planit të biznesit, financimi i projektit parashikohet të realizohet në vlerën 30% nga kapitali aksionar dhe 70% me kredi bankare nga banka të nivelit të dytë.

- Në përputhje me pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave ("e" dhe "f").

- Shoqëria **rezulton se ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit,** në përputhje me përcaktimet e **aneksit A** të rregullores.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 146, datë 13.3.2023, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria "SunPro" sh.p.k.".

- Shoqëria është pajisur me vendimin për VNM paraprake, lëshuar më 18.2.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit "Sistem gjenerues me erë, Maja e Shtogut dhe veprave ndihmëse".

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa "b":** Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin e saj.

- **germa "c":** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin për strukturën e saj organizative të nënshkruar dhe vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "b":** Shoqëria duhet të depozitojë një dokument të përditësuar në lidhje me financimin nga banka, e po ashtu të dokumentojë mbështetjen financiare për pjesën e mbetur të investimit, prej 30%.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **germa "a":** Shoqëria ka plotësuar pjesërisht shtojcën 2, ku ka deklaruar si datë të fillimit të

operimit vetëm vitin 2027. Në referencë me përcaktimet e VKM-së nr. 146, datë 13.3.2023, e cila parashikon afatin 36-mujor për vënien në punë të centralit, ky operim duhet të nisë brenda datës **13.3.2026**. Në këto kushte, **vlerësohet që shoqërisë t'i kërkohet të bëjë përditësimin përkatës të këtij informacioni**, në përputhje me VKM-në dhe, nëse është e aplikueshme, me ndonjë detyrim që rrjedh nga kontrata me MIE-n;

- **germa "b":** Në funksion të koordinimit të jetëgjatësisë së deklaruar të centralit me afatin maksimal të licencës së përcaktuar në legjislacion (deri në 30 vjet), **vlerësohet që shoqëria të depozitojë në ERE një dokument teknik që justifikon jetëgjatësinë e deklaruar të centralit eolik (p.sh. garanci teknike ose certifikatë e pajisjes)**. Gjithashtu, shoqëria duhet të informojë nëse ka krijuar një **shoqëri për qëllime të veçanta**, në përputhje me pikën "g" të VKM-së nr. 146/2023, dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës në rast se ajo ekziston. Po ashtu, referuar pikës iii të VKM-së së sipërcituar, ku parashikohet lidhja e një kontrate me MIE-n për realizimin e projektit, **shoqërisë i kërkohet të informojë nëse kontrata është lidhur dhe, nëse po, të depozitojë një kopje të saj në ERE**.

- **germa "c":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/ Marrëveshjen përkatëse të nënshkruar me OST sh.a.

- Shoqëria, duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e veprës.

- Përveç sa më sipër, në referencë të një korrespondence të zhvilluar më herët me Autoritetin e Aviacionin Civil (AAC), në të cilën është theksuar nevoja që ky autoritet të informohet në rastet kur një subjekt aplikon pranë ERE për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike, me qëllim identifikimin dhe reflektimin e këtyre objekteve në hartat përkatëse për nevojat e **navigimit ajror**, **vlerësohet e nevojshme që AAC-ja të vihet në dijeni për fillimin e kësaj procedure licencimi.**

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SunPro" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë eolike, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SunPro" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Aviacionit Civil për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 99, datë 12.5.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "NAD INVESTMENT" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", nenit 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "e", 13, dhe 14, pika 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1409/7 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'NAD Investment' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Shoqëria "NAD Investment" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1409 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 8.4.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 9.4.2025 dhe 10.4.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.4.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1408/3 prot., datë 15.4.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim, duke evidentuar dhe informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Me shkresën e protokolluar ne ERE me nr. 1408/4 prot., datë 25.4.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende informacion/ dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1409/4 prot., datë 30.4.2025.

- Kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, ashtu sikurse dhe e-mailet që rezultojnë nga dokumentacioni i aplikimit të shoqërisë, te të cilat i është dërguar një kopje e skanuar e shkresës së lartpërmendur. Si e tillë dhe pasi kontaktit nëpërmjet telefonit, kjo shkresë i është dërguar e skanuar shoqërisë nëpërmjet një e-mailit të ri të dhënë nga përfaqësuesi i shoqërisë.

- Në përgjigje, në datën 7.5.2025, shoqëria ka dorëzuar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar në tërësi aplikimin për licencim.

- Sa i përket strukturës organizative, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se shoqëria ka parashikuar një **strukturë të detajuar dhe funksionale**, që mbulon përgjegjësitë teknike dhe operative për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Në këto kushte, vlerësohet t'i lihet kusht që shoqëria me fillimin e operimit të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik të brendshëm.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që synon të furnizojë gjatë pesë viteve të vlefshmërisë së licencës. Ka bërë me dije mbi Sistemin e IT-s që do të operojë veprimtarinë e furnizimit dhe faturimit, si dhe ka dhënë informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët të cilët do të furnizojë.

- Rezulton se aktualisht shoqëria ka një kontratë huapërdorje për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me afat deri më 13.2.2030, që nuk mbulon të gjithë afatin e licencës dhe ka marrë angazhimin për njoftimin e ERE-s në rast ndryshimit të adresës dhe të rinovimit të kontratës. Në këto rrethana vlerësohet t'i lihet kusht që brenda datës 13.2.2030, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, ose një dokument në lidhje me disponimin e zyrave për periudhën e mbetur të licencës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik të brendshëm.

3. Brenda datës 13.2.2030, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k., OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 100, datë 12.5.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "NAD INVESTMENT" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e" dhe 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1408/4 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'NAD Investment' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "NAD Investment" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 8.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 9.4.2025 dhe 10.4.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.4.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1408/3 prot., datë 15.4.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408/4 prot., datë 25.4.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion të përditësuar në lidhje me mbështetjen financiare.

- Sa i përket strukturës organizative, vlerësohet t'i kërkohet shoqërisë, që me fillimin e operimit, të njoftojë ERE-n mbi bërjen efektive të saj, referuar stafit teknik për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Me fillimin e operimit, shoqëria duhet të njoftojë ERE-n mbi bërjen efektive të strukturës organizative të saj, referuar stafit teknik për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k., "OST" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 101, datë 12.5.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "HYDROPOWER" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 2, germa "a", 3, 4, germat "a" dhe "b", 5, germa "j", 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1589/1 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Hydropower' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj",

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë "Hydropower" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "Hydropower" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 mw, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022, për një afat 25-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1589 prot., datë 23.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj, në favor të "Raiffeisen Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa "a", 3, 5, germa "j" dhe 6 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1

- **germa "a":** Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj;

- **germa "c":** Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- **germa "d":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve;

- **germa "e":** Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike;

- **germa "h":** Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e kredisë dhe kontratat e hipotekës, të lidhura me "Raiffeisen Bank" sh.a., për një financim në funksion të zhvillimit të projektit fotovoltaik. Megjithatë, në marrëveshjet e paraqitura nuk përmbajnë një listë të detajuar të aseteve fikse (të paluajtshme) që kërkohet të transferohen, me vlerat përkatëse dhe vlerën totale të tyre. Në këto kushte, shoqëria duhet të depozitojë në ERE: listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre), e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës së hipotekës që i shërben veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në ERE;

- **germa "j":** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të aseteve të kryera më herët nga ana saj.

- **Pika 6:** Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t'i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Hydropower" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 5460 rep., nr. 1472 kol., datë 23.8.2023, lidhur ndërmjet "Raiffeisen Bank" sh.a. dhe shoqërisë "Hydropower" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Hydropower" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 102, datë 12.5.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "DIMAX ALBANIA" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET KONTRATËS SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 2, germa "a", 3, 4, germat "a" dhe "b", 5, germa "j", 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1591/2 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Dimax Albania' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj",

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë "Dimax Albania" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "Dimax Albania" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 mw, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022, për një afat 25-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1591 prot., datë 23.4.2025, ajo ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë "Dimax Albania" sh.p.k, në favor të "Raiffeisen Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa "a", 3, 5, germa "j" dhe 6 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1

- **germa "a":** Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj;

- **germa "c":** Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- **germa "d":** Shoqërisë duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve;

- **germa "e":** Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike;

- **germa "h":** Shoqëria duhet të depozitojë listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre), e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës së hipotekës, që i shërben veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në ERE. Gjithashtu në vijim, kërkohet sqarim nga shoqëria "Hydropower" sh.p.k. në lidhje me cilësinë e saj si bashkëkredimarrëse, në funksion të përcaktimeve të kontratës së kredisë;

- **germa "j":** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj.

- **Pika 6:** Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t'i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Dimax Albania" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj "Raiffesisen Bank" sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë e nr. 5472 rep., nr. 1483 kol., datë 23.8.2023, të lidhur ndërmjet palëve.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Dimax Albania" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 103, datë 12.5.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET KONTRATËS SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 2, germa "a", 3, 4, germat "a" dhe "b", 5, germa "j", 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1590/2 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Construction Energy Parts (C.E.P)' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet kontratës së hipotekës) të aseteve fikse të saj",

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë "Construction Energy Parts (C.E.P)" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "Construction Energy Parts (C.E.P)" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 mw, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 30.11.2022, për një afat 25-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1590 prot., datë 23.4.2025, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse nëpërmjet hipotekimit në favor të "Raiffeisen Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa "a", 3, 5, germa "j" dhe 6 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1

- **germa "a":** Shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj;

- **germa "c":** Shoqëria duhet të paraqesë informacion mbi gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- **germa "d":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve;

- **germa "e":** Shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike;

- **germa "h":** Shoqëria duhet të depozitojë listën e detajuar të aseteve fikse (me vlerat specifike dhe totale të tyre), e cila duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës së hipotekës që i shërbejnë veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe ta depozitojë këtë të fundit në ERE. Gjithashtu në vijim, kërkohet sqarim nga shoqëria "Hydropower" sh.p.k. në lidhje me cilësinë e saj si bashkëkredimarrëse, në funksion të përcaktimeve të kontratës së kredisë;

- **germa "j":** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj.

- **Pika 6:** Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t'i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Construction Energy Parts (C.E.P)" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a., që rrjedhin nga kontrata e kredisë nr. 5466 rep., nr. 1478 kol., datë 23.8.2023, të lidhur ndërmjet palëve.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Construction Energy Parts (C.E.P)" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/06/12 11:01:45 +02'00'
b45979dc3e5d47faa2b8f104c5ae4be0202506121
1013745031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)